Viti XXIII | Nr.227 | Prill 2010 | Rabi-2 / Jumada 1 1431 | Çmimi 50 den

# Hëna e Re

*Revistë kulturore informative islame*

# KUR'ANI
## vërtetësi e përjetshme
*1400 vjetori i shpalljes së fjalës së përsosur të Allahut fuqiplotë*


18 KUR'ANI, MREKULLI E PËRJETSHME


23 NDRYSHIMET E REJA LEGALIZOJNË FALSIFIKIMET


29 ESTETIKA E LEXIMIT TË KUR'ANIT


42 KUR'ANI DHE TEORITË SHKENCORE

www.bim.org.mk | www.henaere.bim.org.mk

FJALIMI I KRYETARIT TË BFI, REIS UL ULEMA, H. SULEJMAN EF. REXHEPI I MBAJTUR NË KONFERENCËN BOTËRORE PËR DIALOG NDËRFETAR DHE NDËRCIVILIZUES

# Dialogu mes religjioneve dhe kulturave është i patjetërsueshëm

*Të nderuar organizator të Konferencës botërore për dialog ndërfetarë dhe ndërcivilizues,*
*Të nderuar përfaqësues të lartë fetarë nga Bota dhe vendi,*
*Të nderuar mysafirë, miq dhe vëllezër*

Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Bashkësisë fetare Islame dhe në emrin tim personal t'ju përshëndes dhe t'ju dëshiroj punë të suksesshme për të mirën e të gjithë qytetarëve të botës por edhe çaste të këndshme në vendin tonë.

Konferenca për dialog ndërfetare dhe ndër religjioz e cila mbahet për të dytën herë me rradhë në qytetin e bukur të Ohrit, i cili në krahët e tij me xhelozi të rrallë po ruan trashëgiminë e kulturave të ndryshme e gërshetuar me multikonfesionalizimin e sotëm, ngadalë po shndërrohet në një traditë e cila me dëshirën e Allahut xh.sh do të vazhdoj që në periudhën e ardhshme të shërbejë si dritë e cila do të shëndërris rrugën e bashkëjetesës, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit.

Në përputhje me sintagmën e shpallur të Allahut xh.sh. e cila thirr në nevojën që të gjithë së bashku të apelojmë tek të gjithë bashkëqytetarët, që të ndjekin urtësinë e rrugës së Zotit, të bëjnë dialog me mjete të cilat i shërbejnë dhe i japin ardhmëri dialogut.

Ashtu edhe siç thotë Kurani i lartësuar në **Suren Nahl, Ajeti 125 :**

**"Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit"**



#### TË NDERUAR TË PRANISHËM

Nga e kaluara e largët, nga koha e Ademit dhe paraqitjes së tij në këtë botë, njeriu krijon vlera shpirtërore dhe materiale në bazë të kushteve të jetesës dhe përvojës së fituar.

Ashtu dhe sot, mund të flasim për pafundësi kulturash, pafundësi civilizimesh, pafundësi përvojash religjioze, por të gjithë këto janë pasqyrë e dëshirës së një Krijuesi të përbashkët, Krijuesit të gjithësisë, e ai është Allahu xhele xhelaluhu.

Për shkak të kësaj, bukurinë e kësaj bote e madhërojnë dallimet, ku të mençurit dhe të sinqertit duhet ta mbështesin dhe ta mbrojnë sepse çdo dhunë me qëllim për të unifiku dallimet e kësaj botë do të paraqes një keqardhje dhe dhimbje për atë që është bërë, por njëkohësisht pasiguri dhe trazim për shpirtin e njeriun të sotëm.

Baza për një dialog të suksesshëm multireligjioz gjithsesi paraqet etika dhe morali i shoqërisë prej nga vijmë dhe të cilat secili prej nesh i mbart në vetvete dhe ne jemi të detyruar që të miratojmë dhe respektojmë vlerat etike të cilat bazohen në barazi, barabarësi, liri në të besuar dhe me të cilat duhet të ndërtojmë vlerat etike universale.

Misioni i thirrjes së Muhamedit a.s. përveç që bazohet në besimin në një Zot ai po ashtu i jep rëndësi edhe përsosmërisë së moralit njerëzorë.

#### TË NDERUAR MIQ

Shpresoj, në fakt besoj se Ju me mençurinë tuaj, me prezantimin e mendimeve tuaja në këtë Konferencë, me shkëmbimin e përvojave të cilat janë pjesë e këtij ambienti, me respektin tuaj për tjetrin i cili është i ndryshëm nga ju, me miqësinë që do të lidhni ndërsa të vjetrat do t'i forconi, do të dërgoni mesazhe të qarta se dialogu mes religjioneve dhe kulturave është i patjetërsueshëm në kohën e njeriut të sotëm i cili është i preokupuar me të mirat materiale të kësaj bote, i kthyer drejt amoralit dhe jetës së pavlerë, do të dërgoni mesazhe të forta për pjekurinë e njeriut, vendosjen e paqes mes njerëzve dhe të gjithë të jemi mbështetës të së vërtetës e cila është udhërrëfyesi i ardhmërisë më të sigurt.

Të gjithë juve ju përshëndes dhe ju uroj punë të suksesshme dhe të frytshme.

**Zoti le të bekoj punën tuaj.**

***06-09 Maj 2010, Ohër***

# Një mijë e katërqind vjet me begatitë KUR`ANORE

Falënderimet tona qofshin për Zotin xh.sh., i cili krijoi gjithësinë, krijoi sistemin diellor e në të planetin tone, duke krijuar kushte për jetë; i cili krijoi njeriun, duke e dalluar atë nga krijesat tjera e duke e autorizuar atë me misionin e mëkëmbësit të Tij në tokë.

Po ashtu, falënderimet tona qofshin për Zotin xh.sh. i cili përmes shpalljeve, periudhë pas periudhe, ka komunikuar me njerëzit, me qëllim që ata të jenë të dijshëm, të udhëzuar, që sa më mirë ta realizojnë misionin e tyre në këtë botë.

Një komunikim i këtillë hyjnor, që njëherit paraqet hallkën e fundit të zinxhirit të komunikimeve, ndodhi para një mijë e katërqind viteve, pikërisht me këto fjalë:

*"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (gjithçka); e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i cili i mësoi njeriut (të përdorë) lapsin; i mësoi njeriut ato që nuk i dinte".*

Pra, këto ishin pesë ajetet e para të Kur`anit famëlartë, që Krijuesi i gjithësisë, Allahu xh.sh., përmes melaqes Xhibril, të Dërguarit të tij, Muhamedit a.s., e përmes tij të gjithë njerëzve, pa dallim racor, gjinor dhe etnik, ua shpalli Kur`anin famëlartë, që është përmbledhje e vlerave universale që nuk kufizohen në kohë dhe në hapësirë.

Pa dyshim, kjo shpallje shënon fillimin e një epoke të re në zhvillimin e mendimit njerëzor, duke e zbatuar atë në të gjithë lëmenjtë e jetës. U lind një periudhë e re, në të cilën arsyeja, dija dhe shkenca janë dominuese. Kur`ani famëlartë në të gjitha konceptet dhe idetë e tij i dha njeriut hapësira të mëdha për hulumtime, zhvillime dhe organizime sa më të mira të jetës së tij, i dha liri të plotë që në përputhje me të arriturat tekniko-shkencore të shfrytëzojë pasuritë natyrore, të cilat Krijuesi i krijoi vetëm për të mirën e njeriut.

Epoka e Kur`anit me të arriturat e tij, gjatë katërmbëdhjetë shekujve, vërtetoi se është një epokë revolucionare në të gjitha poret e jetës së njeriut, epokë e cila për nga ngritja e dijes dhe e shkencës dallon nga epokat e shpalljeve të tjera hyjnore.

Sado që është shkruar, po shkruhet dhe do të shkruhet për rëndësinë e shpalljes së Kur`anit famëlartë, nuk do të arrihet të shpjegohet e tërë vlera e tij, andaj këta pak rreshta le të jenë vetëm një përkujtim i këtij përvjetori të madh, të cilin revista jonë në këtë numër e shënon me punime të ndryshme, duke iu paraprirë manifestimeve të tjera të cilat do të organizohen te ne me rastin e shpalljes së Kur`anit.

# Hëna e re

REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME

Botues:
Rijaseti i BFI në RM

*Kryeredaktor:*
Abaz Islami

*Redaktor përgjegjës:*
Shaban Aziri

*Redaksia:*
Skender Buzaku
Abas Jahja
Ibrahim Idrizi
Qufli Osmani
Shaban Sulejmani
Ismet Osmani
Driton Dikena
Agron Vojnika

*Bashkëpunëtorë:*
Valbona Zunçe
Rejhan Neziri

*Redaktimi gjuhësor:*
Nazif Zejnullahu

*Redaktor teknik:*
Halil Berisha

Telefonat e Redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412

www.bim.org.mk
e-mail:bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk

Dorëshkrimet dhe
fotografitë nuk kthehen


# Përmbajtja



KURANI, VEPËR E PËRHERSHME 26



PËR KUR'ANIN, ME KUR'ANIN! 30



FAMILJA, BËRTHAMË E SHOQËRISË SË SHËNDOSHË 39



PAQJA NË BRENDI TË ISLAMIT 48



DISA DALLIME NDËRMJET BIBLËS DHE KUR'ANIT (II) 54

6 TAKIM: REIS UL ULEMA ME MINISTREN MILEVSKA

6 TAKIM: REIS ULEMA I BFI ME AMBASADORIN TURK OKÇAL

6 SA MË LARG SPEKULIMEVE

6 KËRKOJMË TRAJTIM TË BARABART ME KOM-IN

7 ISLAMOFOBIA USHQEN RADIKALIZMIN DHE EKSTREMIZMIN

8 STUDENTËT - FORCA E BFI-SË

8 BFI DHE ITSHK FIRMOSËN MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

9 KUMTESË PËR OPINION

9 BFI FTON ZËDHËNËSIT E POPULLIT MYSLIMAN NË PARLAMENTIN E MAQEDONISË

10 U VË GURTHEMELI I XHAMISË ARASTA NË ÇARSHINË E VJETËR TË SHKUPIT

10 ISLAMI TEK SHQIPTARËT E MAQEDONISË ËSHTË PJESË E IDENTITETIT KOMBËTAR

11 TË FRESKËTA JANË NDYTËSIRAT TUAJA NË MENDJET TONA

12 CILI ËSHTË DALLIMI MES KOMUNËS QENDËR DHE TË ÇAIRIT

14 DOMOSDOSHMËRIA E DIALOGUT NDËRFETARË DHE NDËRKULTURORË

15 GËNJESHTRA I KA KËMBËT E SHKURTRA

16 A SHKON MAQEDONIA DREJT NJË KONFLIKTI TË RI ETNIK ME NGJYRIME FETARE?!

21 MUHAMEDI A.S., KOMENTATORI I PARË I KUR'ANIT

33 FESTIMI I 1 MAJIT

35 TË PËRPIQEMI QË TË BËHEMI KUR`ANË TË GJALLË

37 TË JETOSH ME KUR'AN

47 KONCEPTI I KUR'ANIT PËR DA'VEN 1 (I)

49 PAQJA NË BRENDI TË ISLAMIT

52 AKTIVITETI NË SFERËN E DA'VETIT (THIRRJES ISLAME)

58 THE DIALOG SHOULD BE THE ONLY MEAN TO ACHIEVE PROSPERITY

59 MEETING: REIS UL ULEMA WITH MINISTER MILEVSKA

59 REIS ULEMA OF IRCM MEETS THE TURKISH AMBASSADOR OKÇAL

59 KEEPING SPECULATION AWAY

59 WE DEMAND EQUAL TREATMENT WITH THE MOC (MACEDONIAN ORTHODOX CHURCH)

60 STUDENTS ARE THE STRENGTH OF IRC 60

61 PRESS RELEASE

61 ISLAM IS PART OF NATIONAL IDENTITY AMONG ALBANIANS OF MACEDONIA






# Takim: Reis ul Ulema me Ministren Milevska

Më 07.04.2010 një delegacion i BFI në krye me Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi zhvilluan një takim pune në Ministrinë e Kulturës me ministren Elizabeta Kamçevska Milevska. Takimi u zhvillua lidhur me fillimin e punëve të rindërtimit të Çarshi Xhamisë së Prilepit. Marrë parasysh se në këtë drejtim nuk ka asnjë pengesë juridike për fillimin e punëve, si dhe faktin se gërmadhat e xhamisë për disa vite kanë dëmtuar imazhin e vendit tonë, shihet si domosdoshmëri që sa më shpejtë të fillohet me punë.

# Takim: Reis Ulema i BFI me ambasadorin turk Okçal

Më 07.04.2010 Reis ul Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi priti ambasadorin e Republikës së Turqisë, H. Hakan Okçal, me të cilin mes tjerash bisedoi edhe për zhvillimin e punëve rreth restaurimit të Xhamisë Mustafa Pasha si dhe për zhvillimin e punëve lidhur me rindërtimin e Xhamisë Arasta dhe problemet me të cilat po ballafaqohet Myftinia e BFI-së – Shkup në lidhje me fillimin e punëve për Xhaminë Arasta.

# Sa më larg spekulimeve

Më 07.04.2010 Myftiu i Muftinisës së BFI-Shkup h. Ibrahim ef. Shabani, në cilësinë e përfaqësuesit të Reis ul Ulema h.Sulejman ef. Rexhepit prezantoi në dreken solemne që KOM-i e shtroi me rastin e festës së Pashkëve. Pjesëmarrës në këtë solemnitet ishin edhe përfaqësues të Kishës Katolike dhe asaj Evangjeliste.

Ajo që u tha në Alsat- M se " sipas mediave takimi, është thirrur për të ulur tensionet.." është thjesht spekulim i radhës dhe me tendencë për të dezinformuar opinionin, aq më tepër kur thuhet se: "Ky është takimi i parë mes përfaqësuesve të bashkësive fetare që pas hapjes së debatit për ndërtimin e kishës në sheshin e Shkupit." Sa për drejt informim duhet te përkujtojmë opinionin se ky konstatim është krejtësisht i gabuar dhe se BFI me pjesëtarë të bashkësive të tjera fetare ka pasur edhe takime të tjera, si psh. Para disa ditëve Muftiu i Muftinisë së BFI-Shkup së bashku me përfaqësues të bashkësive të tjera fetare ishte aktiv në mbledhjen e fidanëve, Reis ul Ulema h.

Sulejman ef. Rexhepi iu përgjigj ftesës së Fondacionit Kondrad Adanauer për një takim ku gjithashtu ishin prezent edhe udhëheqës dhe lider të bashkësive të tjera fetare.

## NUK HJEKIM DORË NGA BURMALI XHAMIA

# Kërkojmë trajtim të barabart me KOM-in

Më 09.04.2010, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi realizoi takim me Kryetarin e Shtetit Gjorge Ivanov.

Në këtë takim Reis ul Ulema shprehi shqetësimet e institucionit lidhur me problemet siç janë: Çarshi xhamia në Prilep, ndërtimi i xhamisë në Llazhec të Manastirit, denacionalizimi i pronave të BFI-së në përgjithësi dhe trajtimi jo i barabartë i BFI me KOM nga ana e Qeverisë.

Në veçanti rasti me Burmali xhaminë ku edhe përkundër kërkesës që kishte parashtruar BFI lidhur me rindërtimin e asaj Xhamie, nuk iu nda vendi, kurse KOM-it i ndau vend për kishë në qendër të Shkupit edhe pse më parë në atë vend kurrë nuk ka pasur kishë si dhe fare pa parashtruar kërkesë. BFI bëri të ditur edhe kryetarit të shtetit se vendimet politike të qeverisë po shkaktojnë probleme nga më të ndryshmet dhe ia prishin imazhin këtij shteti multietnik dhe multifetar.



Për gjitha këto probleme kreu i BFI kërkoi që kryetari i shtetit me autoritetin e tij të ndihmon në tejkalimin e problemeve dhe këtë shtet që të gjithë të ndjejmë si tanin me të drejta të garantuara.

Nga ana tjetër, kryetari z.Ivanov u shpreh se me autoritetin e tij gjithnjë do të angazhohet për tejkalimin e problemeve dhe se gjithnjë do të ndihmon në ndërtim të marrdhënjeve sa më produktive mes bashkësive fetare dhe avancimin e rolit pozitiv të tyre në jetën shoqërore.

## TAKIM REIS UL ULEMA I BFI DHE BERGER

# Islamofobia ushqen radikalizmin dhe ekstremizmin



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis Ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi të premten më 09.04.2010 ka zhvilluar një takim me ekspertin për çështje Islame nga Mbretëria e Holandës, Prof. Dr. Maurits S. Berger, ligjërues në Universitetin holandez "Leiden" i cili njëkohësisht është edhe udhëheqës i Fakultetit Islamik, në po të njëjtin universitet.

Kreu i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, i shoqëruar nga Drejtori i Sektorit për Arsim dhe Shkencë pranë BFI-së, H. Jakup Selimovski, njoftuan mysafirin me aktivitetin që po zhvillon BFI-ja rreth ruajtjes, zhvillimit dhe kultivimit të jetës fetare Islame në Republikën e Maqedonisë.

Gjithashtu, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, njoftoi se gjatë viteve të fundit ka zhvilluar dy takime me ambasadoren aktuale të Holandisë në Shkup, znj. Simeone Filipini, e cila e ka porositur që BFI-në do ta vizitojnë ekspertë të Islamit nga Holanda dhe institucionin fetarë këtu tek ne, ta marrin si shembull të organizimit të jetës fetare-islame edhe në vendin e tyre - Holandë.

Gjithashtu gjatë takimit të kreut të BFI-së dhe ekspertit holandez u fol edhe për organizimin institucional dhe traditën islame në vend ku Prof. Dr. Berger u interesua më tepër që të mëson për organizimin dhe traditën e Islamit në Maqedoni.

" BFI-ja ka strategji afatgjate për kultivimin e Islamit burimor në baza të shëndosha duke filluar nga kultura familjare, mektebet e ndryshme, xhamitë dhe së fundi me hapjen e Medresesë dhe shpërndarjen e paraleleve të saj nëpër disa qytete të vendit dhe përfundon me edukimin akademik pranë Fakultetit të Shkencave Islame", theksoi ef. Rexhepi.

Kreu i BFI-së gjithashtu e njoftoi ekspertin holandez se gjatë sistemit monist shumica e profesorëve që tani ligjërojnë fenë islame tek ne kanë studiuar nëpër vendet të tjera.

"Tani është krejt tjetër, BFI-ja është e gatshme që të krijojë kuadro profesionale dhe me të njëjtit mund ti konkurroj botës", theksoi Rexhepi.

Kjo zgjoi kureshtjen e mysafirit sepse edhe Mbretëria Holandeze, por edhe shtetet e tjera evropiane janë të interesuar që të ofrojnë arsim më kualitativ për muslimanët atje, duke u bazuar në kuadrot e tyre, e njëkohësisht duke mos lënë shumë hapësirë për ndikimet nga jashtë, që në raste të veçanta mund të predikojnë ekstremizmin apo të nxisin situata të padëshiruara..

"Arsimi dhe edukimi fetarë janë shtyllat e forta për ta shkatërruar radikalizmin dhe ekstremizmin në fe", theksoi ef. Rexhepi i cili nënvizoi se duke u bazuar në eksperiencat e shumta të bashkëpunimit të mirë me universitete të ndryshme të Botës siç janë Universiteti i Az'harit, Vjenës, ato në Turqi dhe ato të Botës arabe, Fakulteti i Shkencave Islame ka lidhur ura bashkëpunimi që prodhojnë fryte, ndërsa në frymën e këtij bashkëpunimi Reis ul Ulemaja i bëri ftesë profesorit holandez që një urë bashkëpunimi të kësaj natyre, të fillojë edhe me Fakultetin Islamik në Universitetin "Laiden" të Holandës me qëllim që Islami të filloj të mësohet në Perëndim duke marrë për bazë burimin e vërtetë.

"Kjo do të ndikonte në uljen e islamofobisë evropiane, sepse sa më pak fobi të ketë ndaj një feje, aq më të pakta do të jenë tentimet për radikalizëm dhe ekstremizëm fetarë", theksoi Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi .

## UNIONI I STUDENTËVE TË FSHI-SË NË VIZITË TË RIJASETIT

# Studentët - forca e BFI-së



Të hënën më datë 12 Prill 2010 Unioni i Studentëve të Fakultetit të Shkencave Islame, të udhëhequr nga Mexhit Osmani, ishin në lokalet e Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame dhe u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së H. Afrim ef. Tahiri. Ata e falënderuan Rijasetin e BFI-së në krye me Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, për investimet që janë bërë në FSHI, rreth përmirësimit të ambientit dhe kushteve për punë në të njëjtin fakultet, sipas të cilëve tanimë i vetmi problem mbetet rruga dhe ata ashtu siç janë shprehur kohë më parë në një nga konferencat për shtyp para kompleksit Suli Ann - Shkup, ku Unioni i FSHI-së shpreh gatishmëri që në hapat e mëtutjeshme të Rijasetit të BFI-së të japin kontributin e tyre gjithandej ku kërkohet nevoja.

Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm H. Afrim ef. Tahiri, i njoftoi drejt për drejt studentët me aktivitetet që Bashkësia Fetare Islame i ka ndërmarrë së fundmi, në drejtim të angazhimeve për trajtim të barabartë me bashkësitë e tjera fetare në vend dhe u garantoi studentëve se kjo punë është edhe obligim i tyre hyjnor dhe kushtetues. Bashkësia Fetare Islame shprehu gatishmëri për mbështetjen e projekteve të studentëve në dobi të zhvillimit të tyre akademik dhe në dobi të shoqërisë në përgjithësi.

# BFI dhe ITSHK firmosën marrëveshje për bashkëpunim

*Më 13.04.2010, Shkup*



Duke marrë parasysh interesin e dyanshëm për zhvillimin dhe bashkëpunimin institucional në sferën e procesit kulturor-arsimor, fetar dhe të hulumtimeve kërkimore – shkencore me interes të veçantë kombëtar, e në mbështetje të statuteve të tyre Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë e përfaqësuar nga kryetari Reis Ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, në njërën anë, dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, të cilin e përfaqëson Prof. Dr. Ramiz Abdyli , lidhin marrëveshje për bashkëpunim për botimin e punimeve shkencore të studiuesve të njërës dhe palës tjetër në revistat dhe publikimet që do të rezultojnë nga puna e tyre hulumtuese-kërkimore.

Marrëveshja parasheh që palët të shkëmbejnë informata të përbashkëta për botimin të dokumenteve, dhe botimeve të tjera në sferën e interesit të veprimtarisë së tyre me karakter shkencor kulturor-arsimor, fetar si dhe në sferën e hulumtimeve kërkimore– shkencore.

Po ashtu palët obligohen që të ofrojnë informata dhe bashkëpunim, si dhe dokumente me interes për procesin kulturor dhe kërkimor–shkencor për historinë e BFI-së dhe myslimanëve të Maqedonisë e të rajonit dhe më gjerë.

Të dy institucionet bashkërisht do të angazhohen për shkëmbimin e ekspertëve të njëra - tjetrës për periudha dhe fusha të caktuara në procesin kërkimor– shkencor .

*Sektori për marrëdhënie me publikun i BFI-së*

# Kumtesë për opinion




Ditë më parë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame H. Sulejman ef. Rexhepi me bashkëpunëtorët e tij realizoi një takim me kreun shtetëror të Republikës së Maqedonisë, më saktësisht me Kryetarin e Shtetit z. Ivanov dhe me Kryeministrin e Qeverisë z. Gruevskin. Në këtë takim morën pjesë bashkëpunëtorët e tyre më të ngusht si dhe disa Ministra të kabinetit qeveritarë.

Në këto takime u bisedua për disa çështje të cilat e preokupojnë BFI- por edhe opinion e gjerë në vend siç janë: 'Shkupi 2014' respektivisht rindërtimi i Burmali Xhamisë, denaciaonalizimi i pronës së vakfit, problem i xhamisë në Prilep si dhe xhamia në fshatin Lazhec të Manastirit.

Edhe pse është shprehur dëshirë dhe gatishmëri që të gjendet zgjidhje për këto çështje, Bashkësia Fetare Islame në RM edhe më tej nuk ka marrë përgjigje konkrete për zgjidhjen e çështjeve të sipërpërmendura.

Dje Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame të RM, mbajti mbledhjen e saj të rregullt në të cilën u shqyrtuan raportet e organeve dhe enteve të BFI-së e sidomos u shqyrtuan çështjet e sipërpërmendura me të cilat po ballafaqohet Bashkësia Fetare Islame e RM.

Anëtarët e Kuvendit të BFI-së i dhanë përkrahje të parezervë Reis ul Ulema dhe Rijasetit të BFI, që edhe më tej fuqishëm të qëndroj në kërkesat e saj me të cilat mbrohen interesat e BFI dhe të muslimanëve në vend.

Në rast se këto çështje nuk zgjidhen në favor të BFI-së me të cilat po diskriminohet Bashkësia Fetare Islame e RM, Kuvendi i BFI kërkoi nga Rijaseti i BFI, se nuk ka bazë morale dhe etike që ajo të jetë pjesë e Konferencës për dialog ndërfetarë dhe ndërkulturorë e cila planifikohet që të mbahet në Ohër nga 06 – 09 maj 2010, dhe për qëndrimin e saj të informojë Bashkësitë Fetare dhe asociacionet ndërkombëtare, llojet e ndryshme të organizimit fetar islam si dhe personalite të shquara në Evrope dhe botë.

Pjesëmarrja jonë në gurëthemel të objektit të Ministrisë së Punëve të Jashtme ishte edhe një mesazh për bashkëjetes, me këtë rast për herë të parë arritëm që në një solemnitet të këtill të paraqiten në mënyrë të barabartë përfaqësuesit e pesë bashkësive fetare në R.M.

*15.04.2010, Shkup*
*Sektori për marrdhënie me publikun i BFI-së*

## QEVERIA TË MOS UZURPON DHE KEQPËRDOR PRONËN E BFI-SË

# BFI fton zëdhënësit e popullit mysliman në Parlamentin e Maqedonisë

Më 20.04.2004, Bashkësia Fetare Islame organizoi Pres Konferencë për mediat e shkruara dhe elektronike para së cilave u prononcua Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi lidhur me Propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për denacionalizim.

Reis Ulema i BFI për mediat shprehi se:

"Qeveria e Maqedonisë vazhdon me politikën e saj diskriminuese dhe islamofobe.

Ne edhe një herë i dhamë shancë kësaj Qeverie që të përmirësohet me politikën e saj mirëpo hapi i fundit



për të ndryshuar Ligjin për denacionalizim na jep shenja të qarta se kjo Qeveri në vend që të krijoj kushte për të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët , në vend që të hapëroj drejt BE dhe NATO, ajo ka zgjedhur diskriminimin, shkeljen deri në flagrancë të të drejtave të qytetarëve, uzurpimin e pronës së huaj, nacionalizimin më keq se në komunizëm.

Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për denacionalizim nuk është asgjë tjetër vetëm se edhe një tentim i Qeverisë së Maqedonisë për nacionalizimin e dytë të pronës së BFI-së.

Me këto ndryshime, shteti dëshiron që të shpallë veten pronarë legjitim të vakufit dhe të pamundësoj kthimin e tij tek pronarët e vërtet. Nëse Ligji për denacionalizim më parë ka kërkuar që prona mund të kthehet tek pronari i vërtetë nëse nuk ka pengesa juridike dhe faktike deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për denacionalizim, tani ky afat shtyhet në momentin e vendosjes.

Duke marrë parasysh se denacionalizimi tek ne po zgjat 12 vite për gjithë këtë kohë janë bërë uzurpime dhe keqpërdorime të ndryshme të pronës së nacionalizuar të BFI-së dhe janë paraqitur shumë pengesa juridike dhe faktike të reja të cilat nuk kanë ekzistuar në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për denacionalizim.

BFI-ja ka dhjetëra kërkesa vetëm për denacionalizim vetëm në Çarshinë e Vjetër, dyqane, Hane, Hamame….. Me ligjin ekzistues shteti është i detyruar që ta kthejë këtë pronë tek pronari i vërtet dhe nuk ka asnjë pengesë juridike. Me ndryshimet e reja paraqitet një pengesë e madhe faktike dhe juridike, për kthimin e pronave tek pronari i vërtet. Me miratimin e Ligjit për Çarshinë e Vjetër e gjithë Çarshia shpallet zonë e mbrojtur me ligj e rëndësisë së veçante.

Ligji për denacionalizim (Neni 7) nuk lejon kthimin e pronave që janë monumente të kulturës nëse ato janë “të rëndësisë së veçante” ndërsa me Ligjin për Çarshinë, BFI-së i pamundësohet kthimi i pronës së nacionalizuar në këtë zonë të mbrojtur me ligj. Deri tani kjo pengesë juridike nuk ka ekzistuar ndërsa ndryshimet e reja bëjnë që Kapan Hani, Suli Hani, Bezisteni, Tetari i fëmijëve dhe dhjetëra dyqane të tjera të vazhdojnë të mbesin pronë e shtetit duke përjashtuar përfundimisht elementin mysliman nga Çarshia e vjetër. Thjeshtë këto ndryshime që i bën kjo Qeveri po sllavizojnë Çarshinë e vjetër deri në palcë dhe lejojnë që shqiptarët të jenë vetëm qiraxhinjtë në pronën e tyre.

Po ashtu me Ligjin për denacionalizim ka qenë e ndalueshme që të shfrytëzohet prona që është në procedurë të denacionalizimit ndërsa me ndryshimet e reja shtetit i lejohet shfrytëzimi i pronës që është në procedurë të denacionalizimit, nëse kërkesa për denacionalizim nuk është regjistruar në Librin publik e të drejtave të patundshmërisë.

Ligji ekzistues deri tani nuk ka paraparë normë që kërkesat e denacionalizimit të regjistrohen në Librin publik dhe shteti e din se BFI-ja nuk ka të regjistruar asnjë kërkesë në këtë libër kështu që shteti duke futur këtë normë , vetes i jep të drejtën që të shfrytëzoj tokën dhe pronën e huaj që është në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe konventat ndërkombëtare ku e drejta e pronës është një e drejtë e patjetërsueshme.

Në fakt edhe Ligji për denacionalizim kështu siç është nuk e ka as formën e ligjit, meqë më shumë përhap konfuzion sesa rregullon një materie që tani e 10 vite është bërë burim i fërkimeve.

Nga 350 kërkesa sa ka bërë BFI-ja ku kërkon kthimin e 3. 869.806,00 m2 tokë përfshirë këtu livadhe, ara, kullosa, male dhe të tjera si dhe 41.258 m2 objekte përfshirë banesa, shtëpi dhe dyqane, pas 12 vitesh denacionalizim vetëm 10 për qind të pronës kemi arrit që ta kthejmë.

Sa për ilustrim:

Në Shkup nga 127 kërkesa vetëm 10 prej tyre janë të plotfuqishme;

Në Manastir nga 56 kërkesa për mbi 180 parcela kadasatrike vetëm 15 prej tyre janë të plotfuqishme;

Në Kumanovë nga 10 kërkesa , vetëm 1 e plotfuqishme;

Në Prilep nga 4 kërkesa për dhjetëra parcela kadastarike asnjë e plotfuqishme

Po ashtu në Dibër, Ohër, Negotinë, Shtip, Veles, Kavadarc dhe gjithë Maqedoninë lindore situata është e njëjtë.”

Ai gjithashtu shtoi se kjo politikë e Qeverisë nuk i shërben bashkëjetesës në Maqedoni:” Qeveria e Maqedonisë me këtë politikë dërgon sinjale se ajo nuk është për bashkëjetesë, nuk është për një shtet multietnik, multifetar dhe demokratik.

Qeveria e Maqedonisë edhe një herë po bëhet shtylla e ndarjes së qytetarëve në baza etnike dhe fetare, ajo po thellon hendekun e urrejtjes dhe ndasisë që është një politikë që bie ndesh me vullnetin e qytetarëve, pavarësisht përkatësisë etnike dhe fetare. Qeveria e Maqedonisë nëse nuk ndryshon kursin politik shtetin do ta kthej drejt kryqëzatave të cilat lanë pas vete vetëm viktima, urrejtje, ndasi dhe dhimbje.

Ne edhe një herë bëjmë apel se jemi për bashkëjetesë, jemi për integrimin e vendit në BE dhe NATO, jemi për të respektuar njëri tjetrin dhe krejt së bashku të ndërtojmë një shtet të fortë ku do të respektohen të gjithë.

Por edhe një herë potencojmë se durimi ka kufij dhe kupa e durimit më është mbushur, për këtë arsye Qeveria duhet të mbaj llogari sepse çdo eskalim i gjendjes do të jetë i dëmshëm për të gjithë ne dhe e vetmja fajtore do të jetë AJO. Me këtë rast apelojmë tek të gjithë zëdhënësit e popullit mysliman në Parlamentin e Maqedonisë që të jenë më vigjilent, ti thonë STOP ndryshimit të Ligjit për denacionalizim sepse në të kundërtën do të tradhtojnë amanetin e dhënë.”

# U vë gurthemeli i Xhamisë Arasta në Çarshinë e vjetër të Shkupit

Sot më 22 prill 2010 në Çarshinë e vjetër të Skupit u bë hudhja e gurëthemelit të Xhamisë Arasta në Çarshinë e vjetër të Shkupit.

Në këtë ceremoni mjaftë me peshë si për Bashkësisnë Islame në RM ashtu edhe për qytetin e Shkupit, përveç kreut më të lartë të BFI-së në krye më Reis ul Ulemanë h.Sulejman ef. Rexhepi, morën pjesë edhe shumë autoritete relevante të vendit tonë si dhe një numër i konsiderueshëm qytetarësh. Përveç Myftinjëve të Myftinive të BFI-së, në këtë akt solemn morën pjesë përfaqësuesi i Ambasadës së Turqisë njëherit përgjegjës për çështje kulturore e fetare z. Bahatin Bildik, Zëvendësambasadori i Ambasadës së R. së Shqiprisë, përfaqësues të Ambasadave dhe përfaqësues të Misionit të OSB-së të akredituar në vendin tonë, përfaqësuesi i Partisë Demokratike Shqiptare z. Enver Loku, Kryetari i Partisë Demokracia e Re z. Imer Selmani, Kryetari i Komunës së Haraçinës z. Bastri Ba-



jrami, përfaqësuesi i Shoqatës së Esnafëve të Çarshisë së vjetër z. Muhidin Braha, përfaqësues të Institutit Albanologjik në Shkup si dhe përfaqësues Organizatave Civilie dhe shumë mysafir të tjerë.

Ceremonia e këtij akti solemn u hap me këndimin e pjesëve të Kur'anit Famëlartë nga hfz. Mr. Abaz Jahja përgjegjës i shërbimit për Kulturë pranë BFI-së, ndërsa prezentimin e programit së këtij manifestimi e bëri Skender Buzaku i cili përveç që falëndoroi Kreun e Bashkësisë Fetare Islame për pjesëmarrjen e tyre dhe të mysafirëve tjerë, falënderoi edhe Këshillin iniciativ për rindërtimin e këtij objekti, për punën e palodhshme që kanë bërë deri më tani në krye me Aziz Zymerin.

Në fjalën e tij të rastit Reis ul Ulema H. Sulejman ef Rexhepi pasi që përshëndeti të pranishmit që morën pjesë në këtë akt historik për BFI dhe muslimanët e këtij nënqielli theksoi se rindërtimi i këtij objekti ishte nevojë immediate për banorët dhe xhematin e Çarshisë së vjetër. Në vazhdim Reis ul Ulema foli për rëndësinë e xhamisë, rolin e saj në shoqëri si nga aspekti edukativ ashtu edhe nga aspekti shpirtëror. Ajo do të shërbejë në kultivimin e vlerave shpirtërore, morale e kulturore, vlera për të cilat ka më së tepërmi nevojë bota por edhe besimtarët e vendit tonë.

# Islami tek shqiptarët e Maqedonisë është pjesë e identitetit kombëtar

Sot paradite më 15.04.2010, Reis ul Ulema i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm Afrim ef. Tahiri, Myftiu i Myftinisë së BFI-Tetovë, operativa e myftinisë, Imami i xhamisë së Larme dhe kryetari i komunës së Tetovës, Prof. Dr. Sadi Bexheti e pritën eminencën e tij, Presidentin e shtetit Shqiptar, z. Bamir Topi në xhaminë e Pashës e njohur si xhamia e Larme në Tetovë.



Reis ul Ulema në fillim i shprehi mirëseardhje në emër të institucionit dhe në emrin e tij personal, duke theksuar se jemi të nderuar që vizitoni R. Maqedonisë, Bashkësinë Fetare Islame

respektivisht këtë xhami në këtë vend të veçant. Më pastaj z. Topi falënderoi për mikëpritjen që iu bë duke shtuar se :" Jam i nderuar që jam tani në mesin e juaj në këtë vend( faltore) dhe se ndjehem mjaft i emocionuar ngase vetëm feja na bënë të atill të plotësohemi dhe se feja (besimi) është vlerë për të cilën kemi nevoj. Ne, juve këtu u urojmë për misionin që e keni, punën që po realizoni dhe kontributin që e jepni për të mirën e përgjithshme. z.Topi më tej shtoi : " Ju e dini se në Shqipëri nga 1967 u pengua feja mirëpo, ajo nuk zgjati edhe aq, por tani shihet një ringjallje e jetës shpirtërore e qytetarëve të R. Shqipërisë që është për t'u përshëndetur.

Reis ul Ulema gjatë bisedës u ndërlidh në faktin se Islami tek shqiptarët e Maqedonisë është pjesë e identitetit kombëtar. Dhe se neve kemi për obligim që këtë vlerë ta ruajm me pastërtinë që ka.

Ndërsa, prof. dr. Sadi Bexheti shtoi se: "Islami ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe se kjo është një e vërtetë e pamohuar.

Në fund mbi historikun e kësaj faltore dhe arqitekturën e xhamisë së Larme gjegj. Xhamisë së Pashës, z. Topin e njoftoi Dr. Metin Izeti.





# Të freskëta janë ndytësirat tuaja në mendjet tona

Myftinia e BFI- Shkup reagon ndaj deklaratave të turpshme të Behixhudin Shehapit.

Më 23.04.2004, Myftinia e BFI- Shkup organizoi Pres Konferencë për mediat e shkruara dhe elektronike para së cilave u prononcua zëdhënësi i Myftinisë, Skender Buzaku lidhur me deklaratat të turpshme të Behixhudin Shehapit që kishin të bënin me Arasta xhaminë.

Skender Buzaku në prononcimin e tij para mediumeve të shkruara dhe elektronike shprehi se:

"Muftinia e Shkupit përmes kësaj Press konference për shtyp dëshiron t'u bëjë me dije qytetarëve mysliman se është tepër krenare që me datë 22-04-2010 hudhi gurthemelin për rindërtimin e xhamisë Arasta në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

Duke patur parasysh se xhamia në fjalë graviton në Myftininë e Shkupit ne do të bëjmë çmos që jo vetëm këtë xhami por edhe objekte dhe prona të cilat gravitojnë në Myftininë e Shkupit të kthehen sa më parë në pronësi të pronarit të vërtetë.

Muftinia e Shkupit ndien për obligim që t'i informoj qytetarët e vendit se Behixhudin Shehapi nuk ka asnjë të drejtë juridike dhe morale të flet se a kemi apo jo të drejtë për rindërtimin e kësaj xhamie, duke patur parasysh se ky objekt fetar është shkatëruar nga tërmeti i vitit 1963, dhe se për të njëjtin sipas nenit 65 të ligjit për ndërtim nuk është e domosdoshme që të sigurohet leje ndër-

timi.

Juve z. Shehapi paraqiteni shumë vonë atë që e quani vlera kulturore, ngase më herët nuk e keni parë të arsyeshme të reagoni asnjëherë sa i takon punimeve të paligjshme që janë zhvilluar në xhaminë e Jahja Pashës në Shkup, Mihrabit në Urën e Gurit-Shkup, ligjin shumë të dëmshëm për revitalizim të Çarshisë së vjetër-Shkup e shumë shkelje tjera të cilat po ju bëhen objekteve fetare Islame edhe jashtë qytetit të Shkupit.Paraqitjet e juaja në mediume kundër rindërtimit të xhamive na jep sinjale të qarta se juve më tepër kontriboni për ndërtimin e kishave dhe manastireve se sa për xhamitë.

Mos mendoni se ne kemi haruar për atë që sa punë të ndyta keni bërë në të kaluarën në Institucionin e BFI-së në RM. Ju me pa të drejtë në vitin 2003 e plaçkitët dhe përvetësuat Organizatën humanitare El Hilal të cilën Bashkësia Fetare Islame në RM e kishte themeluar në vitin 1987, dhe që nga atëherë ju nuk keni moral që të flitni për diçka që ka të bëjë me mbrojtjen e jetësimin e objekteve fetare, por atë amoralitet të së kaluarës po e reflektoni edhe këto ditë duke kërkuar pengimin e punimeve në këtë xhami.

Duhet të dini se ju nuk jeni ata që keni të drejtë të siguroni donacione për rindërtimin e xhamive dhe objekteve fetare, për këtë gjë jemi të thirrur vetëm neve si Institucion fetar. Ne si Muftini e Shkupit ju tërheqim vërejtjen që të mos fërkoheni dhe ti futni hundët nëpër xhamitë e Shkupit, andaj qëndroni atje ku e keni vendin dhe vazhdo t'i kontribuosh diskriminimit ndaj BFI-së dhe myslimanëve të Maqedonisë ashtu siç po bëjnë edhe ata që nuk i takojnë fesë Islame.

# Cili është dallimi mes Komunës Qendër dhe të Çairit



Më 27. 04. 2004, Myftinia e BFI-Shkup organizoi Pres Konferencë për mediat e shkruara dhe elektronike para së cilave u prononcua Myftiu i Myftinisë së Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, i cili theksoi:

Muftinia e BFI Shkup është e detyruar që të mban press,që për hirë të së vërtetës të drejtëinformohen besimtarët në territorin e Mutinisë së Shkupit dhe më gjërë. Është turp nga Komuna e Çairit të mbajë Press konferencë kundër ndërtimit të xhamisë.

Ne si Muftini e Shkupit shumë herë i jemi drejtuar Komunës së Çairit me kërkesë për leje për rindërtim të xhamisë së Arastës, por kërkesat tona mbaronin ne sirtaret e zyrava të komunës, nuk e dinim pse? Këshilli i formuar për rindërtimin e xhamisë Arasta në krye me Haxhi Aziz Zimerin si dhe ne si Muftini e Shkupit konstatuam se një leje e tillë nga një Kryetar i një komunë Shqiptare për fat të keq nuk mund të sigurohet se për cilat shkaqe ai duhet të tregoj.

Nga arsyeja se edhe me ligje, kërkesës zyrtare duhet t'i jepet përgjigje brenda një afati kohor prej 15 ditëve qoftë pozitiv apo negativ, sepse përndryshe heshtja e administratës nënkupton pajtimin pozitiv në lidhje me atë kërkesë.

Por si duket nga përovoja e hidhur me rindërtimin e xhamisë Hatunxhuk 2007 na bënë që të mos ia besojmë punët tona Komunës së Çairit, por të i përmbahemi ligjit, dhe ashtu siç e dinë edhe populli "Xhamia dhe Medrese ndërton dhe do të rindërtoj Bashkësia Fetare Islame, e jo komunat dhe institucionet tjera ,ata kanë shumë punë tjera me cka duhet dhe kanë mandat të merren.

Xhamitë ndërtohen për Allah, dhe jo për atë që thoshte Izet Mexhiti, nga i cili neve nuk presim të na tregoj vaz dhe nasihat, por duhet t'u përgjigjet kërkesave të institucionit tonë, e jo të njëjtat të anashkalohen pa arsye dhe në kundërshtim me ligjin.

Si duket përmes Arasta xhamisë dikush paska dashur të përfitoj materialisht, por edhe të imponoj lëvizje të ndryshme radikale, si ata të jomedh'hebive,e të tjera, siç ndodhi me xhaminë e Hatunxhukut-Shkup.

Me rindërtimin e Arasta xhamisë neve na u paraqit njëfarë Behixhudin Shehap, në cilësi të drejtorit të Qendrës për konzervim në nivel Republikan, me të cilin neve si Muftini e Shkupit as që duhet të kemi punë, neve kemi kordinim me qendrën për

konzervim në nivel te qytetit të Shkupit, ku edhe e kemi prezentuar projektin ideor të Arasta xhamisë, nga i cili ishim te udhëzuar që ta kompletojmë lëndën me lejet e duhura nga komuna, të na jepet çertifikatë të planit detal urbanistik, të na siguron kushte lokale për rikonstruimin e \xhamisë e tjera, ata të Komunës së Çairit na e marrin projektin qe e kemi pagur 5000 euro, investitor i të cilës është vetë Bashkësia Fetare Islame në RM dhe të njëjtin nuk na kthen, kjo çudi ndodh vetëm në Komunën e Çairit-Shkup.

Mirëpo si duket Behixhudin Shehap i ashtuquajturi kryetar i këshillit koordinativ për rindërtim të Burmali xhamisë, qenkan edhe kundër Arastës, vetëm pse komuna e Çairit nuk arriti ta implementon planin e ngjashëm me Hatunxhukun. Tani haptas pyesim si është e mundur që ky far i ashtuquajtur këshill koordinativ të jetë për Burmali xhaminë, ku vetë kryetari i këtij këshilli të ashtuquajtur Behixhudin Shehap është kundër Arastës dhe kërkon plotësim të procedurave, a në fakt Arasta është me fletë pronësie tokë në pronën e BFI, kurse atje ku shpërndaheshte bakllava në vendin e Burmalisë, de jure ai vend që nga viti 1925 nuk është në pronësi të BFI, atëherë pyesim Behixhudin Shehap si kryetar këshilli i këtij këshilli të ashtuquajtur koordinativ cilat procedura do i respektojë?

Reis ul Ulema H.Sulejman ef. Rexhepi nëse u kujtohet kishte deklaruar se dita që do të fillohet ndërtimi i Kishës, Bashkësia Fetare Islame do të vendosë gurthemel të Burmali xhamisë, i pyetur edhe pa leje? Pergjigja ishte po, sepse aty ka pasur xhami! Pra pa respektuer procedura. Parashtohet pyetja:A do të pengoheshim nga i ashtuquajturi kryetar i këshillit koordinativ për rindërtimin e Burmali xhamisë në krye me Behixhudin Shehap?

Dhe atëherë në fakt cili do ishte dallimi mes Komunës Qendër dhe të Çairit?

### KONFERENCA E DYTË NDËRFETARE DHE NDËRCIVILIZUESE NË OHËR

# Domosdoshmëria e dialogut ndërfetarë dhe ndërkulturorë




Konferenca Botërore për Dialog Ndërfetar dhe Ndërcivilizues " Feja dhe Kultura- lidhje e pashkëputur mes popujve" Ohër, 06- 09 Maj 2010

Shoqëritë kanë nevojë për kooperim dhe bashëkpunim ndërinstitucional që në mënyrë kontinuitive të tejkalojnë problemet, stereotipet, dallimet dhe mosmarrëveshjet që janë të pranishme në mesin e tyre. Kemi shoqëri multikonfesionale dhe multikulturore të cilët për çdo ditë mund të hasim mostolerancë dhe mungesë të dialogut dhe se konferencat me karakter ndërkombëtar mund të ndihmojnë shumë në linjën e e mirëkuptimit dhe afirmimin e vlera. Porositë që dilën nga liderë fetar ishin të karakterit se mungesa e dialogut ndërfetar dhe ndërshoqëror është një paftësi e mirëkuptimit të njeriut modern. Të njëjtit lider dërguan mesazhe qeverive aktuale që të ndihmojnë bashkësitë fetare në promovimin e dialogut dhe respektimit të dallimeve fetare dhe kulturore tek shoqëritë. Klasa politike mund të ndihmojë fuqishëm në ngritjen e vlerave universale që promovojnë fetë për bashkjetesë dhe respekt të ndërsjellt. Porositë e liderëve fetar vazhduan deri në atë masë që të gjithë bashkarisht të ndihmojmë njëri-tjetrin për të krijuar një faqe të re të historisë së njerëzimit, hap i cili do të bënë që tani e tutje ndarjet të jenë një e kaluar e haruar. Kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski në hapjen e konferencës tha se toleranca është mënyra e vetme për të jetuar në këtë botë.

"Toleranca nuk është lëshim pe dhe nuk guxon të kuptohet si dhënie të asaj që e posedon. Edhe pse është e vështirë, por megjithatë duhet të tolerohen edhe ata që nuk kanë qëllime të mira,....", deklaroi Nikolla Gruevski, kryeministër i RM –së. Pjesëmarrësve iu drejtua edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi i cili mes tjerash theksoi se: "Nga e kaluara e largët, nga koha e Ademit dhe paraqitjes së tij në këtë botë, njeriu krijon vlera shpirtërore dhe materiale në bazë të kushteve të jetesës dhe përvojës së fituar. Ashtu dhe sot, mund të flasim për pafundësi kulturash, pafundësi civilizimesh, pafundësi përvojash religjioze, por të gjithë këto janë pasqyrë e dëshirës së një Krijuesi të përbashkët, Krijuesit të gjithësisë, e ai është Allahu xhele xhelaluhu." Në këtë konferencë morrën pjesë rreth 450 personalitete nga afër 40 shtete të botës.

# Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra

Ngjashmëria mes popullit të Adit dhe Ramadanit me kompaninë.

Kush gënjen më shumë? Ramadan Ramadani apo Behixhudin Shehap.

Ditë më parë i ashtuquajturi Këshilli i Burmalisë ka përgënjeshtruar Myftininë e Shkupit, e cila në akuzat drejtuar Behixhudin Shehap e përmend atë si kryetar të Këshillit për ndërtimin e Xhamisë Burmali.

Myftinia e tha një të vërtet, pavarësisht se ajo sa mund të jetë e dhimbshme . Reagimi i Ramadanit si kodër pas diellit tregon se ai ka mizën nën kësulë. Nga të gjitha që tha Ramadani vetëm një ishte e vërtet se i ashtuquajturi Këshilli është formuar në shkurt të vitit 2008. Gjithçka tjetër ishte vetëm llomotitje sa për të bërë zhurmë.

Se B. Shehap është kryetar apo ka qenë i tillë është një e vërtet e madhe që se luan topi, por krejt varet nga ajo se sa Ramadan Ramdani i do të vërtetat dhe i ka për qejfi.

Gënjeshtra është interpretim i gabuar e i qëllimshëm i së vërtetës, por thotë populli se ajo i ka edhe këmbët e shkurtra. Gënjeshtra e thënë në televizionin Alsat-M nga Ramadan Ramadani është një interpretim i gabuar i së vërtetës e që ka për qëllim arritjen e një qëllimi përfitues dhe asgjë më shumë.

Populli e ka të freskët ende paraqitjen fontome të këtyre këshillave që dolën me qëllim për të legalizuar projektet antishqiptare të Qeverisë Maqedonase. Myftinia e Shkupit e mban mend të shtunën e shkurtit të vitit 2008 kur në Holiday Inn bënë publike kërkesat e tyre gjoja 76 shoqata të cilat për kryetar kishin zgjedhur Behixhudin Shehap dhe letra e ashtuquajtur "e mirëkuptimit" dërguar kryeministrit Gruevski mbante vulën qendrore të vet Behixhudin Shehap.

Mirëpo si erdhi deri tek shkarkimi nga posti, ndërrimi i strukturës dhe të tjera asnjëherë se morëm vesh. Kjo na bën të dyshojmë se B. Shehap u bë kryetar vetëm e vetëm ti vardiset ndonjë parti që të marrë pozicionin e drejtorit që ka sot. Apo B. Shehap "lufton" për xhamitë varësisht se a është në pushtet apo jashtë tij. Si duket peshorja e B. Shehap për të kërkuar diçka për xhamitë është pushteti. Deri sa është jashtë saj kërkon diçka ndërsa kur ulet në kolltukun qeveritar , jo vetëm që harron ato që ka kërkuar por shkatërron edhe disa të tjera.

Ne mund të kuptojnë frikën e B. Shehap se nëse vazhdon të jetë kryetar i të ashtuquajturit Këshill koordinativ mund të rrezikoj vendin e punës, por nuk mund të kuptojmë brengën e Ramadanit për ta mbrojtur B. Shehap.

Edhe po që se nuk është më B. Shehap kryetar por vazhdon të mbesë anëtarë, sekretar, zëdhënës s'ka rëndësi, mjafton të kuptohet se nga kjo zhurmë mund të kuptohen qëllimet e dyshimta dhe se kush po i koordinon punët e këtij të ashtuquajturi këshill koordinativ dhe se kuadër i kujt janë B. Shehap dhe "avokati" i tij R. Ramadani.

Ju o Ramadan, thoni se është themeluar i ashtuquajturi këshill në shkurt të vitit 2008. Por zgjimi juaj është pak i vonshëm ngase Qeveria në janar solli vendimin për ndërtimin e kishës. BFI-ja kërkesën e saj e ka dërguar shumë herët para jush , që nga 20 prilli 2007. Ju në vend që ti bashkëngjiteni institucionit fetarë dhe të ndihmoni atë në realizimin e saj që ka bërë para jush, ju zgjodhët të merrni rrugën lanetit dhe në vend që të ndihmoni vazhdoni të ngatërroni hesapet.

Themeluat gjoja se një këshill, por edhe themelimi i tij sidomos kur themelohet për xhami i ka disa marifete. Ti, besoj i din shumë mirë këto marifete si i punësuar fetarë dhe nuk dua të marr rolin e "hatibit" për ty sepse je vetë i tillë në Xhaminë e Isa Begut.

Ti o Ramadan e din mirë se sa norma dhe rregulla qoftë fetare, qoftë kushtetuese, qoftë morale brenda institucionit nga merrni edhe bukën, ke thyer me trumbetimet e tuaja nëpër media me qëllim të përfitimit personal. A nuk ke turp? Po ku njeh gënjeshtari turpin. Përveç kësaj dilni në opinion dhe pa tu skuqur fytyra gënjen se B. Shehap nuk është kryetar. Ke filluar të dukesh qesharak. Ndoshta shumë kujt mund tu falet gabimi nga mosdija, por faji, turpi dhe neglizhenca jote po trefishohen kur ke parasysh se je i punësuar në BFI dhe aspak nuk respekton kierarkinë që të detyrohet. T'ia kthesh shpinën institucionit që të shkolloi, udhëzoi në rrugën e drejtë është turp e herezi. Të shkelësh bukën me këmbët e tua është amorale, plëngprishëse, idioteske.

Edhe më keq, të marrësh "shkopin" në dorë dhe të kërkosh diçka nga institucioni fetarë, BFI, për të mbuluar turpin tënd atëherë kalon kufijtë e arsyeshmërisë dhe mirëkuptimit të pa fund që të ka dhënë mu ty o Ramadan.

BFi-ja në agjendën e saj e ka edhe faljen e namazit, si hap për të plotësuar kërkesën e saj për rindërtimin e Xhamisë së Burmalisë. Po këtë hap o Ramadan do ta bëj BFI-ja kur të vlerësoj se është i nevojshëm për tu bërë dhe ti si hatib e din fare mirë se kush janë rregullat për të organizuar faljen e një namazi të xhumasë në një vend të caktuar.

Për në fund, jo që kemi nevojë për ndihmën tënde, por për hir të vërtetës jemi të detyruar që ti tregojmë publikut se ti në këtë rast gënjen për interesa personale të tuat që i dinë vetë dhe së bashku me B. Shehap nuk jeni asgjë më shumë se matrapaz që dilni të "llomotitni" vetëm sa për të bërë zhurmë. Ti e din se çfarë u bëri Allahu xh.sh. popullit të Adit për arsye se ishin gënjeshtar, matrapaz, plangprishës, ngatrraç. Ishalla Zoti ti fal të gjitha dhe nuk të dënon me dënimin e popullit të Adit.

**Rexhep Ziberi**
**Shoqata ILMIJE në R.M**

# A shkon Maqedonia drejt një konflikti të ri etnik me ngjyrime fetare?!

**Nikolla Gruevski është i interesuar për një konflikt të ri etnik me ngjyrime fetare, vlerësojnë analistët. Shqetësime për situatën e krijuar kanë shprehur edhe Bashkimi Evropian, NATO, OSBE dhe SHBA, të cilët një ditë më parë njëzëri kanë shprehur shqetësimet e tyre për tensionet politike në Maqedoni. Thirrjes së ndërkombëtarëve u është përgjigjur BDI, BDK dhe LSDM maqedonase, të cilat kanë porositur që mesazhet të merren seriozisht, ndërsa VMRO ndjehet pjesërisht përgjegjëse për kritikat e marra dje nga Perëndimi për situatën e tensionuar ndëretnike në vend, mirëpo fajin kryesor e hedh te partitë opozitare shqiptare**

**DRITON DIKENA**

Maqedonia vetëm 10 vjet pas një konflikti ndëretnik duket se po rrëshqet drejt një konflikti të ri, po ashtu me ngjyrime etnike. Shpërthimi i ri duket se do të jetë shumë më fatal, nëse në të përzihet edhe aspekti fetar.

Analistët shprehin pesimizëm për veprimet e fundit të qeverisë, sidomos prishjes së marrëdhënieve fetare edhe mes komunitetit maqedonas të fesë ortodokse e atij shqiptar të fesë islame.

Duke analizuar veprimet e qeverisë katërvjeçare, do të shohësh se ka pasur njëra pas tjetrës provokime etnike, si enciklopedia, evidenca pedagogjike, maqedonishtja nga klasa e parë, refuzimi i përdorimit të shqipes në nivel shtetëror, moszgjidhja e statusit të ish-luftëtarëve të UÇK-së, hapja e katër lëndëve të Hagës e të tjera. Duke parë se partitë politike shqiptare tani bëhen promotore të ndaljes së një konflikti të ri etnik, siç thonë analistët, topi i provokimeve kohën e fundit është hedhur mbi petkun fetar. Nervozizmi është rritur nga projekti "Shkupi 2014", ku përveç se nuk është përfshirë aspak kultura shqiptare, është paraparë të ndërtohet në qendër të Shkupit "Kisha Shën Elena dhe Konstatini", ndërkohë që nuk është paraparë ndërtimi i Xhamisë Burmali. Edhe selamet e Bashkësisë Fetare Islame se ngelet në qëndrimin e saj për të bojkotuar Konferencën ndërkombëtare për dialog ndërfetar dhe ndërkulturor, japin shenja se kryeministri aktual Nikolla Gruevski është i interesuar për një konflikt të ri etnik me ngjyrime fetare.

Analistët po ashtu shprehin brengosje ndaj deklaratave të mëhershme të kreut të PDSH-së Menduh Thaçi për luftë. Reagimi i tyre, po ashtu ka vënë theks edhe në paralajmërimet e ish-kreut të PDSH-së, Arben Xhaferi, se ai do të tërheq nënshkrimin nga Marrëveshja e Ohrit.

## GRUEVSKI KA SHPREHUR INTERES PËR NJË KONFLIKT TË RI

Analisti Alajdin Demiri thekson se nga kjo që po u serviret qytetarëve, mund të kuptojmë se kryeministri Nikolla Gruevski ka shprehur interes për një konflikt të ri.

"Shqetësuese është fakti që shqiptarët në politikë këtaj radhe duken shumë të pagjendshëm, si BDI, ashtu dhe PDSH e DR, dhe duket se do të jenë pengesa për një konflikt eventual", thekson Demiri, duke nënvizuar se është tragjedi ajo që partitë politike shqiptare për një kohë të gjatë nuk janë duke ofruar asnjë zgjidhje të re. "Në vend të zgjidhjes, ato ofrojnë oportunizëm të thellë dhe status quo, ndërsa kjo politikë faturën e dënimeve e lë mbi supet e shqiptarëve". " Arroganca e Gruevskit, mosrespektimi i Marrëveshjes së Ohrit, refuzimi i çdo kërkese shqiptare, refuzimi i gjuhës shqipe në përdorim shtetëror dhe një mori ligjesh të tjera, që provokojnë thellë substancën kombëtare shqiptare, janë vetëm disa nga arsyet se pse Maqedonia shkon drejt një konflikti të ri etnik", thekson Demiri. Sipas tij, edhe prishja e marrëdhënieve fetare mes dy grupeve më të mëdha në vend është sinjal shqetësues, sidomos paraqitja e disa grupeve të dyshimta të fshehura në petkun fetar. "Faktorë politik më destabilizues për momentin paraqiten edhe disa këshilla koordinues për xhami. Ato nuk kanë mandate politike, por merren me politikë. Nuk kanë vizion politik, por ofrojnë zgjidhje politike dhe çuditërisht gjithmonë ofrojnë variante negative", potencon Demiri, duke shprehur shqetësim se konflikti i ri mund të ketë edhe ngjyrime fetare. "Problemi me emrin dhe sjellja e Gruevskit si patron i pakontestueshëm për zgjidhje fatlume dhe anëtarësimin në NATO dhe BE, janë isharetet se vetëm ai dëshiron konflikt", përfundon Alajdin Demiri, analist.

Shqetësime për situatën e krijuar

kanë shprehur edhe Bashkimi Evropian, NATO, OSBE dhe SHBA, të cilët një ditë më parë njëzëri kanë shprehur shqetësimet e tyre për tensionet politike në Maqedoni, duke ftuar të gjithë faktorët vendorë që të përkushtohen në të ardhmen evropiane të vendit dhe zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit për të drejtat e shqiptarëve. “Duam të theksojmë besimin tonë se integrimi euro-atlantik, si dhe zbatimi i plotë i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MO) mbetet rruga më e mirë drejt progresit për të gjithë qytetarët e vendit dhe për tërë rajonin," thuhet në komunikatën e tyre.

## GJITHË FAJIN E KA VMRO; AJO FAJËSON OPOZITËN SHQIPTARE

Thirrjes së ndërkombëtarëve u është përgjigjur BDI, BDK dhe LSDM maqedonase, ndërsa VMRO edhe dje ka pëlqyer heshtjen për mesazhet ndërkombëtare.

Për BDI-në, mesazhi i ndërkombëtarëve duhet kapur seriozisht. “Përmbajtja e mesazhit, sidomos momenti në të cilin vjen ai, duhet të shërbejnë si sugjerim ndaj gjithë aktorëve politik për atë se cilat janë prioritet themelore të shtetit tonë dhe cilat duhet të jetë qasja ndaj tyre: tri shtyllat kryesore mbi të cilat ndërtohet shteti ynë janë Marrëveshja e Ohrit, dialogu politik dhe integrimet. Po qe se e thjeshtësojmë formulën, ajo do të tingëllonte kështu: paqja ndëretnike (Marrëveshja Kornizë), paqja brendaetnike (dialogu politik), janë parakusht themelor për klimë pozitive me projektet për të zgjidhur kontestin rreth emrit. Shpresojmë se mesazhi do të kuptohet si qëllimmirë dhe do të shërbejë si udhërrëfyes lidhur me atë se në çfarë drejtimi duhet ecur politika jonë e brendshme dhe e jashtme në kohën që vijon“, thekson Ermira Mehmeti, deputete e BDI-së.

Më e ashpër është treguar BDK e Bardhyl Mahmutit. Sipas tij, marrëdhëniet ndër-etnike në Maqedoni së fundi janë në një gjendje tejet të keqe dhe për këtë ai akuzoi qeverinë e udhëhequr nga Nikolla Gruevski. “Tërheqim vërejtjen për mundësi shpërthimi të situatës dhe për të evituar këtë, ftojmë Qeverinë që të ndërmarrë një seri masash për të përmirësuar pozitën dhe të drejtat jo të plota shqiptarëve”, thekson Bardhyl Mahmuti, kryetar i BDK-së.

Edhe partia opozitare maqedonase, LSDM, tha se deklarata e përbashkët e BE-së, NATO-s, OSBE-së dhe SHBA-së duhet të merret parasysh nga qeveria, për t'i zgjidhur çështjet problematike në vend.

Deputeti i LSDM, Emilijan Stankoviq, tha sot se kjo deklaratë e katër faktorëve perëndimorë “paraqet një porosi diplomatike jashtëzakonisht serioze për gjendjen aktuale politike në vend”, duke shtuar se VMRO-DPMNE "përfundimisht duhet t'i përkushtohet zgjidhjes së çështjeve të hapura dhe problemeve".

"Porosia e faktorëve ndërkombëtarë kyç është shumë e qartë. Dukshëm është se Republika e Maqedonisë shmanget nga kursi që ishte dhe duhet të mbetet prioritet i të gjitha qeverive. Ky është kursi i integrimit të tërësishëm në BE dhe NATO, respektimi i Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe përparimi i vazhdueshëm i dialogut politik", deklaroi deputeti i LSDM-së.

Në anën tjetër, partia maqedonase në pushtet, VMRO-DPMNE, ndjehet pjesërisht përgjegjëse për kritikat e marra dje nga Perëndimi për situatën e tensionuar ndër-etnike në vend, mirëpo fajin kryesor e hedh te partitë opozitare shqiptare. "I dërgojmë apel edhe opozitës, ndaj së cilës më së shumti janë adresuar këto vërejtje nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, t'i pranojë të njëjtat dhe të veprojë sipas udhëzimeve", thekson VMRO-DPMNE në një komunikatë. Kjo parti tha se i kupton dhe do t'u japë rëndësi të veçantë të gjitha udhëzimeve të bashkësisë ndërkombëtare dhe të njëjtat i vlerëson si qëllimmira.

Shqetësime për këtë situatë kanë shprehur edhe mbi 40 organizata joqeveritare shqiptare, të cilat kanë paralajmëruar protesta mbarëkombëtare për 10 maj në Shkup.

Edhe deputeti i Demokracisë së Re, Sulejman Rushiti, bëri të ditur qëndrimin e Demokracisë së Re ndaj letrës së përbashkët të ambasadorëve të BE-së, SHBA-ve, NATO-s dhe OSBE-së. “Demokracia e Re ndan shqetësimin e njëjtë me ambasadorët, të cilët dje u prononcuan në lidhje me zhvillimet politike, por jo vetëm kaq. Ne si parti kemi ngritur zërin, kemi ngritur iniciativa, kemi paralajmëruar për gjendjen politike në vend dhe, njëkohësisht, jo vetëm që ndajmë shqetësimet me ambasadorët relevantë në Republikën e Maqedonisë, por njëkohësisht inkurajojmë ata, ashtu siç na kanë mbështetur në rrugën e Maqedonisë gjithë këto vite drejt krijimit të një shteti të vërtetë me vlera demokratike në procesin e integrimit euro-atlantik, të vazhdojnë të na mbështesin në këtë mënyrë”, deklaroi Rushiti.



# Kur'ani, mrekulli e përjetshme

**Udhëzimet hyjnore për gjithë njerëzimin janë obligim. Çështje kjo që është definitive dhe e prerë, e argumentuar dhe e vërtetuar me argumente reale. Nga ana tjetër, një gjë e këtillë është logjikisht e arsyeshme si nevojë e domosdoshme për përsosjen kulmore të jetës së njeriut**

MR. ASS. FAHRUDIN EBIBI

Gjëja më e rëndësishme në mrekullueshmëri të Kur'anit është se i Dërguari i Allahut (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) i ka sfiduar, përkatësisht, i ka ftuar kontestuesit e shpalljes që të prezantonin diç të ngjashme me Kur'anin. Në këtë kontekst janë shpallur shumë ajete kur'anore që flasin për atë se Kur'ani fisnik është mrekulli që vërteton pejgamberllëkun e Muhamedit alejhis-selam, është argument dhe dëshmi konkrete e gjithë kësaj.

Ajo që është edhe më e rëndësishme, është fakti se një sfidim i këtillë ka përfshirë botën njerëzore dhe botën e xhindeve. Për atë se disa poetë të famshëm të asaj kohe, duke parë gojëtarinë dhe rrjedhshmërinë e fjalëve të Muhamedit alejhis-selam, pretendonin në atë se gjenialiteti i tij në këtë drejtim ishte si pasojë se atë e mësonte dikush nga xhindet. Prandaj, Krijuesi i gjithësisë kërkoi nga Muhamedi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem që të sfidonte botën njerëzore, arabët dhe xhindet, duke kërkuar nga ata që të sjellin diç të ngjashme sikur Kur'anin. Në qoftë se ata do të mund të bënin një gjë të tillë.

Çdo pejgamber e kishte të domosdoshme që t'i prezantonte popullit të vet mrekullinë, përmes së cilës do të kishte vërtetuar pejgamberllëkun e vet, mrekulli e cila do të kishte sfiduar artet, shkathtësitë dhe të arriturat më të skajshme njerëzore të kohës.

Mrekulli sipas fjalorit terminologjik do të thotë veprim mbinatyror i atij që pretendon të ushtrojë një detyrë të shenjtë, e cila do t'i kishte përkuar të gjitha ligjet e natyrës, gjë të cilën nuk mund ta bëjë askush tjetër përveç atij të cilin Allahu e ka zgjedhur të ishte pejgamber. Duke dëshmuar dhe vërtetuar me atë se vërtet ai është i vërtetë në atë që pretendon. Domosdo i Dërguari i Allahut të kishte mrekullinë. Udhëzimet hyjnore për gjithë njerëzimin janë obligim. Çështje kjo që është definitive dhe e prerë, e argumentuar dhe e vërtetuar me argumente reale. Nga ana tjetër, një gjë e këtillë është logjikisht e arsyeshme si nevojë e domosdoshme për përsosjen kulmore të jetës së njeriut. Me tendencë të arritjes së kënaqësisë së përhershme dhe të akordimit madhor të shpërblimeve.

### Profetësia e Muhammedit a.s

Meqë udhëzimet hyjnore për gjithë njerëzimin ishin nevojë e domosdoshme, gjithsesi një gjë e këtillë determinon nevojën e dërgimit të komunikuesit, respektivisht të mësuesit të atyre udhëzimeve. Natyrisht, mësuesi i mësimeve hyjnore do të ishte nga radhët e njerëzve dhe detyrë e të cilit do të ishte shpjegimi i gjërave që janë jo të qarta sa duhet për njerëzit e rëndomtë. Normalisht, poste të këtilla prestigjioze do të kishte ëndërruar shumëkush. Do të kishin dëshiruar shumë njerëz t'i ushtronin postet e atilla. Si pasojë, nga kjo do të ishte ngatërruar ajo që është reale me atë që është gënjeshtër, do të ishte ngatërruar pejgamberi i vërtetë me pejgamberin e rrejshëm etj. Prandaj, këto ishin disa rrethana që determinonin pretenduesi i postit pejgamber të kishte edhe mrekulli, e cila do të kishte vërtetuar pejgamberllëkun. Duke u nisur nga ajo që mrekullia është proces, i cili i tejshpon të gjitha ligjet e natyrës, nuk mund ta bëjë një gjë të atillë përveç atij që është i dërguar i Allahut, për faktin se mrekullitë realizohen me fuqinë absolute të Krijuesit të gjithësisë në dorën e personit të nominuar për pejgamber.

Në ditët e para të shfaqjes së Muhamedit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem si pejgamber, paria mekase duke bërë analiza për gjendjen e shkaktuar, paraqitjen e fesë së re, përhapjen e saj, e kishte filluar Muhamedi alejhis-selam, ishin në kërkim të mekanizmave të fuqishëm, të cilët do të ishin në shërbim të parandalimit të përhapjes së idesë së Muhamedit. Prandaj, ishin në kërkim të çdo lloj subjekti ose instrumenti, i cili do të kishte revanshuar ose që do të triumfonte ndaj Muhamedit dhe idesë së tij. Gjatë debateve, takimeve dhe analizave të bëra u vendos që Velid b. Mugire el-Mahzumi të ishte



ai i cili do të përcaktonte format dhe mënyrat e rezistencës?! Velidi do të ishte ai i cili do të përcaktonte mënyrën dhe formën si do të mposhtej Muhamedi alejhis-selam, respektivisht, Islami, për atë se numri i muslimanëve të rinj për çdo ditë shtohej.

Një ditë Pejgamberi ishte ulur afër Qabesë. Velid b. Mugire el-Mahzumi shkoi dhe u ul pranë tij, duke kërkuar nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem që t'i lexonte disa vargje nga 'poezitë e tij', ashtu siç e cilëson Velidi Shpalljen. Nuk janë vargje poezish ato që unë lexoj, por janë shpallje që më shpallen nga ana e Allahut - ia ktheu Pejgamberi alejhis-selam. Në atë rast Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem filloi t'i lexonte ajete kur'anore nga kaptina Fussilet. Transetimet flasin për atë se Pejgamberi i kishte lexuar ajetin 13 të kësaj kaptine. Por, kur arrin: " Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaj: "Unë tërhoqa vërejtjen e një rrufeje (dënimi), si rrufeja e Adit dhe Themudit!" (Kur'an, 41: 13) Velidi filloi të rrëqethet dhe e kapluan dridhjet e trupit, saqë nuk kishte mundësi të kontrollonte veten. Ishte ndikuar aq shumë nga dëgjimi i leximit të atij ajeti nga Pejgamberi alejhis-selam, ashtu që nuk kishte mbetur diç tjetër sa Velidi të shprehej: "Pak më parë dëgjova nga Muhamedi alejhis-selam fjalë të cilat nuk janë të njeriut, as të xhindeve, por janë fjalë të ëmbla dhe të bukura të stilit të lartë". Ky është konfirmimi i parë nga një ekspert i retorikës së asaj periudhe të hershme kohore rreth Kur'anit dhe mënyrës së ndikimit të jashtëzakonshëm dhe të mrekullueshëm retorik të fjalëve të Allahut në shpirtin e atij që e dëgjon ose që e lexon.

**Madhështitë e Kuranit f.l**

Aspekti i mrekullueshëm i fjalëve të Kur'anit shihet te fjalët e bukura dhe te përpikëria përmbajtësore e tyre. Bukuria e fjalëve të Kur'anit është cilësuar nga disa si fjalë magjike. Ndërkaq, disa të tjerë i pengonin miqtë e tyre që të mos i afroheshin Muhamedit alejhis-selam kur ai të lexonte Kur'anin. Për faktin se me të dëgjuar të leximit të një ose dy ajeteve kur'anore, njerëzit menjëherë ndikoheshin dhe bindeshin. Prandaj, ky ishte motivi që Muhamedi alejhis-selam të cilësohej si poet, magjistar, si i çmendur e çka jo tjetër me akuza të paargumentuara nga ana e mekasve në atë kohë.

Madhështia dhe saktësia përmbajtësore janë thelbi i sfidimit kuptimor që solli me vete Kur'ani famëlartë. Me parezervë mund të thuhet që ky aspekt është ajka e çudibërjes, përkatësisht aspekti i mrekullueshëm kuptimor, i cili arrin në atë shkallë sa që dëgjuesi më i rëndomtë, i cili sadopak të kishte shije të natyrës së gjuhës arabe, mund të kuptojë ose të konstatojë se Kur'ani, respektivisht, fjalët e tij nuk mund të ishte fjalë e askujt tjetër për vetë faktin se shprehjet e tilla janë mbi çdo fjalë që mund ta shpreh njeriu, gjë të cilën nuk mund ta bëjë asnjë gojëtar në asnjë mënyrë, në asnjë periudhë kohore.

Përsëritja e fjalëve në Kur'an nuk shkakton monotoni, ashtu siç ndodh me tekste të tjera përsëritja e shprehjeve ose e fjalive shkakton monotoni te lexuesi ose dëgjuesi. Në dallim nga librat tjerë, përsëritja e fjalëve në Kur'an bën që lexuesi ose dëgjuesi të ndjejë kënaqësi. Sa më tepër të lexojë Kur'an, i shtohet

ëndja e leximit. Këtë tipar ose këtë specifikë nuk e ka asnjë tekst tjetër përveç Kur'anit. Fjalë të pakta, por kuptimplote, respektivisht me shumë kuptime të tilla janë vetëm fjalët e Kur'anit. Sa për ilustrim po theksoj këtë ajet: "E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe, kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë." (Kur'an, 99: 7-8)

Shumë ajete kur'anore kanë informuar, përkatësisht kanë lajmëruar për disa gjëra dhe ngjarje shumë të rëndësishme, të cilat ndërlidhen me atë se ç'do të ndodhë në perspektivë. Ashtu që të gjitha informatat dhe paralajmërimet e tilla ishin të sakta dhe të vërteta, pa mos devijuar asgjë nga ajo që ka paralajmëruar. Informacione dhe lajme këto nuk mund të sigurohen përveç përmes shpalljes. Sa për ilustrim do të kishim theksuar këtë ajet: " Përkujtoni kur Allahu ua premtoi njërin prej dy grupeve se është juaji, e ju dëshironit t'ju takojë ai (grup) i paarmatosur, ndërsa Allahu dëshiroi që me premtimet e Tij ta vendosë të vërtetën e ta zhdukë në themel mbeturinën e mohuesve." (Kur'an, 8:7) Ky ajet ka paralajmëruar për ndodhinë ose ngjarjen e luftës së Bedrit, e cila ndodhi ashtu siç kishte informuar Kur'ani dhe triumfues ishin muslimanët. Pastaj ajeti tjetër, i cili paralajmëron faktin se misioni dhe thirrja e Muhamedit alejhis-selam do të ishte me përmasa të gjera dhe se ndikimi i kurejshëve dhe dominimi i tyre do të marrë dhenë. "Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiqu idhujtarëve. S'ka dyshim se Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që tallen." (Kur'an, 15:94-95) Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është se idhujtarët kurejshitë në fillim të thirrjes islame, gjatë periudhës mekase, i pulitnin sytë dhe e përgojonin Muhamedin alejhis-selam kur ai kalonte pranë tyre. Duke e nënvlerësuar dhe duke u tallur me misionin e tij, shpreheshin nëse ky është ai pejgamberi i cili pretendon se me vete e ka xhebrailin? Ajeti në fjalë, siç ka treguar Enes b. Maliku, informon për atë se misioni i Muhamedit do të ngadhënjejë dhe do të triumfojë së shpejti në gjithë hapësirën e Gadishullit Arabik.

Informata dhe paralajmërime kur'anore për sekrete dhe mistere të krijimit, të panjohura për kohën gjejmë në shumë ajete kur'anore për ligje që i përkasin kozmosit dhe natyrës në përgjithësi. Ato mistere do të ishin enigmatike për logjikën e njeriut në mungesë të informimit ose lajmërimit të shpalljes. Megjithëse grekët e vjetër kishin disa informata lidhur me disa ligje të kozmosit, ndërkaq populli i Gadishullit Arabik ishte në errësirë dhe skajshmërisht i painformuar lidhur me ligjet dhe proceset e kozmosit, shumë gjëra për të cilat kishte informuar Kur'ani janë zbuluar më vonë dhe janë qartësuar pas zhvillimit teknologjik dhe përparimit të shkencës. Një nga informatat e tilla ose paralajmërimeve kur'anore është ky ajet kur'anor: "E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vënë kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve." (Kur'an, 15:19) Kohëve të fundit është vërtetuar që të gjitha llojet e bimëve përbëhen nga pjesë të veçanta që kanë peshë të caktuar. Ashtu që nëse shtohet ose pakësohet diç në ato pjesë delikate, atëherë në proces kemi një përbërje tjetër. Nevoja e njerëzve për të prodhuar lloje të bimëve të reja, konstatimi qëndron në atë se procesi i pjalmimit arrihet përmes erërave. Në Kur'an është theksuar: "Ne i lëshojmë erërat mbarësuese, e nga qielli (retë) lëshojmë shi dhe atë ua japim ta pinë, e ju nuk mund ta ruani atë. " (Kur'an, 15: 22)



*"Atij (Kur'anit) nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit". Fussilet-42*

# Muhamedi a.s., komentatori i parë i Kur'anit

Kur'ani famëlartë është vula e të gjitha shpalljeve hyjnore, të cilin Muhamedi a.s. u detyrua t'ia proklamonte njerëzimit. Ky mision i shenjtë nuk nënkuptonte vetëm përcjelljen e tij te njerëzit, por edhe sqarimin e tij, ashtu siç mësojmë nga ky ajet kur'anor:

**"Ty ta zbritëm këtë Kur'an tua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë".** En-Nahl, 44

Ky mision i Muhamedit a.s. zgjati rreth 23 vjet, deri në plotësimin e të gjitha dispozitave të sheriatit, me zbritjen e ajetit të fundit kur'anor 81 ditë para vdekjes së tij. I Dërguari i Allahut e kreu me nder dhe përgjegjësi të plotë këtë detyrë dhe barrë të rëndë me të cilën ishte ngarkuar.

Allahu fuqiplotë deshi që ky mision i fundit dhe kjo shpallje hyjnore të përmbyllte të gjitha shpalljet e mëparshme. Dhe, vërtet, Kur'ani, si libër i fundit hyjnor ishte mrekullia me të cilën Allahu f.p. forcoi zemrën dhe misionin e Muhamedit a.s., duke sfiduar mendjet njerëzore në çdo kohë. Deshi Providenca hyjnore që ky Kur'an të mbetet mrekulli deri në ditën e gjykimit. Dhe, nga fjalitë e tij çdo brez të nxjerrë thesaret e urtisë, të cilat do të jenë argumente të pakontestueshme se Kur'ani është fjalë e Allahut f.p. dhe si të tillë Pejgamberi a.s. ua përcolli as'habëve të tij, të cilët do të jenë bartës të këtij amaneti te gjeneratat që do të vijnë pas tyre.

Pas Kur'anit si burim i parë dhe i pakontestueshëm në Islam, vjen sunneti (hadithi) i Pejgamberit a.s. si burim i dytë i Islamit. Pra, çdo gjë që vjen nga i Dërguari i Allahut, nëse është transmetuar me sened autentik dhe të besueshëm, pranohet pa kurrfarë hezitimi, sepse ai nuk ka folur për çështje të fesë pa qenë I frymëzuar nga Allahu f.p.

"Dhe ai nuk flet nga dëshira (hamendja) e tij. Ai (Kur'ani) nuk është tjetër, pos shpallje që i shpallet". En-Nexhm 3-4.

Se a e komentoi Muhamedi a.s. tërë Kur'anin ose pjesërisht, te dijetarët islamë ekzistojnë mendime të ndryshme.

Një grup i vogël i dijetarëve islamë, në krye me Ibni Tejmijen, janë të mendimit se Pejgamberi a.s. as'habëve të tij ua sqaroi të gjitha kuptimet e Kur'anit. Megjithatë, shumica e dijetarëve islamë janë të mendimit se Pejgamberi a.s nuk e komentoi Kur'anin në tërësi, por vetëm disa ajete që kishin të bënin me dispozita të caktuara, si dhe disa ajete për të cilat e pyesnin as'habët e tij kohë pas kohe. Këto ajete kryesisht ishin të natyrës transcedentale dhe kërkonin sqarime më të hollësishme. Të këtij mendimi janë shumica e dijetarëve bashkëkohorë, si dhe ata të mëhershmit - El Huvejbi dhe Sujutiu.

### ARGUMENTET E GRUPIT TË PARË

- Argumenti i parë i Ibni Tejmijes është fjala e tij: "Duhet të dimë se i dërguari i Allahut ua sqaroi as'habëve kuptimet e Kur'anit ashtu siç ua sqaroi edhe shprehjet e tij, sepse ajeti kur'anor: **"Ty ta zbritëm këtë Kur'an t'ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë"** përfshin Kur'anin dhe Hadithin.

- Argumenti i dytë janë fjalët e disa as'habëve të mëdhenj, si të Othmanit r.a., të Abdullah ibn Mesudit etj. që i transmeton tabiiu i njohur Ebi Abdurrahman Es-Selemi, se as'habët e Muhamedit a.s. kur i mësonin dhjetë ajete të Kur'anit, nuk fillonin mësimin e të tjerave, pa i studiuar mirë dhe hollësisht dispozitat e ajeteve të mëparshme. Madje, është e njohur edhe thënia e tyre: " E mësonim Kur'anin, e bashkë me të mësonim edhe dijen, edhe mënyrën e të vepruarit me ato ajete".

Sipas Ibni Tejmijes ajeti kur'anor: **Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni",** Jusuf 2, dëshmon qartë se ky Kur'an është shpallur në gjuhën arabe, që njerëzit ta kuptojnë.

"Logjika e shëndoshë nuk e pranon faktin që një popull ta lexojë një libër të një disipline shkencore, e të mos e komentojë detajisht; atëherë ç'mund të thuhet për Kur'anin f.l…"

- Argumenti i tretë sipas tij është ajo që e transmetojnë Imam Ahmedi dhe ibni Maxhe nga Omeri r.a i cili ka thënë: Ajeti i kamatës është ndër të fundit që ka zbritur nga Kur'ani, mirëpo i Dërguari a.s. vdiq pa e komentuar atë".

**ARGUMENTET E GRUPIT TË DYTË**

- Transmeton Bezzari nga Aishja r.a. e cila citohet të ketë thënë: "I Dërguari i Allahut nuk bënte ndonjë komentim të Kur'anit, përveç disa ajeteve të pakta, të cilat ia mësonte atij Xhibrili a.s"

- Argumenti i dytë i tyre është se i Dërguari i Allahut me qëllim të caktuar nuk ua sqaroi as'habëve të gjitha kuptimet e Kur'anit, sepse muslimanët janë të obliguar në çdo kohë t'i studiojnë e t'i hulumtojnë ajetet kur'anore, në mënyrë që të forcojnë bindjen se Allahu f.p. është krijuesi i vërtetë i kësaj gjithësie për të cilën flasin edhe shumë ajete kur'anore.

- Argumenti i tretë është se nëse i dërguari i Allahut do t'ua kishte sqaruar as'habëve të gjitha kuptimet e Kur'anit, atëherë ç'domethënie do të kishte duaja e tij që kishte bërë për Ibni Abasin, kur ishte lutur për të: " O Zot, bëje të dijshëm në çështjet e fesë dhe mësoja komentimin".

Sipas këtij grupi, nëse i dërguari i Allahut do ta kishte sqaruar krejt Kur'anin, atëherë pse ta veçonte me këtë dua Ibni Abasin?!

Dijetarët bashkëkohorë pas analizave dhe studimeve të argumenteve të të dy palëve dhanë mendimin e tyre lidhur me këtë çështje. Ajo që është me rëndësi të ceket në këtë rast është fakti se të gjithë dijetarët bashkëkohorë janë bashkuar në çështjen se për të dërguarin e Allahut nuk kishte ndonjë paqartësi rreth kuptimeve të Kur'anit, sepse ato ia mësonte Allahu f.p. nëpërmjet shpalljes. Në anën tjetër, edhe pse as'habët i kuptonin përgjithësisht nga aspekti gjuhësor tekstet kur'anore, megjithatë rreth disa çështjeve të fshehta ishin të pafuqishëm të gjenin ndonjë përgjigje, por fatmirësisht në mesin e tyre gjendej Pejgamberi a.s. i cili aty për aty ua sqaronte atë që nuk e kishin të qartë.

Dijetarët bashkëkohorë ndaj të dy grupeve që përmendëm kanë marrë një qëndrim të mesëm. Këta mendojnë se argumentet e grupit të dytë janë më të fuqishme dhe i pranojnë pa ndonjë hezitim. Kurse në fjalën e tyre përfundimtare lidhur me faktin nëse i dërguari i Allahut e ka komentuar tërë Kur'anin ose vetëm disa ajete, thonë: i Dërguari i Allahut, megjitheatë, nuk e ka komentuar Kur'anin në tërësi, por i ka sqaruar shumicën e ajeteve që kanë të bëjnë me dispozita dhe shumë ajete të tjera për të cilat as'habët bënin vazhdimisht pyetje. Është fakt se për disa ajete as i Dërguari i Allahut nuk kishte njohuri të fliste, siç ishin ajetet rreth momentit të kiametit, ajeti rreth shpirtit dhe të disa gajbeve të tjera.Et Tefsir vel Mufessirun,

Dijetarët bashkëkohorë këtë konstatim të tyre e mbështesin edhe në një thënie të Ibni Abasit, i cili ka thënë: " Tefsiri është katër llojësh:

1. Tefsiri që arabët e njohin prej vetë fjalëve sinonimeve të tyre,
2. Tefsiri të cilin e kuptojnë njerëzit nga vetë natyra e lindur e tyre,
3. Tefsiri që e kuptojnë dhe e zbërthejnë vetëm dijetarët dhe
4. Tefsiri që nuk e di askush tjetër, përveç Allahut.

Nga ana tjetër, Dr. Abdulhamid en-Nexh-xhar vihet në mbrojtje të Ibni Tejmijes, duke deklaruar se fjalët e këtij dijetari të madh janë keqkuptuar, sepse nga fjalët e tij assesi nuk mund të kuptohet se i Dërguari i Allahut ua ka sqaruar as'habëve të gjitha kuptimet e Kur'anit famëlartë, kur dihet se vetë Ibni Tejmije rreth burimeve të tefsirit tradicional thotë nëse në Kur'an dhe sunnet nuk gjejmë komentim në lidhje me ndonjë çështje, atëherë kthehemi te fjalët e as'habëve, sepse pas dy burimeve të para ata ishin njohësit më të mirë të Librit të Allahut f.p.

**PSE MUHAMEDI A.S. NUK E KOMENTOI TËRË KUR'ANIN?**

Po të donte Allahu f.p., me siguri Muhamedi a.s. do ta kishte komentuar në tërësi Kur'anin, mirëpo kjo, megjithatë, nuk ndodhi, sepse Muhamedi a.s. as'habëve ua komentoi disa pjesë kur'anore sipas nevojës, edhe atë ajetet që kishin të bënin me dispozitat islame, me ndalesat dhe urdhëresat hyjnore.

A thua për ç'arsye Muhamedi a.s. nuk e komentoi tërë Kur'anin famëlartë? Lidhur me këtë çështje përgjigjet dijetari i famshëm bashkëkohor Muhamed Muteveli Sharavi, i cili thotë: Aftësitë mendore te njerëzit në kohën e zbritjes së shpalljes nuk ishin në gjendje të absorbonin të gjitha kuptimet e të gjitha mistereve që përmbajnë fjalët e Allahut f.p. dhe për këtë arsye nuk i rëndoi as'habët me gjëra që nuk përputheshin me realitetin e kohës dhe me aftësitë e tyre mendore. Ishte kjo një ndër urtësitë më të mëdha hyjnore, sepse Allahu f.p. deshi që çdo gjeneratë të shuajë etjen në detin e pafund të ëmbëlsisë kur'anore."

Pra, Allahu f.p. deshi që në Kur'an të përfshihet një thesar urtësish e sekretesh të cilat do të mund t'i kuptonin vetëm gjeneratat e mëvonshme, nëpërmjet zbulimeve të mirëfillta shkencore, në mënyrë që gjithkujt t'i bëhet e qartë se ky Kur'an është fjalë e Allahut f.p. dhe është mrekulli deri në ditën e gjykimit.

Nga gjithë kjo që u tha, mund të përfundohet se i Dërguari a.s. nuk ua ka shpjeguar as'habëve të gjitha kuptimet e ajeteve kur'anore, me qëllim që çdo brez të përfitojë nga Kur'ani dhe nga të vërtetat e pakontestueshme të tij.

**S.B**

# Ndryshimet e reja legalizojnë falsifikimet

**Guximi i Qeverisë së Gruevskit për përhapjen e bindjes se me ndryshimet e fundit të Ligjit për denacionalizim do të përshpejtohet procedura e denacionalizimit, flet për mospërfillje arrogante të aftësisë së popullit për të kuptuar gënjeshtrën e tij, si dhe pasojat e saj. Thjesht, këto ndryshime që i bën Qeverua po sllavizojnë Çarshinë e Vjetër deri në palcë dhe lejojnë që shqiptarët të jenë vetëm qiraxhinj në pronën e tyre**

**DRITON DIKENA**



Qeveria e Maqedonisë ka propozuar ndryshimin e Ligjit për denacionalizim. Detyrë e kemi që t'ju informojmë se këto masa po propozohen me qëllim që të pamundësohet kthimi i pronës së nacionalizuar të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, më saktë siç janë komplekset Kapan-Han, Suli-Han, Bezisten në Shkup, Kompleksi Arabati Baba Teqe e të tjera.

Ky ndryshim i Ligjit për denacionalizim parasheh fshirjen e kulturës materiale të muslimanëve dhe bashkë me atë edhe të shqiptarëve, turqve, boshnjakëve, romëve dhe torbeshëve. Njëkohësisht, do të shtrembërohet edhe e kaluara historike në këto treva, me qëllim që e tanishmja e Maqedonisë të tregohet si vend i një populli, i një gjuhe, i një kulture, i një feje që, në thelb, është një parim i cili ashpër është dënuar dhe është gjykuar nga forcat progresive evropiane.

**Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për denacionalizim**

**Propozohet që të ndryshohet Neni 49**

ka qenë " ...*Kthimi i pronës vetëm se nuk ka pengesa juridike dhe faktike*"

propozohet "*...do të kthehet në pronësi vetëm nëse nuk janë*



ligj e rëndësisë së veçantë.

Ligji për denacionalizim (Neni 7) nuk lejon kthimin e pronave që janë monumente të kulturës nëse ato janë "të rëndësisë së veçantë", ndërsa me Ligjin për Çarshinë, BFI-së i pamundësohet kthimi i pronës së nacionalizuar në këtë zonë të mbrojtur me ligj. Deri tani kjo pengesë juridike nuk ka ekzistuar, ndërsa ndryshimet e reja bëjnë që Kapan-Hani, Suli-Hani, Bezisteni, Teatri i Fëmijëve dhe dhjetëra dyqane të tjera të vazhdojnë të mbesin pronë e shtetit, duke përjashtuar përfundimisht elementin shqiptar nga Çarshia e Vjetër. BFI-së me këto ndryshime jo vetëm që i merret e drejta e kthimit të objekteve kapitale, por i pamundësohet edhe kthimi i një dyqani qoftë edhe prej 2 m2, i cili është shkatërruar ose asgjësuar nga faktorë të ndryshëm.

Ndryshimet e reja po ashtu legalizojnë edhe ndërtimin e Filarmonisë në vakëfin e "Ibni Pajkos", ndërtim ky i cili jo vetëm që shkeli Ligjin për denacionalizim, por shkeli rëndë edhe mbi ndjenjat fetare të muslimanëve të këtij vendi.

Thjesht, këto ndryshime që i bën Qeveria po sllavizojnë Çarshinë e Vjetër deri në palcë dhe lejojnë që shqiptarët të jenë vetëm qiraxhinj në pronën e tyre.

*paraqitur pengesa juridike dhe faktike, deri në momentin e vendosjes*"

Në bazë të këtij amendamenti të propozuar, Qeveria e Maqedonisë tenton të bëjë nacionalizimin e dytë të pronës së BFI-së, ose më saktë të legalizojë pengesat juridike dhe faktike të falsifikuara gjithë këtë kohë.

Nëse Ligji për denacionalizim më parë ka kërkuar që prona mund të kthehet te pronari i vërtetë nëse nuk ka ***pengesa juridike dhe faktike deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për denacionalizim,*** tani ky afat shtyhet ***në momentin e vendosjes.***

Duke marrë parasysh se denacionalizimi te ne po zgjat 12 vjet, për gjithë këtë kohë janë bërë uzurpime dhe keqpërdorime të ndryshme të pronës së nacionalizuar të BFI-së dhe janë paraqitur shumë pengesa juridike dhe faktike të reja, të cilat nuk kanë ekzistuar në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për denacionalizim. Sipas Ligjit ekzistues, pengesat juridike dhe faktike të paraqitura pas nxjerrjes së Ligjit për denacionalizim të gjitha aktet juridike janë shpallur të pavlefshme para organeve të shtetit (nëse shteti e ka shitur pronën, e ka kaluar te pronarët e rinj), me ndryshimet e reja këto ndryshime janë të plotfuqishme.

Me thjesht e thënë, Qeveria me këto ndryshime po legalizon falsifikimin e pengesave juridike dhe faktike.

## SLLAVIZIMI I ÇARSHISË SË VJETËR

BFI-ja ka dhjetëra kërkesa vetëm për denacionalizim vetëm në Çarshinë e Vjetër të Shkupit: dyqane, hane, hamame…Me ligjin ekzistues, shteti është i detyruar që ta kthejë këtë pronë te pronari i vërtetë dhe nuk ka asnjë pengesë juridike.

Me ndryshimet e reja, paraqitet një pengesë e madhe faktike dhe juridike për kthimin e pronave te pronari i ri. Me miratimin e Ligjit për Çarshinë e Vjetër, e gjithë Çarshia shpallet zonë e mbrojtur me

**Propozohet që të ndryshohen Nenet 57 dhe 58**

**(Neni 2 dhe 3 te Propozim-ndryshimet)**

Deri tani për çdo vendim të Komisionit të shkallës së parë për denacionalizim, BFI-ja ka pasur të drejtë t'i ankohej Komisionit të shkallës së dytë për denacionalizim në Qeverinë e Maqedonisë.

Komisioni i shkallës së dytë deri tani ka qenë dëshmia e joefektivitetit, joracionalitetit, jofunksionalitetit dhe e moskryerje me kohë të punëve, me tendencë të theksuar për pengimin e realizimit të të drejtave dhe interesave të drejtpërdrejta ligjore të BFI-së. Komisionerët, një dyzinë dirigjentësh, muzikologësh,

artistësh, profesorësh, me në krye një politikolog pa asnjë ditë përvojë pune në çështjet juridike, me punën e tyre deri tani kanë treguar një avashllëk, burokraci të theksuar dhe shkallë të lartë të subjektivitetit gjatë procesit të denacionalizimit. Kanë treguar një sjellje jokooperative dhe joprofesionale ndaj BFI-së, që ka shkaktuar pasoja të dëmshme për vetë vakëfin.

Eliminimin e këtij komisioni e mbështet BFI-ja.

**Propozohet që të ndryshohet Neni 64**

ka qenë " …*Me hyrjen në fundi të këtij ligji, është e ndalueshme që të shfrytëzohet prona që është në procedurë të denacionalizimit*";

propozohet "…***pas 5 viteve të parashtrimit të kërkesës për denacionalizim, lejohet shfrytëzimi i pronës që është në procedurë të denacionalizimit, vetëm nëse ajo është regjistruar në Librin publik të patundëshmërive"***.

Me këto ndryshime shteti po bën nacionalizimin e dytë të pronës së BFI-së, duke i dhënë vetës të drejtën që pronën e vakëfit, që është në procedurë të denacionalizimit, ta shfrytëzojë si ia do qejfi.

Alineja e propozuar "***është e ndalueshme që të shfrytëzohet prona që është në procedurë të denacionalizimit, vetëm nëse kërkesa e denacionalizimit është regjistruar në Librin publik e të drejtave të patundshmërisë***" është një normë kryekëput antikushtetuese dhe antiligjore.

Deri tani Ligji për denacionalizim palëve nuk u ka kërkuar që kërkesën e denacionalizimit ta regjistrojnë edhe në Librin publik dhe jo vetëm BFI-ja, por asnjë subjekt, qoftë juridik apo fizik, që ka kërkuar denacionalizim, nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe asnjë kërkesë nuk është e regjistruar në Librin publik.

Ky ndryshim i jep liri të pafund shtetit që të shfrytëzojë pronën e huaj, sepse është i sigurt se asnjë kërkesë nuk është e regjistruar në Librin publik.

Këto ndryshime bien ndesh me çdo normë juridike, ngase regjistrimi i kërkesës në Librin publik të patundshmërive deri tani nuk ka qenë obligim ligjor, ndërsa ndryshimet e reja vënë në situatë tejet të pabarabartë BFI-në dhe të gjithë parashtruesit e tjerë të denacionalizimit, ngase "vullneti i lirë i palëve" tani iu shndërrohet në një "normë obliguese", e cila u merr të drejtën që të kthejnë pronën e nacionalizuar dhjetëra vite më parë.

Guximi i Qeverisë së Gruevskit për përhapjen e bindjes se me ndryshimet e fundit të Ligjit për denacionalizim do të përshpejtohet procedura e denacionalizimit, flet për mospërfillje arrogante të aftësisë së popullit për të kuptuar gënjeshtrën e tij, si dhe pasojat e saj. Nuk duhet shumë mend që të kuptohet se edhe me ligjin ekzistues nuk është duke iu kthyer prona e nacionalizuar nga shteti Bashkësisë Fetare Islame, mirëpo ndryshimet që planifikon Qeveria në vete ngërthejnë shpirtngushtësinë, njëkohësisht dhe strategjinë e palës maqedonase që t'u thotë JO kërkesave të BFI-së lidhur me pronat e nacionalizuara dhe të uzurpuara me pa të drejtë.

Nga 350 kërkesa, sa ka bërë BFI-ja, ku kërkon kthimin e 3. 869.806,00 m2 tokë, përfshi këtu livadhe, ara, kullota, male dhe të tjera, si dhe 41.258 m2 objekte, përfshi banesa, shtëpi dhe dyqane, pas 12 vitesh denacionalizim vetëm 10 për qind të pronës kemi arritur që ta kthejmë.

**SA PËR ILUSTRIM**

**Në Shkup** nga 127 kërkesa, vetëm 10 prej tyre janë të plotfuqishme

**Në Manastir,** nga 56 kërkesa për mbi 180 parcela kadastrore, vetëm 15 prej tyre janë të plotfuqishme

**Në Kumanovë** nga 10 kërkesa, vetëm 1 e plotfuqishme

**Në Prilep,** nga 4 kërkesa për dhjetëra parcela kadastrore, asnjë e plotfuqishme.

Po ashtu në Dibër, Ohër, Negotinë, Shtip, Veles, Kavadar dhe në gjithë Maqedoninë Lindore situata është e njëjtë.

Qeveria e Maqedonisë me këtë politikë dërgon sinjale se ajo nuk është për bashkëjetesë, nuk është për një shtet multietnik, multifetar dhe demokratik.

Qeveria e Maqedonisë edhe një herë po bëhet shtylla e ndarjes së qytetarëve në baza etnike dhe fetare, ajo po thellon hendekun e urrejtjes dhe të ndasisë, që është një politikë e cila bie ndesh me vullnetin e qytetarëve, pavarësisht përkatësisë etnike dhe fetare.

Nëse nuk e ndryshon kursin politik, kjo qeveri shtetin do ta kthejë drejt kryqëzatave, të cilat lanë pas vete vetëm viktima, urrejtje, ndasi dhe dhimbje.

**APELI PUBLIK**

BFI-ja kohën e fundit ka shpeshtuar takimet me faktorët relevantë, që mund të pengojnë ndryshimet e reja për denacionalizim. Është dhënë edhe apeli publik, ku porositen deputetët e përkatësisë islame dhe të gjithë deputetë tjerë, që janë përcaktuar për bashkëjetesë:

"Qëllimi i propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për denacionalizim është moskthimi i pronës së nacionalizuar Bashkësisë Fetare Islame në RM, të Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe të vendeve të tjera siç që janë Kapan-Hani, Suli-Hani, Bezisteni, Teatri i Fëmijëve dhe objekte të tjera kapitale.

Të nderuar deputetë, bëhuni më vigjilentë dhe mos i votoni ndryshimet e Ligjit për denacionalizim, sepse në të kundërtën do të tradhtoni votuesit tuaj dhe amanetin e dhënë", thuhet në apelin publik dërguar deputetëve, i cili është shpallur edhe në mediat e vendit.



# KURANI, vepër e përhershme

**"Unë shpresoj se s'do të kalojë shumë kohë, kur të urtët e botës do të bashkohen dhe do t'i zgjidhin problemet e botës, sipas parimeve të Kur'anit. Vetëm ato janë të drejta dhe i garantojnë njerëzimit lumturinë." (Napoleon Bonaparta)**

**REXHEP ZIBERI**

Pa dyshim se Kur'ani është mrekullia më e madhe e të gjitha kohëve, misteret e Tij dita-ditës shtohen e shumëzohen, ato nuk kanë të mbaruar asnjëherë. Ai posedon mrekulli të shumanshme. Një ndër mrekullitë e shumta që posedon Kur'ani është vetë leximi i Tij.

Kur'ani është Libri më i lexuar në botë, është Libri që mësohet më së shumti përmendsh nga miliona njerëz të vendeve të ndryshme në botë, është Libri që ka ndikim më të madh në jetën e përditshme të besimtarëve muslimanë.

Nuk ekziston vepër më e dashur për besimtarin musliman sesa leximi i fjalëve të Krijuesit Absolut, fjalë të cilat sado që t'i lexojë, njeriu nuk ngopet asnjëherë me to.

Kur'ani Famëlartë është Libri i librave, ai është mbi çdo libër Ai nuk ka nevojë për asnjë libër tjetër, ndërsa çdo libër tjetër ka nevojë për të. Libri i Allahut ka ekzistuar edhe para se të shkruhet në faqe, madje edhe para se të regjistrohet në burimin e tij në Leuhi Mahfudh. "**Përkundrazi,** (ata që gënjejnë), **ai është Kur'an i famshëm. Në një pllakë të ruajtur mirë** (Leuhi Mahfudh). Buruxh:21-22.

Çdo Libër i shkruar (me plot kuptimin e fjalës libër) në natyrën e vet prezantuese ose ka kuptim të bukur dhe arsimues, ose zbulon parafytyrime dhe mësime të reja, ose paraqet norma dhe rregulla të fuqishme juridike për jetën, individin, natyrën, shoqërinë ose shtetin, ose zbardh rrugët e realitetit dhe orientimit të drejtë, ose zgjon kureshtje ndaj gjërave shpirtërore, ose paraqet të kaluarën si mësim për ardhmërinë, ose paraqet fjalë të zbukuruara dhe të radhitura në stilin më të përkryer gjuhësor etj.



Karakteristikë e Librit të Allahut është se i përmbledh të gjitha llojet e kualiteteve dhe kuptimeve të librave që potencuam më lart, po gjithsesi edhe të atyre mësimeve dhe kuptimeve që logjika e njeriut të kësaj dhe gjeneratave që do të vijnë nuk do të arrijë që t'i zbulojë dhe t'i kuptojë!

Ai nuk la asnjë send pa prekur në brendinë e thellë të tij, ai është i zbritur si sqarim për çdo gjë. **"Shpallja e librit (Kur'anit) nuk ka dyshim se është shpallje nga Zoti i gjithësisë."** Sexhde-2.

Qëllimi kryesor i këtij Libri është që njeriun logjikisht dhe fizikisht ta tërheqë nga ajo që tërësisht jetën e tij ta përputh me natyrën e tërësishme si vepër të Allahut f.p.

### HOLLËSITË E TIJ

Dijetarët e rruzullit aq shumë u interesuan për këtë Libër, saqë na treguan edhe detajet më të vogla që përmban ky Libër, duke u nisur nga shkronjat, fjalët dhe fjalitë e tij.

Kur'ani Famëlartë përmban gjithsej: 381.121 shkronja, 73.412 fjalë, 6219 fjali, 114 kaptina dhe 30 pjesëza të ndara me nga 20 faqe. Ai është i përkryer në çdo shkronjë të Tij. Ai është larg ndryshimeve, është i ruajtur dhe i mbrojtur nga çdo ndryshim. Që nga zbritja e tij e deri në Ditën e gjykimit nuk do të pësojë asnjë ndryshim, qoftë edhe të një shkronje.

Ky është Libri që përmban fjalë të cilat ia kënaqin shpirtin njeriut, fjalë të cilat janë të ngulitura në brendinë më të thellë të zemrës së besimtarit musliman, fjalë që nuk plaken asnjëherë, fjalë me të cilat njeriu nuk ngopet në asnjë mënyrë. Këto janë fjalët e Kur'anit Famëlartë, që është i pamposhtur dhe i pavdekshëm deri në ditën e kataklizmës së përgjithshme, po edhe pas saj!

Kur'ani është Libër i përjetshëm, që nuk është i krijuar. Ai është libri i librave. Madhështia e Kur'anit mahnit masën e thjeshtë, si dhe rrafshin intelektual. Për këtë poeti i madh Johan Volfgang Goethe ka thënë: "Askush nuk duhet të habitet me efikasitetin e lartë të librit. Për këtë ai është cilësuar si jo i krijuar i përjetshëm, (si fjalë) e Zotit nga ana e admiruesve të tij. Kështu, pra, do të mbetet ky libër, përjetësisht, me efikasitetin më të lartë".

### LIBËR I PAKONKURRENCË

Kur'ani posedon muzikalitet fascinues, simfoni të mrekullueshme. Tingujt e Kur'anit i shtyjnë dëgjuesit të derdhin lot. Kumbimi dhe jehona e zërit kur'anor dridh kodra e male. Ai dëgjohet kudo në botë.

Leximi i Kur'anit asnjëherë nuk sjell mërzi te besimtarët, përkundrazi gjatë rileximit, dashuria ndaj tij shtohet edhe më shumë. Vargjet kur'anore janë ato që e bëjnë për vete shpirtin dhe zemrën e besimtarit.

Tingujt e tij kanë bukuri magjepse dhe pushtuese. Ai ka një elokuencë të përkryer. Stili i pastër gjuhësor i Kur'anit gjunjëzon edhe linguistët më të mëdhenj botërorë.

Për nga aspekti letrar, ata Kur'anin e konsideruan si kryevepër me karakter botërorë.

Për stilin e Tij të përkryer dhe të mrekullueshëm, folën edhe dijetarët që nuk i takojnë konfesionit islam.

Përkthyesi i Kur'anit në gjuhën angleze, Arthur Arberry, ka thënë: "Saherë që e dëgjoj leximin e Kur'anit, më duket sikur dëgjoj muzikë, melodia e së cilës përcillet me të rrahura të përhershme të lodrave dhe kjo më krijon emocione të fuqishme sikur me më pëlcit zemra".

Studiuesi francez J.S. Restler thotë: "Meqë bukuria e Kur'anit qëndron në stilin e tij të mrekullueshëm, Ai ka zbritur për t'u lexuar ose për t'u kënduar me zë të lartë dhe asnjë përkthim nuk mund ta shprehë dallimin preciz dhe përplot ndjeshmëri orientale. Duhet ta lexosh në gjuhën e tij (arabe), në të cilën është shkruar, që të arrish të ndiesh gjuhën e Tij, fuqinë shprehëse dhe madhështinë e formës së Tij. Muzikaliteti dhe rima e Tij sajojnë ndikim magjik në shpirt, ku shndrisin mendimet me fuqinë e tyre dhe pamjet me shkëlqimin e vet. Askush s'mund të mohojë se ritmi i Tij mahnitës dhe spirtualiteti i Tij i shkëlqyer ndikojnë në ndijimin tonë dhe në atë se Muhamedi (a.s.) është i frymëzuar nga mëshira dhe madhështia e Allahut (xh.sh.)".

Për nga aspekti arsimor, në Kur'an hasim begatitë më të mëdha intelektuale, të cilat ua tejkalojnë të gjithë dijetarëve më të mëdhenj botërorë, pavarësisht se cilit lëm i përkasin ata.

Për ne muslimanët Kur'ani është fjalë e gjallë në zemrat tona, është gjëja më e shenjtë që ne e kemi.

Kur'ani është libër i besimit, është libër i legjislacionit, është pikënisje e shumë shkencave dhe e shumë diturive, është libër i gjuhës dhe i letërsisë, është libër i etikës dhe i moralit, është dritë nga dija e Allahut xh.sh.

Kur'ani është libri i fundit qiellor, të cilin Allahu fuqiplotë ia shpalli Muhamedit a.s. për ta udhëzuar njerëzimin në rrugën e drejtë, të udhëzuar.

**FILLIMI I ZBRITJES**

Kur'ani Famëlartë Muhamedit a.s. iu shpall pjesë-pjesë, sipas nevojës, në një interval kohor prej 23 vjetësh. Kjo mënyrë e shpalljes së tij pati për qëllim edukimin dhe përforcimin e vazhdueshëm moral të Muhamedit a.s. dhe të muslimanëve, për t'u përballur më lehtë me vështirësitë e ndryshme. Shpallja e tillë e Kur'anit Famëlartë gjithashtu atyre u mundësonte ta mësonin dhe ta praktikonin më lehtë në jetë, sepse, sikur të ishte shpallur Kur'ani përnjëherë, me të gjitha detyrimet dhe ndalesat që përmban, me siguri do të shkaktonte vështirësi te muslimanët fillestarë dhe numri i atyre që do ta kishin pranuar Islamin do të ishte shumë i vogël.

Zbritja e Kur'anit Famëlartë ndodhi në një natë të shenjtë. **"Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar. Ne dëshiruam t'u tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm."** Ed-Duhan:3.

Ajo natë bart emrin Nata e Kadrit. **"Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit."** Kadër:1.

Nga Kur'ani Famëlartë mësojmë se nata e shejtë e zbritjes së Kur'anit gjendej në Ramazan.

**"Muaji i Ramazanit është ai në të cilin filloi zbritja e Kur'anit…"** Bekare:185.

Në këtë natë ndodhi zbritja e tërësishme e Kur'anit të shenjtë në qiellin e parë, ndërsa zbritja e tij në tokë për njeriun vazhdoi në mënyrë sukcesive përgjatë 23 viteve.

Me zbritjen e Tij në tokë, arritën edhe shenjat e para të dritës së Allahut aty, ato të së vërtetës, të diturisë dhe të ndërgjegjes humane. Libri i Allahut është burimi kryesor i çdo drite dhe vetë Krijuesi Absolut këtë dritë e ndan dhe e dhuron sipas dëshirës dhe planit të Tij. Ai që në fillim ndau nga kjo dritë kur e arsimoi dhe mësoi trurin e njeriut duke i mësuar emrat e sendeve elementare që ai nuk dinte.

Të gjitha çështjet shpirtërore dhe morale në çdo kohë dhe vend janë të njëjta dhe me plot vlera. E vërteta në çdo kohë dhe vend është e vërtetë. Drejtësia në çdo kohë është drejtësi. Humaniteti në çdo kohë është humanitet. Identik është rasti edhe me të gjitha çështjet tjera që i mbuloi zbritja e dritës së Allahut fuqiplotë. Drita e Allahut është e pandryshuar, ashtu siç është i pandryshuar edhe burimi i saj.

Fjalët e para të Kur'anit Famëlartë që i zbritën Muhamedit a.s. kanë qenë pesë ajetet e para të sures Alek, që kanë këtë kuptim:

"Lexo! Në emër të Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari. Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me penën. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte". Alek: 1-5.

Përmbajtja e këtyre ajeteve në mënyrë të pakontestuar vërteton se Kur'ani është i shpallur nga Zoti i gjithësisë, me urdhrin e të cilit është transmetuar përmes Xhibrilit a.s. në zemrën e Muhamedit a.s., me qëllim që të udhëzojë njerëzimin në rrugën e drejtë të besimit dhe të veprimit islam.

Si për nga forma, ashtu edhe për nga përmbajtja, Kur'ani është i paimitueshëm dhe i pakrahasueshëm.

Kundërshtarët e Islamit që në fillim të shpalljes së Kur'anit mohonin prejardhjen e tij hyjnore dhe pretendonin se Muhamedi a.s. e trillonte vetë. Për të demantuar gënjeshtrat e tyre, i thirri ata që të shkruanin një libër të ngjashëm me të, ose dhjetë sure si ai, madje më vonë kërkoi prej tyre që të përpilonin vetëm një sure si të Kur'anit:

**"Ose ata thonë: Atë (Kuranin) e ka trilluar vetë (Muhamedi). Thuaj, sillni një sure të ngjashme me to dhe thirrni (në ndihmë) kë të mundeni, përveç Zotit, nëse jeni të sinqertë".** Junuz:28.

Arabët në kohën e zbritjes së Kur'anit Famëlartë poezisë dhe retorikës i kushtonin rëndësi të madhe. Disa poetë të shquar të asaj kohe, siç ishin el Esved el Ansi, Musejlemetul Kedhab etj., me poezitë e tyre u përpoqën që t'u bëjnë konkurrencë ajeteve kur'anore për t'i imituar ato, mirëpo nuk patën sukses, ngase krahasuar me përmbajtjen e mrekullueshme të Kur'anit Famëlartë, poezitë e tyre nuk kishin kurrfarë vlere. Allahu f.p. më në fund konfirmoi se Kur'ani është i paimitueshëm: **"Thuaj (Muhamed), edhe nëse bashkohen njerëzit dhe xhindet për të përpiluar një Kur'an si ky, nuk do të mund ta përpilojnë atë edhe në qoftë se i ndihmojnë njëri-tjetrit (bashkëpunojnë midis tyre).** Isra:88.

Në anën tjetër, fjalët e Kur'anit Famëlartë, me stilin e tyre të bukur dhe me përmbajtjen e tyre frymëzuese u zbutën zemrat shumë kundërshtarëve dhe i bindën për ta pranuar Islamin.

Poeti me famë Lubejdi, kur i dëgjoi fjalët e Kur'anit Famëlartë nga Muhamedi a.s., i mahnitur nga stili dhe kuptimi i lartë i tyre, u shpreh se këto fjalë mund të dëgjohen vetëm nga goja e një Pejgamberi dhe në atë moment e pranoi Islamin.

Omeri r.a., i cili ishte nisur për ta vrarë Muhamedin a.s., kur dëgjoi ajetet e para të sures "Taha" në shtëpinë e motrës së tij, menjëherë ndërroi mendje, shkoi te Muhamedi a.s. dhe në vend të vrasjes, ai kërkoi falje dhe e pranoi Islamin.

Kur'ani Famëlartë është dritë e shpirtit, e zemrës dhe e mendjes njerëzore. Kjo është e potencuar në disa vende në Kur'an, e njëherit është edhe karakteristikë e vetë emrit kur'anor:

**"Atëherë, pra, pranoni Allahun, të dërguarin e tij dhe dritën që e zbritëm Ne. Allahu është i njohur për atë që veproni."** Tegabun:8.

Besimi në Kur'anin Famëlartë dhe dashuria ndaj mësimeve të Tij e hap shpirtin që të pranon dritën e Tij, me të cilën dritë ndriçon rrugët e realitetit. Kur'ani u dërgua për këtë qëllim. **"Elif, Lamë, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty urdhrin e Zotit, që t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të fuqiplotit, të falënderuarit."** Ibrahim:1.

Qëllimi i Kur'anit është që të gjithë botët t'i ngjyrosë me këtë dritë të pavdekshme dhe të pashtershme.

# Estetika e leximit të Kur’anit

**“Stolisni këndimin e Kur’anit me zërin tuaj të bukur, sepse zëri i bukur ia shton edhe më tepër bukurinë Kur’anit” (Hadith)**

**MR. ABAS JAHJA**

Pa dyshim që Kur’ani famëlartë është fjalë e Allahut fuqiplotë dhe paraqet një ndër mrekullitë më të mëdha të të dërguarit tonë Muhamedit a.s. Kur’ani është udhëzues dhe shpëtim për njerëzit e devotshëm dhe ata të cilët marrin mësim prej tij. Leximi i Kur’anit është ibadeti, adhurimi më i madh dhe kontakti i robit me krijuesin, ngase kur falim namaz, ne atë e falim me leximin e Kur’anit.

Para se gjithash, duhet ditur se Kur’ani është fjalë hyjnore e Allahut f.p. dhe në kohën e zbritjes së Kur’anit poezia ishte në kulminacionin më të lartë. Pikërisht për këtë, Kur’ani me rrymën e lartë hyjnore i mahniti dhe i la pa fjalë edhe poetët më të mëdhenj të asaj kohe. Leximin e Kur’anit nuk e dëgjonin vetëm ata që e besonin, por kishin dëshirë të madhe për ta dëgjuar edhe ata që nuk e besonin, d.m.th se Kur’ani kishte ndikim edhe te jobesimtarët. Kur’ani me muzikalitetin e tij pati dhe ka ndikim të madh në historinë njerëzore.

Pasi që leximi i Kur’anit paraqet një ibadet kaq të madh, muslimanët që në kohën e zbritjes së tij kanë treguar interes dhe kujdes të madh për leximin dhe formën e stilit sa më të bukur. Gjithë ky kujdes dhe interesim i madh është një inicim i vetë Pejgamberit a.s., i cili në shumë hadithe në mënyrë të qartë flet për këtë:

*“Stolisni këndimin e Kur’anit me zërin tuaj të bukur, sepse zëri i bukur ia shton edhe më tepër bukurinë Kur’anit.”*

*“Çdo gjë ka zbukurimin e saj, kurse zbukurimi i Kur’anit është zëri i bukur”.*

*“Allahu nuk i kushton kujdes askujt sikur një të dërguari që ka zë të bukur, i cili e lexon Kur’anin me zë të qartë dhe të bukur”.*

Musa el Eshariu ishte njëri ndër as’habët i cili kishte zë shumë të bukur. Atë një natë, duke lexuar Kur’an, e dëgjon Pejgamberi a.s. dhe të nesërmen i thotë: ”Ja Musa, ty të është dhënë një nga mizmaret (meloditë) e Davudit a.s”.

Gjithashtu, Pejgamberi a.s. e ka lavdëruar edhe Salim Hudhejfen kur ka thënë: “E falënderoj Allahun që brenda ummetit kemi një person si Hudhejfeja”.

Në vitet e para të shpalljes Kur’ani lexohej më rrafsh, me një diapazon jo shumë të gjerë të zërit, por me ndikim të fortë te dëgjuesit. I pari që ka lexuar Kur’anin me melodi është Abdullah ibni ebu Bekri dhe më pas edhe nipi i tij, Abdullah ibni Omeri, i cili vazhdoi me stilin e Abdullahut.

Ky stil i leximit nuk kishte lidhje me ginan dhe hudan (forma të zbukurimit të tepërt të zërit), ndërsa më vonë ky stil do të marrë emrin Kiraeti i ibni Omerit.

Këtë stil të leximit të Kur’anit e vazhdoi Said el Al-laf, i cili njëkohësisht i ka marrë lëvdatat edhe nga Kalifi i kohës së tij, Harun er Reshidi.

Por, më vonë ky stil i leximit të Kur’anit fillon të zëvendësohet me melodi që mbanin karakteristikat e vendeve nga ana e lexuesve lokalë. Sepse, me zgjerimin e kufijve të shtetit islam, Kur’anin fillojnë ta lexojnë edhe joarabët, kështu që paraqiten disa shkolla të leximit:

- Hixhazi, sipas stilit arab
- stili i Kufes – Nabati
- stili i Basrës – Husrevani
- Farisi – persian
- Stili i Shamit – nën ndikimin e dijetarëve.

Përfaqësuesit e parë të cilët kanë filluar ta lexojnë Kur’anin duke i shtuar melodi këngësh dhe thurjesh të tepërta të zërit janë: el Hajtem el Al-laf dhe Aban ibni Taglib. Më vonë këta i ka ndjekur Ibni A’juni dhe Muhamed ibn Sad et-Tirmidhiu.

Hajtem el Al-lafi ajetin kur’anor “Emmes-sekinetu fekanet” e ka lexuar me një melodi të një kënge të njohur të asaj kohe; po ashtu edhe Muhamed bin Sad et Termidhiu ka marrë melodi nga këngët profane dhe i ka modifikuar në pjesët e ajeteve kur’anore. Duke i pasur parasysh këta faktorë që i përmendëm më lart, duhet potencuar se në këtë drejtim janë zhvilluar edhe debate dhe polemika të shumta, e të ashpra, midis dijetarëve islamë, por duhet të dimë se asnjëherë me mendime të skajshme nuk mund të jepen përfundime të sakta dhe të shëndosha.

Përzierja e melodive të këngëve në leximin e Kur’anit ka nxjerrë në dukje disa risi:

- Ter’id – dridhja e zërit gjatë leximit;
- Tatrib - ngritja dhe ulja e zërit, zgjatja e tepërt e medeve dhe vendosja e medeve aty ku nuk e kanë vendin;
- Tahzin – largimi nga leximi i vërtetë, leximi i Kur’anit sikurse me qenë i përmalluar.
- Leximi i një shkronje si të jenë dy, përforcimi i shkronjave ku nuk ka nevojë.

Pikërisht për këtë duhet të dimë se gjatë leximit të Kur’anit duhet të kemi kujdes të madh dhe duhet që t’u përmbahemi rregullave të texhvidit ose drejtleximit të Kur’anit. Sipas tërë kësaj që potencuam deri më tash, mund të konkludojmë se, aq sa është i rëndësishëm zëri i bukur gjatë leximit të Kur’anit, po aq është e rëndësishme edhe të përmbajturit në rregullat e drejtleximit, siç janë shqiptimi i shkronjave, zgjatja dhe matja e duhur në vende të caktuara, ruajtja nga meloditë joserioze që u ngjasojnë melodive të këngëve dhe ruajtja nga meloditë profane.

# Për Kur'anin, me Kur'anin!

**"Kur'ani është, pa dyshim, shpallja e Zotit të të gjitha botëve. E solli i besuari Xhibril. Në zemrën tënde, të bëhesh thirrës, lajmëtar. Në një gjuhë të qartë arabe".** ***(Esh - Shu'ara, 192 – 195)***

**EMINE A. VEZAJ**

Sado që ndryshojnë kohët, sado që civilizohen shoqëritë, sado që evoluon shkenca, të gjithë mbeten vetëm një hije dhe margjinalizohen në kohë, përpos librit të shenjtë i cili aktualizohet gjithmonë! Bota islame, që nga zbritja e Kur'anit e ka pasur këtë libër, në fenë islame nuk ka tjetër tekst kanonik me prejardhje hyjnore, vetëm Kur'ani e ka këtë privilegj i cili mbetet libër ose frymë hyjnore që nga fillimi deri në fund.

Kur'ani është Fjalë e Zotit, respektivisht mrekulli e Tij. Ka zbritur në këtë botë Natën e Fuqisë (Lejletul Kadër), kah fundi i muajit Ramazan, muaji i nëntë i kalendarit hënor. Muaji i cili agjërohet nga muslimanët dhe që kjo natë festohet në mënyrë më specifike.* Kjo ishte "zbritje" (tenzil) shpirtërore në zemrën e Pejgamberit a.s. derisa ai gjatë muajit Ramazan përsiaste në një shpellë në malin Hira, jo shumë larg Mekës. Kjo zbritje vertikale e Kur'anit u shfaq në dimensionin e jashtëm në shpalljet fragmentare që dolën prej tij, të nxitura nga kjo apo ajo rrethanë, përgjatë periudhës 23 vjeçare të misionit të tij pejgamberik.[1] Por, nuk kishte asgjë të re në mesazhin mbi malin Hira. Kjo ishte thjesht feja e vjetër e Zotit, që kishte zbritur vazhdimisht, por e cila i ishte besuar të Dërguarit Muhamed për t'ua përcjellë jo vetëm arabëve, por të gjithë njerëzve të botës. Kjo fe tashmë e "re" nuk kishte filluar në malin Hira, por në ditën e Krijimit, sepse edhe vetë Kur'ani nuk deklaron fshirjen e zbritjeve të mëparshme.[2]

Kur'ani është mrekullia e vetme dhe më e madhe të cilën Allahu xh.sh. e përcolli përmes Xhibrilit tek i Dërguari i fundit Muhamedi a.s, tek një i Dërguar, që siç e ka cilësuar edhe Gëteja Muhamedin në një dorëshkrim që mban datën 27 janar 1816, "Kreu i qenieve të krijuara". Zbritja e Kur'anit nga rrafshi i pakrijuar i realitetit në atë të krijuar u krye përmes rrezes ndriçuese të dritës së Shpirtit të Shenjtë, i personifikuar në Xhibrilin a.s. Krye – Engjëllin e Shpalljes dhe tutorin e Pejgamberit a.s.

Mrekullia që përshkon këtë libër dhe që ka një diversitet karshi një libri të rëndomtë, nuk ka të bëjë me karakteristikat gramatikore, sintaksore, gjë që mund të emetohen, por prania Hyjnore në çdo shkronjë, melankolia e një artikulimi të bukur, bashkërendimi i ngjarjeve, të gjitha këto janë të paimitueshme, janë mrekulli e vetëm një koleksionuesi – Allahut xh.sh. Pejgamberi a.s. nuk kishte kurrfarë kontrolli mbi rrjedhën e shpalljes. Kur'ani i erdhi pavarësisht dëshirës së tij: ai as nuk mund ta shpejtonte ardhjen e vargjeve dhe të kapitujve, dhe as ta shtynte atë për më vonë. Realitetin e shpalljes ai e përjetonte si subjektivisht, ashtu edhe objektivisht. Xhelaludin Rumi, në veprimet e tilla që zbulojnë shumëllojshmërinë e interpretimit të Kur'anit ka vërejtur "të hequrit e mbulesës" nga Kur'ani dhe me atë rast ka thënë se kurrë nuk dimë me siguri nëse ndonjë mbulesë është "ajo e vërteta". Ai thotë: "Kur'ani është si gruaja e re e martuar. Madje edhe nëse orvateni t'ia hiqni perçen, ajo nuk do t'ju shfaqet. Nëse debatoni për Kur'anin, asgjë nuk do të zbuloni dhe nuk do të shijoni kurrfarë kënaqësie. Kjo është për shkak se mundoheni ta shkulni mbulesën, mirëpo Kur'ani nuk e lejon këtë. Duke përdorur dinakërinë dhe mashtrimin dhe duke u bërë të neveritshëm dhe të padëshiruar në sytë tuaj, ai ju thotë: 'Unë nuk jam ajo që ju doni'. Dhe në këtë mënyrë ajo mund të shfaqet në çfarëdo forme."

Shpallja kur'anore, të cilën Pejgamberi kishte filluar ta pranonte nga momenti i meditimit në malin Hira, kishte pasoja shpirtërore, psikike dhe fizike mbi Pejgmaberin a.s. Ky ishte një përjetim tronditës, sublim, i një prezence që mbushi të gjithë horizontin dhe prej të cilit "shpëtimi" ishte i pamundur. Ai tashmë ishte hedhur në një fushë që ai kurrë nuk e kishte imagjinuar, pjesa e sipërme e trupit të tij dridhej nga konvulsionet, vërshimi që përjetonte nga këto momente të kontaktit me Xhibrilin kishin ndikuar edhe në natyrën fizike të tij. Me një rast, kur po i shpalleshin disa ajete të Kur'anit, trupi i Pejgamberit a.s. u bë aq i rëndë, saqë deveja mbi të cilën ishte ulur më kot përpiqej ta mbështeste

barrën e shtuar me përshtatjen e këmbëve të veta. Në kohën kur u ndërpre shpallja, barku i devesë ishte ngjitur përtokë, ndërsa këmbët i kishte të shtrira (Hadith).[3] Njëherë Pejgamberi a.s. pati deklaruar: "Asnjëherë nuk mora një mesazh pa kujtuar se shpirti u shkul prej meje". Sidoqoftë, krahas të gjitha vështirësive që kishte pasur gjatë këtij misioni në pranimin e shpalljes nga Pejgamberi a.s, Kur'ani u bë në një shpirt të pastër, pa kurrfarë pengesash që do ta errësonin rrezatimin e shpalljes. "A nuk ta hapëm kraharorin dhe ta hoqëm ty barrën".[4]

S'do mend, duhet të jetë e vështirë të shkruhet për një libër – mrekulli, dhe që nuk është as i ngjashëm, por as nuk krahasohet me ndonjë libër tjetër, por meqë u drejtohet krijesave atëherë, duhet bërë përpjekje për ta kuptuar brenda suazave të asaj që kuptohet. Për Kur'anin ka folur vetë Kur'ani, por kanë dhënë përshkrime dhe shumë kuptimësi edhe hadithet e Pejgamberit a.s. Në pamundësi (për natyrën e shkrimit) për të përmbledhur të tëra ajetet dhe hadithet që flasin në këtë drejtim një pjesë prej tyre, pra, vetëm disa ajete kur'anore, hadithe dhe emërtimet që i bëhen në tekstet hyjnore Kur'anit, janë të përfaqësuar një numër i madh i karakteristikave të Fjalës Hyjnore, të cilat njëkohësisht mundësojnë edhe qasje më të mirë njerëzore në kontaktin me Kur'anin. Kur'ani për Kur'anin në disa ajete thotë: **"Ne të zbritëm ty librin me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu..."**. [5] **"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij"**.[6] Kur'ani e përshkruan veten edhe **"Kur'an i nderuar në librin e fshehtë"**.[7] **"Kur'an i lavdishëm në tabelën e mbrojtur"**.[8]**,** së këndejmi edhe hadithet e Pejgamberit a.s. flasin për Kur'anin, për shkakun e zbritjes së Kur'anit, zbatimin e urdhrave të Kur'anit, formën se si duhet të lexohet etj. Pejgamberi a.s. thotë: *"Unë juve ju lash dy gjëra. Nëse ju u përmbaheni atyre, nuk do të devijoni: Librin e Allahut dhe Sunnetin tim". "Ata që dëshirojnë të dinë dijen e të parëve dhe të pasmëve le të lexojnë Kur'anin".*

**KUR'ANI ME NE**

**RETROSPEKTIVË**

Jemi në një vit jubilar të përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, përkujtim për një libër i cili është bazë themelore e fesë islame, e kulturës dhe qytetërimit në përgjithësi. Është platformë e vetme që unifikon gjithë besimtarët muslimanë kudo që janë. Kur'ani, si një libër i pakrahasuar gjatë gjithë kohëve qysh nga fillimi i zbritjes, kishte edhe interesimin e njerëzve nga të gjitha anët e botës, pra një qasje që nuk i interesonte vetëm botës arabe, por mbarë botës në përgjithësi. Të gjithë të interesuarit,



nuk kishin qëllim të njëjtë, disa e studion për ta kuptuar thelbin e Kur'anit dhe për ta kënaqur shpirtin nga bukuria që përmban ky libër, të tjerët iu qasën në mënyrë tendencioze për qëllimet e tyre antiislame. Sidoqoftë, sot Kur'anin e kemi një libër të kompletuar pa asnjë fije dyshimi. Sot, nuk ka popull në botë që këtë libër nuk e ka të përkthyer në gjuhën e tij. Edhe shqiptarët, pavarësisht rrethanave, izolimeve, okupimeve të njëpasnjëshme si dhe konflikteve që përjetonin nga armiqtë, në veçanti nga vendet fqinje, në këtë drejtim nuk mbeti mbrapa. Përderisa te popujt e tjerë të Evropës Kur'ani ishte përkthyer nga të krishterët, shumica e të cilëve ishin orientalistë specialistë për gjuhën e kulturën orientale në përgjithësi dhe atë arabe në veçanti, dhe përkthimit të Kur'anit i ishin qasur për çështje misionare me qëllime antiislame, Ilo Mitko Qafëzezi përkthimit të Kur'anit i hyri që t'u ofronte vëllezërve të tij të gjakut që i përkisnin fesë tjetër-fesë islame. Në faqen e brendshme të kopertinës është dhënë përkushtimi i përkthyesit: "Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u dedikohet.[9]

**KUR'ANI SOT**

Duket se ka qenë e vështirë, madje edhe e pamundur që një gjuhë, siç është gjuha e Kur'anit, u bë problem serioz për shumë përkthyes sepse e dimë se gjuha kur'anore krijon një botëvështrim (i cili është edhe religjioz), ndërkohë që s'duhet harruar që historia e tërësishme e gjuhës arabe, para se të "sanksionohej" me Kur'an si gjuhë e shenjtërisë dhe shpirtërores islame, ka qenë nën ndikimet e pareshtura të traditës monoteiste, e cila është zhvilluar në ind të gjuhës hebreje, si edhe të gjuhëve tjera, me të cilat korrespondon "gjenetikisht" dhe gjeografikisht.[10] Rrjedhimisht, gjuhët janë të ndryshme dhe "ndryshueshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave të njerëzve është argument i Zotit".[11] Sot, meqë e kemi Kur'anin në gjuhën shqipe, do të thotë se ky Kur'an në vete pos një përkthimi që hera-herës është përkthyer vetëm

nga kuptimi sintaksor, duhet parë si një rezultat dhe si një event shumë të rëndësishëm për besimtarët muslimanë shqipfolës.

Meqë të mendosh do të thotë të mendosh ndryshe, përkthimi dhe komentimi janë diçka tjetër, diçka e ndryshme nga origjinali. Nëse në përkthimin dhe komentim të Kur'anit mendoj për atë çka flet Kur'ani, unë mendoj ndryshe nga ajo se si është shpjeguar në origjinalin kur'anor, thjesht për faktin se gjuha ime ndryshe e organizon botën (madje edhe botën e përkthyer dhe të komentuar), përfundon Enes Karic.

Sidoqoftë, përkthimi i Kur'anit që nga fillimi i historisë së vet nuk ka mundur asnjëherë të shterohet me gjykimet teologjike mbi "pamundësinë" e përkthimit, duke e quajtur madje të gabueshëm ndërmarrjen e një përkthimi të tillë. Por, pavarësisht të gjitha këtyre fushatave, Kur'ani është përkthyer në të gjitha gjuhët e botës.

Nuk do të hyjmë në çështjen e të dhënave statistikore rreth historikut të përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, por me pak fjalë do të shtrojmë se edhe te ne, fillimisht, ka ekzistuar rezistenca rreth përkthimit të Kur'anit. Mirëpo, mund të theksohet se kjo rezistencë ishte jetëshkurtër, sepse çështja shkoi më tepër jo *a të përkthehet* Kur'ani, por *si të përkthehet* ai më mirë dhe *çfarë metode e rruge* të ndiqet gjatë përkthimit. Por, rezistenca e ulemasë shqiptare rreth mos/përkthimit të Kur'anit ishte e arsyeshme, sepse në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX populli shqiptar ballafaqohej me ndikime politike, ushtarake, ekonomike dhe kulturore të shumta e të fuqishme perëndimore nën dirigjimin e kishës katolike dhe lindore, nën dirigjimin e kishës ortodokse. Latinizimi dhe sllavizimi i aspekteve të ndryshme të jetës ndër shqiptarët e shtyri ulemanë e vendit të ketë drojë nga risitë në pikëpamje të fjalës së shkruar, sepse gojarisht qysh më herët bëhej përkthimi dhe interpretimi i Kur'anit dhe të të vërtetave fetare në gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera të vendit.[12] Cituar sipas Dr Ismail Bardhit, disa autorë vonesën e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe e shohin si provë të konceptimit të ulemasë së vendit mbi pamundësinë e përkthimit të Kur'anit në gjuhë të tjera.[13]

Pavarësisht të gjitha situatave që ka kaluar Kur'ani, qoftë në ruajtjen e tij në origjinalitetin të cilin e ka edhe sot (dhe do ta ketë)[14], por edhe në atë të përkthimit që i janë bërë, muslimanët e kanë të vetmen pikë referimi për çdo sjelle të jetës njerëzore. Madje, cituar sipas Dr. Metin Izetit, "qëllimi i Kur'anit para se gjithash është përqendruar në dy momente themelore: 1) Në lidhshmërinë e njeriut me Zotin e tij dhe 2) Në lidhshmërinë e njeriut me shoqërinë njerëzore. Sipas aspektit të parë, njeriu nëpërmjet të Kur'anit formon lidhshmërinë me Zotin e vetëm dhe që e pranon natyra njerëzore, e konfirmon njëshmërinë e Zotit të vërtetë me bindje për t'i eliminuar të gjitha llojet e zotave të rrejshëm dhe që i dalin në rrugë këtij qëllimi. Sipas aspektit të dytë, njeriu e formon lidhshmërinë me shoqërinë për ta kompletuar mënyrën e solucionit të vetëm të problemit të kontrastit dhe për ta realizuar në të njëjtën kohë edhe drejtësinë hyjnore..."[15]

Kur'anin e lexojnë mijëra shqiptarë kudo që ndodhen, e ruajnë si librin më të çmuar, e vendosin më lart karshi çdo libri tjetër, e ruajnë në sirtarët më të bukur. Është libër për të gjitha nevojat shpirtërore dhe një bibliotekë e shenjtë që jep libra të përshtatshëm për rrugët e për metodat e të sinqertëve dhe dijetarëve.[16] Çdo xhami në Kosovë brenda vetes ruan dhe kultivon institucionin e mësimit të leximit të Kur'anit nga gjeneratat e reja, organizata të shumta me qëllime sublime kanë krijuar kurse për mësimin e leximit të Kur'anit, brenda vetë Medresesë funksionojnë edhe garat e leximit të bukur të Kur'anit, të cilat mbahen çdo vit dhe tashmë kanë krijuar një traditë. Të gjitha këto janë vetëm një dëshmi se Kur'ani asnjëherë nuk do të shuhet në këto troje, jo vetëm se i Madhi Zot ka garantuar për ruajtjen e këtij libri, por pikërisht edhe prej faktit se janë besimtarët ata që e kultivojnë dhe e transmetojnë brezni pas breznie. Një praktikë të tillë muslimanët e morën nga as'habët e Pejgamberit a.s., ndërsa këtë praktikë ua mësuan edhe të tjerëve, shpeshherë duke e bërë leximin e Kur'anit jo si një libër fabul ose tregim interesant, por si një mrekulli që nuk ka të ngjasuar me asnjë libër tjetër. Si përfundim i kësaj që u tha, dua të përmend vetëm shembullin e Gëtes. "Shileri, në një letër për Kimbelin që mbart datën 22.02.1815, tregon se Gëteja u lexonte me zë të lartë anëtarëve të familjes së Dukës së Vajmarit dhe miqve të tyre përkthimin e Kur'anit në gjuhën gjermane nga Jozef fon Hameri dhe se vetë Shileri, bashkë me të shoqen, kishin marrë pjesë në një takim të tillë.[17] Për Gëten Kur'ani është, thjesht, *libri i librave* (*Das Buch der Bucher*).

[*] Respekti i Gëtes për Kur'anin shkon deri aty, saqë ai, në moshën shtatëdhjetëvjeçare, shkruan se synon të festojë "*Me respekt atë natë të shenjtë, në të cilën Profetit iu soll Kur'ani nga lart*", Edvin Cami, fq. 63.

[1] Ismail Bardhi. Kriza e teologjisë muslimane shqiptare, Shkup, 2009, boton "Logos – A", fq. 56.

[2] Karen Armstrong, Muhamedi një biografi e Profetit, Tiranë, 2006, fq. 110.

[3] Ismail Bardhi. Kriza e teologjisë muslimane shqiptare, Shkup, 2009, boton "Logos – A", fq. 59.

[4] El-Inshirah 1-2.

[5] En - Nisa, 4:105.

[6] El - Hixhr, 15:9

[7] El Vakia, 76-77.

[8] El Buruxh, 22.

[9] Cituar sipas Ramdan Shkodrës. Nisma e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe nga Qafëzezi – vepër monumentale e kulturës islamo – shqiptare. Në www.forumishqiptar.com

[10] Enes Karic, Si të komentohet Kur'ani, pa vit botimi, Boton Fakulteti i Studimeve Islame – Prishtinë, fq. 46.

[11] Kur'ani XXX: 22

[12] Cituar sipas Nexhat Ibrahimit, Mbi përkthimin e Kur'anit, në www.zeriislam.com

[13] Ismail Bardhi, Hafëz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore, Shkup, 1998 fq. 110, fusnota 195.

[14] **"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij" Hixhr, 15:19**

[15] Metin Izeti, Ethet e metafizikës, pa vit botimi, Boton shoqata kulturore "Skofia", fq. 138.

[16] Musa Musai, Psikologjia e identitetit fetar, Gostivar, 2005. fq. 209.

[17] Edvin Cami, Gëteja mes Perëndimit dhe misticizmit oriental, Tiranë, 2009. fq. 63.

Zëri i FSHI
Shtojcë informative dhe kulturore e studentëve të Fakultetit të Shkencave Islame

*" Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen ".*

*Hadith kudsijë:*

*Allahu xh.sh thotë: "Unë jam në mendimin e robit tim kur ai më kujton Mua, Unë jam me të kur ai më përmendën Mua, nëse më përmendën Mua në veten e tij, e përmendi Unë atë në Veten Time, nëse me permendën në një masë, e përmendi Unë atë në një masë më të mirë se ajo, nëse afrohet nga Unë një shpull, afrohem kah ai një krahë"(transmeton muslimi)*

# Festimi i 1 Majit

**SHABAN TAIRI, VITI IV-FSHI**

Një nga veçoritë që i kishte Pejgamberi ynë, *salallahu alejhi ve selem*, është se Zoti atij ia tregoi disa ngjarje të së ardhmes, disa paralajmërime për popullin tonë. Një ndër to është edhe paralajmërimi se ky *Ummet* do të ndjekë *Ehlu-l-Kitab*-ët hap pas hapi, saqë nëse ata tentojnë të depërtojnë në vrimën e hardhucës, ne do t`i ndjekim.

Këtë fenomen më së miri dhe më qartë e vërejmë në mesin tonë në kohën e sotme, ku shohim se si muslimanët solidarizohen me jobesimtarët në gjithçka, saqë edhe festat e tyre na duken se janë tonat. Ata as që duan të dëgjojnë se ekziston feja jonë, e lëre më festat tona, kurse ne ua festojmë të gjitha festat e tyre.

Një ndër ato festa është edhe dita e 1 Majit, ku kjo ditë është e shpallur si ditë jo pune nga shumë shtete, andaj edhe muslimanët tanë të shkretë në këtë ditë dalin në parkun e Shkupit ose të Sarajit, sikur të jenë të obliguar nga Zoti e respektojnë daljen atë ditë, por vallë, a e kemi menduar ndonjëherë se çka është kjo festë? Prej ku e ka fillimin?

Në vijim do të cekim se si ishte zanafilla e kësaj dite.

**DITA E 1 MAJIT**

Dita e Një Majit tradicionalisht është festuar te populli gjerman me qindra vite më parë, ndërkohë që dita e 1 Majit ishte një ditë e rëndësishme në shtetet komuniste. Si fillim zyrtar llogaritet nga takimi i Socialistëve, të cilët e mbajtën një mbledhje më 1889 dhe e shënuan këtë ditë si ditë të punëtorëve.

Sistemi i kaluar komunist, i cili i ka kushtuar rëndësi të madhe kësaj feste (1 Majit) me qëllim që ta largojë popullin nga festat me bazë



fetare dhe t'i zëvendësojë me festa pagane dhe që bazohen në hamendje, një gjë të tillë e ka bazuar në ideologjinë marksiste.[2]

Por, vallë, a është e vërtetë se kjo festë u kushtohet punëtorëve, apo është për qëllim ndonjë punëtor tjetër, si punëtorët e rendit të Mendjendriturve?

**REALITETI MBI 1 MAJIN**

Në Evropën e lashtë dita e një Majit është llogaritur si dita e parë kur fillon koha e ngrohtë dhe dita e luleve, ndërsa romakët në këtë ditë vallëzonin në shenjë falënderimi ndaj zotit të natyrës, të quajtur Flora, kurse Druidët kanë ndezur zjarre si shenjë falënderimi ndaj zotit Bela. Ndërkaq, në shekujt mesjetarë evropianët zbukuronin shtëpitë me lule, kanë vendosur një dru në oborr dhe kanë luajtur valle rreth tij. Sipas paganëve evropianë, në këtë ditë bëhen rituale falënderimi ndaj zotit të pjellshmërisë, lëshohet muzikë dhe ka gëzim të madh për shkak të gjelbërimit të natyrës. Muaji maj sipas tyre është muaji i gjallërisë, është dita më e lumtur, pasi në të është dita e shumimit. Shumë njerëz e kanë adhuruar natyrën dhe tokën në të kaluarën, ashtu siç ka edhe sot, por shumica e bëjnë këtë pa e ditur. Shembull konkret është mu 1 Maji. Në të kaluarën, ndër disa popuj 1 Maji llogaritej si festë e shtrigave dhe e satanistëve.[3]

Kjo datë është edhe data e themelimit të organizatës sekrete *Illuminaty* (Mendjendriturit), e themeluar nga Adam Vajshop, pra, më 1 Maj të vitit 1776 themelohet kjo shoqatë, e cila emrin e merr nga grupe njerëzish që i kanë takuar misticizmit babilonas. Pra, komunizmi e festoi 1 Majin, ditëlindjen e *Illuminaty*-ve, nga shkaku se përkrahësi i komunizmit, Karl Marksi, ishte anëtar i kësaj shoqërie.[4]

Nëse hyjmë në analiza më të thella rreth kësaj date, do të shohim se kjo ditë është ditë e paganëve, andaj çka e lidh muslimanin me këtë festë, vallë ne duhet t`i largojmë traditat e paganëve apo t`i kultivojmë, saqë edhe nëse dikush do t`i eliminojë ato, muslimanët tanë janë ata që e pengojnë eliminimin e tyre, fatkeqësisht duke i festuar për çdo vit.

[1] "May Day Parade in East Berlin," *Microsoft® Encarta® Encyclopedia 2000.* © 1993-1999 Microsoft Corporation. All rights reserved.

[2] Revista "Paqja", nr. 14, fq. 22, tema: Viti i ri.

[3] Për më tepër, shih: Masonski i okultni simboli – Dr. Keti Barns, fq. 237-238; si dhe "Kodi i Da Vinçit", nga Dan Brown, i cili jep një përshkrim të vogël në fq. 127; Botimet Dudaj, 2003.

[4] Shih: "Komploti botëror" – Nikolla M. Nikolov, fq. 47 dhe fq. 168; "Kush e sundon botën"- Jim Marrs, fq. 321.



# Të përpiqemi që të bëhemi Kur`anë të gjallë

*"Edhe nëse litari i deves më humb, atë përsëri do ta gjej me librin e Allahut"* (Ibn Abbasi r.a.)

**MIXHIT OSMANI**

Në qenien njerëzore gjenden tre komponentë që e udhëheqin këtë qenie. Ata komponenetë janë: trupi, shpirti dhe nefsi (pasioni). Të kesh diçka, e cila është në dorëzimin a udhëheqjen tënde, është shumë lehtë, por, në të shumtën e rasteve, ndodh e kundërta, pra, e ke, mirëpo nuk mund të udhëheqësh me të. Kjo në brendi përmban një mister të padefinuar ezoterik. Me grumbullimin e këtyre mistereve, shkaktohen anomali psikike, që rezultati i tyre është stresi i mbinivelizuar, agresivitete të ashpra etj. dhe përfundimi i kësaj lloj qenieje është në humnerë. Përderisa kemi të bëjmë me faktet që japin sëmundje psikike, pikënisja e tyre është në mosmbajtjen e baraspeshimit, ashtu siç kërkon Krijuesi i çdo gjëje, nga ata komponentë që ishte e formuar ajo qenie, njeriu. Për mbajtjen e baraspeshës pa dyshim kërkohet ndonjë fuqi që nuk është në dorën njerëzore, e ajo fuqi është fuqia e fjalës së Allahut xh.sh. e që është për qëllim fuqia e Kur`anit.

Por, tash na hapet një shteg tjetër, si mund ta shfrytëzojmë këtë fuqi të Kur`anit të Madhëruar?! Shfrytëzimi më i mirë i Kur`anit Famëlartë është "me dhënë mund maksimale që të jemi një Kur`an i gjallë". Në lidhje me ajetin e 4 të sures el-Kalem që iu shpall të Dërguarit të Allahut



s.a.v.s., ku Allahu xh.sh. thotë: ***"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!"***, Aishja (radijall-llahu anha) është pyetur nga të tjerët: "Si ishte morali (ahlaku, sjellja) i të Dërguarit të Allahut?". Përgjigjja nga Aishja ishte në këtë formë: "Morali i tij ishte Kur`ani" (Müslim, Kitâbu's-salât 746).

Jorastësisht fjalët e Allahu xh.sh. në fillim të sures er-Rahman janë: ***"Rrahmani - Mëshiruesi (Zoti ynë), Ai ia mësoi Kur'anin, E krijoi njeriun, Ia mësoi atij të folurit (të shprehurit, të shqiptuarit)."*** (Kaptina 55,1-4). Për këto ajete shumica e mufesirëve thoshin: "Allahu i Madhëruar për t`ua mësuar Kur`anin, i krijoi njerëzit dhe për ta kuptuar atë (Kuranin), e ka mësuar njeriun".

Është një fakt tejet interesant që Allahu xh.sh në këto ajete së pari thekson mësimin e Kur`anit e më pas krijimin e njeriut. Nga kjo nënkuptojmë se të mësuarit e Kur`anit është më i rëndësishëm se krijimi i vetë njeriut. Ka ardhur në këtë formë ajeti, sepse don të theksojë faktin që Allahu xh.sh. thotë se në Kur`an janë çelësat e kësaj dhe të botës tjetër. Kur thotë 'çelësat e kësaj bote', do të thotë se në të janë përfshirë të gjitha shkencat që janë në përdorim, po edhe ato shkenca që ende nuk janë në praktikën njerëzore. Do ta theksojmë vetëm një informatë, e cila gjendet në Kur`an e që ka të bëjë me lëmin e astronomisë. Sa për kuriozitet, në vitin ***1957*** është lëshuar anija e parë kozmike e quajtur ***Sputnik***. Këtë mund ta lidhim me ajetin kur`anor, ku Allahu xh.sh. thotë në suren me numër 19 (Merjem) ajeti 57: ***"Ne e ngritëm atë në një vend të Lartë (ia ngritëm lart famën)."*** Edhe pse ajeti ka të bëjë me Idrizin a.s., po nuk është e rastit si vjen në suren 19 e ajetin 57. Kjo është njëra ndër mrekullitë që gjenden në Kur`an. E kemi fjalën se edhe në këtë botë Kur`ani e ka vendin më të lartë. Kurse sa i përket çelësit të botës tjetër, nuk diskutohet ajo se shpëtimi në botën tjetër është vetëm i atyre që kanë qenë praktikues të Kur`anit dhe të jetuarit me të. Shpirti i Kur`anit na mëson neve se si mund t`i zgjidhim problemet që na paraqiten në çdo sferë të jetës dhe të marrim përgjigje në të gjitha ato pyetje që na nevojiten për një jetë sa më lumtur nën flamurin islam.

Në qoftë se i kthehemi jetës së as'habëve, sesi ata e kanë shijuar ëmbëlsinë e asaj që të jenë një Kur`an i gjallë, e kemi rastin me Ebu Bekrin r.a., i cili kur e ka dëgjuar shpalljen e ajetit kur`anor: ***"...kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me të dhe, pos Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës as ndihmës"*** (en-Nisa 123), e kanë kapluar aq thellë ethet e brendshme shpirtërore, saqë ka thënë: "U ndjeva sikur me m'u këput shpina; ngela i shtangur". Ta zbukurojmë edhe me një ngjarje që ka ndodhur me Omerin r.a., i cili ka qenë duke ecur nëpër rrugët e qytetit kur ka dëgjuar një person i cili ka kënduar Kur`an, saqë zëri i tij është dëgjuar deri jashtë. Kur i është afruar Omeri r.a. që ta shihte se kush ishte ai, në ato momente ai lexonte kaptinën et-Tur dhe, sa iu afrua Omeri r.a., u erdhi radha ajeteve 7 dhe 8: ***"Është e vërtetë se dënimi i Zotit tënd patjetër do të ndodhë; atë s' ka kush që mund ta largojë."*** Me të dëgjuar të këtyre ajeteve, Omeri r.a. u mbështet për muri dhe e kapluan të dridhurit dhe nga kjo vuajtje qëndroi disa ditë i shqetësuar në shtëpi.

Pasi që elita shoqërore e historisë së njerëzimit janë frikësuar aq shumë nga ajetet që flasin për dënimet, e ku mbeti për ne! Ani që ka të tillë që as zemrat nuk u rrëqethen, e lëre më shpirti. A nuk të habit fjala e Omerit r.a., i cili ka thënë: *"Suren Bekare e kam mësuar për 12 vjet dhe pas mbarimit të mësimit, e kam therur një kurban falënderimi"*. Mos, vallë, e ka pasë për qëllim mësimin direkt, pra mësimin përmendsh? Përkundrazi, ai e ka pasur për qëllim që për 12 vjet çdo ajet ta fut në praktikë, pra të jetë një Kur`an i gjallë, ku këtë e ka kurorëzuar me një kurban në formë falënderimi. Kjo tregon që edhe ne duhet të jemi më me vullnet ndaj asaj që ta shijojmë Kur`anin, ashtu siç kërkon vetë të shijohet ai.

E tash do të mundohemi që ta përshkruajmë një rast tejet interesant e rrëqethës, ku në të njejtën kohë do ta kuptojmë më mirë se çka do me thënë të jesh prej atyre që jetojnë me

Kur`an.

Abdullah ibn Muabreku ishte një person i cili ishte shumë i kujdesshëm në sjelljet e tij, tregon Ibn Mubareku një rast që ka të bëjë me temën tonë. Një ditë prej ditëve dola në rrugë për në haxh, për ta vizituar shtëpinë e Allahut dhe varrin e Muhamedit s.a.v.s.. Rrugës pashë diç të zezë; çka me pa, një grua që kishte veshur një jelek të vjetër bashkë me një mbulesë të leshtë dhe, kur iu afrova, e përshëndeta: *"Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berekatuhu"*,kurse ajo m'u përgjigj me një ajet nga surja Jasin: *"Kanë "Selam", thënie e Zotit mëshirues! (Jasin, 58),* që ma pranoi përshëndetjen. I thashë: *"Zoti t`i dhashtë të mirat, po çka kërkon këtu?"* M'u përgjigj me ajetin nga surja A`raf: *"Për atë që Allahu e la në humbje, s'do të ketë udhëzues, dhe ata do t'i lë të bredhin në vrazhdësinë e tyre." (A`raf, 186).* E kuptova që e paska humbur rrugën dhe e pyeta: *"Për ku je nisur?". "Pa të meta është Madhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), parësi (i punëve të Muhamedit)."* (Isra, 1). M'u përgjigj me këtë ajet kur`anor dhe ekuptova se paska bërë haxh dhe don të shkojë për në Bejtu-l Makdis. Përsëri e pyeta: *"Sa ditë je këtu?"* M'u përgjigj me ajetin 10 të sures Merjem: "Ai (Zekeriai) tha: Zoti im, më jep mua një shenjë (që të di)!" Ai (Allahu) tha: "Shenja jote është se (duke qenë shëndoshë e mirë), nuk do të mund t'u flasësh njerëzve tri net (e tri ditë)". (Merjem, 10). U habita dhe vazhdova me pyetjet: *"Nuk po të shoh se ke diçka për të ngrënë me vete"* M'u përgjigj: *"Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë"(Shuara, 79).* Nuk pushova me të pyetur. I thashë: "Me çka merr avdes?" M'u përgjigj me ajetin 43 të sures Nisa: *"...e nuk gjeni ujë, atëherë mësyne dheun dhe fërkoni me duart (tejemmum). Allahu shlyen e fal mëkatet." (Nisa, 43).* I thashë: *"Unë kam me vete për të ngrënë diçka; a po do prej saj?"* M'u përgjigj: *"...hani e pinin derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje."* (Bekare, 187). Përsëri i thashë: "Po ky muaj nuk është muaji i Ramazanit?!" Ajo m'u përgjigj me ajetin 158 të sures Bekare: *"E kush bën ndonjë të mirë nga vullneti (joobliguese), s'ka dyshim se Allahu është shpërblyes i gjithëdijshëm." (Bekare, 158). "Po neve na është lejuar që të mos agjërojmë duke qenë udhëtarë"*, i thashë. Përsëri m'u përgjigj me ajetin 184 të sures Bekare: *"Mirëpo, po qe se dini, agjërimi është më i mirë për ju."* Më nuk munda të qëndroja. Pa më pyetur i thashë: "Pse ti nuk bisedon ashtu siç bisedoj unë?" Përsëri ajo m'u përgjigj me ajete kur'anore: *"Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm."(Kahf,18).* E pyeta: "A dëshiron që të të hipi mbi devenë time, ashtu që ta arrish karvanin tend?" Ajo më tha: *"Allahu di për atë që e punoni nga e mira." (Bekareh, 197).* Pasi që u pajtua që ta hip në deven time, që ta arrijë ajo karvanin e tyre, menjëher[ e ula devenë dhe aty, duke hipur, më tha: *"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit)..."(Nur, 30).* Kur hipi mbi deve, i lexoi ajetet 13 dhe 14 të sures Zuhruf: "Të uleni mbi to dhe atëherë, pasi të jeni vendosur mbi to, ta përkujtoni të mirën që u dha Zoti juaj e të thoni: 'Falënderuar qoftë Ai që i nënshtroi këto për neve, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë'. Dhe, ne me siguri do të kthehemi te Zoti ynë!". Ndërkaq, gjatë rrugës e lexoi ajetin: "...pra, falu duke lexuar Kur'an, sa t'ju vijë më lehtë..." (Muzemmil, 20). Edhe unë, kësaj radhe, ia lexova një ajet kur'anor: "Ai ia dhuron hikmetin atij që do, e kujt i është dhënë hikmeti, i është dhënë mirësi e shumtë, por nuk përkujtohet askush pos të mençurve." (Bekare, 269). Dhe, arritëm në grupin (karvanin) e tyre dhe i thashë: "Ja, arritëm në karvanin tuaj; kë e ke në mesin e tyre?" M'u përgjigj me ajetin 46 të sures Kehf: *"Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë".* Nga ky ajet kuptova se ka fëmijë në mesin e tyre. Më pas e pyeta: "Përse janë në haxh fëmijët e tu?" M'u përgjigj me ajetin 16 të sures Nahl: "Vuri edhe shenja të tjera (për orientim ditën), ndërsa (natën) ata orientohen me anën e yjeve." E kuptova se fëmijët e kësaj ishin udhërrëfyes, e kishte për qëllim rregullimin e çadrave. Përsëri e pyeta: Vuri edhe shenja të tjera (për orientim ditën), ndërsa (natën) ata orientohen me anën e yjeve. M'u përgjigj me një sëri ajetesh, siç ishin, ajeti 125 i sures Nisa: *"Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është bindur Allahut dhe, duke qenë bamirës, e ndjek fenë e drejtë të Ibrahimit? Allahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin më të ngushtë."*, ajetin 164 të sures Nisa: *"...e Musait i foli Allahu me fjalë"*, po ashtu edhe me ajetin 12 të sures Merjem: *"O Jahja, merre librin me shumë kujdes dhe, ashtu dhe ashtu, Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë."*. Pas kësaj unë i thirra: *"O Ibrahim, o Musa, o Jahja"*, ku dolën tre djem që shkëlqenin si hënë. Pasi erdhën dhe u ulën, nëna e tyre ua lexoi ajetin 19 të sures Kehf: *"...prandaj dërgojeni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ju sjellë atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju"*. Shkoi njëri prej të rinjve, bleu diçka për të ngrënë dhe në atë moment nëna e tyre lexoi ajetin 24 të sures Hakka: *"(E thuhet) Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë"*. Pasi që ma servirën ushqimin, djemve të saj u thashë: *"Le të më bëhen haram këto mua nëse nuk ma tregoni shkakun se përse nëna juaj është kështu (bisedon kështu)"*. Djemtë iu përgjigjën se përse nëna e tyre vepron kështu. Ata thanë: ***"Kjo është nëna jonë, Zoti e Mëshiroftë; ajo nga frika që të mos bëjë mëkat, 40 vitet e fundit nuk flet asnjë fjalë pos fjalëve të Zotit."*** Pasi që e dëgjova këtë, lexova ajetin 4 të sures Xhuma: *"Kjo është mirësi e Allahut, që ia jep atij që do, e Allahu është Zoti i dhuntisë së përsosur."*.

Nga gjithë kjo ngjarje, mund të konkludojmë se njeriu vetëm me ajete kur`anore mund të jetojë. Andaj, si porosi e fundit do të ishte edhe ajeti kur'anor ku Allahu xh.sh. thotë: *"Ne të shpallim Kur'anin, që është shërim për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u dhuron tjetër, përpos dëshpërim." (Isra, 82).*

Lusim Allahun xh.sh. që të na bëjë prej atyre që të jetojm[ me dritën dhe shpirtin e Kur`anit.



# Të jetosh me KUR'AN

**"Shtëpia më e pavlerë është ajo shtëpi që nuk e ka librin e Allahut".**
**"Më i mirë ndër ju është ai që mëson Kur'an dhe që ua mëson të tjerëve".**

**MR.LUTFI NEXHIPI**

Kur'ani Famëlartë është libri me të cilin Allahu xh.sh. përmbylli të gjitha shpalljet hyjnore. Kur'ani si libër hyjnor është mrekulli e përkryer, që vërteton pejgamberllëkun e Muhamedit a.s., është libri që përmban norma, ligje, këshilla etj. Me një fjalë, Kur'ani është kushtetutë e çdo besimtari musliman, i cili nëse veprimet e veta i harmonizon në përputhje me mësimet e tij, do ta gjejë lumturinë në këtë botë dhe shpëtimin në botën e ardhshme. Kur'ani është libri që ka ndërruar përfundimisht rrjedhat e gjithëmbarshme të historisë njerëzore, duke çuar përpara dijen, zhvillimin dhe përparimin e njeriut. I dërguari i Allahut, Pejgamberi a.s., thotë:

*"Në librin e Allahut gjenden tregime për ata që ishin para jush, por ka edhe norma për jetën tuaj dhe atyre që do të vijnë pas jush. Ai është ndarës i të vërtetës nga gënjeshtra, nuk është thashethem, e kotë. Ai i cili e braktis atë nga dhuna e ndonjë zullumqari, Allahu e dënon. Ai i cili kërkon udhëzim jashtë tij, Allahu atë do ta lerë kokë për kokë me sjelljen e tij të shëmtuar. Ai është libri i shëndoshë i Allahut, këshillë që e ndan diturinë e vërtetë nga e gabuara. Ai është rrugë e drejtë. Zemrat që janë të lidhura me të nuk devijojnë, nuk rrëshqet gjuha që të infektohet me të humburën, nuk ngopen dijetarët me të,*

*nuk vjetrohet ai me lexim, nuk kanë fund mrekullitë e tij. Kur e dëgjuan atë xhindet, nuk patën mundësi që të ruhen nga thënia:* "... Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij...".(Xhinde-1,2) *Kush flet sipas tij, e ka thënë të vërtetën; kush e jeton jetën me të, e gjen shpërblimin në këtë botë dhe në botën tjetër. Kush gjykon me të, ka gjykuar me të drejtë. Ai që fton në të, ka bërë thirrje në një rrugë shumë të vërtetë."*

**VLERA E KURANIT**

Ai duhet lexuar Zotit të Madhëruar, që të bën të meditosh rreth kuptimit të pasur të tij. Kështu, shpërblimi, mirësia që vjen pas leximit të Kur'anit është shumë e madhe. Në shkëmbim të çdo shkronje jepen dhjetë sevape, prandaj Pejgamberi a.s. ka porositur kështu:

*"Çdokush që lexon një shkronjë nga Kur'ani famëlartë, ka një mirësi. Dhe, për çdo mirësi ka dhjetë sevape. Unë nuk po them se "elif lam mim" është një shkronjë; por elifi është një shkronjë, lami është një shkronjë dhe mimi është një shkronjë".*

Kudo që përmendim virtytet në librat fetarë, njëra prej tyre patjetër është leximi i Kur'anit. Për shembull:

"Zemra ka pesë ilaçe". Njëri prej tyre është leximi i Kur'anit.

Në një porosi të tij Pejgamberi a.s. thotë:" Tre zëra i do Allahu i Madhëruar". Njëri prej tyre është " Zëri i besimtarit që lexon Kur'anin Famëlartë".

Thuhet se "Katër gjëra ndriçojnë varrin e besimtarit". Njëra prej tyre është leximi i Kur'anit Famëlartë.

Tregohet se "Mburojat e besimtarit jane tri". Njëra ndër to është leximi i Kur'anit.

Leximi i Kur'anit famëlartë ndriçon zemrën dhe largon gjynahet. Njëherë Pejgamberi a.s. duke biseduar me as'habët e tij ju tha: *" Edhe zemrat ndryshken si hekuri",* as'habët e pyetën: "O i dërguar i Zotit, me se pastrohet ndryshku i zemrave?" Pejgamberi a.s. u tha: *"Pastrohet duke lexuar Kur'anin Famëlartë dhe duke kujtuar vdekjen".*

Si duhet lexuar Kur'anin Famëlartë?

Kur'anin Famëlartë duhet lexuar duke e menduar kuptimin ngadalë, një nga një, dhe duke e shqiptuar çdo shkronjë me shqiptim të plotë. Andaj, në ajetin kur'anor thuhet: "Lexoje Kur'anin ngadalë dhe me vëmendje".(Muzemmil-4). Në një hadith thuhet: " *Atij që lexon përherë Kur'an, në xhenet do t'i thuhet kështu: Lexo dhe ngrihu! Sikur e ke lexuar ngadalë dhe me vëmendje në këtë botë, ashtu lexoje edhe këtu. Pa dyshim që grada jote është sipas leximit që u ke bërë ajeteve."*

Kur lexohet Kur'ani Famëlartë, duhet heshtur dhe duhet dëgjuar me përkushtim të veçantë. Prandaj, edhe në Kur'anin Famëlartë thuhet: "Kur lexohet Kur'ani, dëgjojeni dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë". (A'raf-204)

Në një shtëpi ku lexohet Kur'ani Famëlartë shtohet pasuria dhe begatia. Ebu Hurejre r.a. thotë: "Në atë shtëpi ku lexohet Kur'ani Famëlartë shtohet pasuria dhe begatia. Largohen djajtë dhe engjëjt zbresin pikërisht aty. Në shtëpinë ku nuk lexohet Kur'ani Famëlartë, paraqiten skamje, shqetësime dhe probleme. Engjëjt e mëshirës largohen prej aty dhe e pushtojnë djajtë atë vend."

Në një hadith, në lidhje me një shtëpi ku nuk lexohet Kur'ani thuhet: *"Shtëpia më e pavlerë është ajo shtëpi që nuk e ka librin e Allahut".*

*"Më i mirë ndër ju është ai që mëson Kur'an dhe që u mëson të tjerëve".*

Pejgamberi a.s. thotë: *"Dy njerëz ia vlen të kihen zili. Njëri është ai që e përvetëson Kur'anin dhe që lexon Kur'anin ditë e natë. Kurse tjetri është ai që Allahu i ka dhënë plot pasuri dhe që e jep atë ditë e natë".*

**MIRËSIT E KURANIT**

Kur'ani Famëlartë duhet lexuar shumë. Sepse, në ditën e gjykimit ai do t'ju bëhet ndërmjetësues lexuesve të tij. Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Lexoni Kur'anin, sepse Kur'ani në ditën e gjykimit do të ndërmjetësojë ata që e kanë lexuar atë".*

Në një hadith bëhet një krahasim i tillë për muslimanët që lexojnë Kur'an dhe që nuk lexojnë, ku thuhet: *"Besimtari që lexon Kur'an është si portokalli, aromën e ka të këndshme dhe shijen të mirë. Besimtari që nuk lexon Kur'an është si hurmë, nuk ka aromë, ndërsa shijen e ka të mirë. Hipokriti që lexon Kur'anin Famëlartë është si borzilok (bimë barishtore), aromën e ka të këndshme, mirëpo shijen e ka të hidhur. Hipokriti që nuk lexon Kur'anin Famëlartë është si shalqi (bimë), nuk ka aromë dhe shijen e ka të hidhur".*

Ata që kanë mësuar përmendsh Kur'anin përgëzohen me ndërmjetësim dhe xhenet. Pejgamberi a.s. thotë kështu: *"Kush e lexon Kur'anin Famëlartë, e mëson përmendsh atë, të lejuarën e pranon të lejuar dhe të ndaluarën të ndaluar, Allahu në saje të kësaj e shtyn atë në xhenet. Ai person ndërmjetëson për dhjetë vetë nga familja e tij, të cilët e kanë merituar xhehenemin".*

Allahu i Madhëruar e lartëson dhe e nderon popullin që e respekton Kur'anin Famëlartë dhe ligjin e tij. Ndërkaq, ata popuj që nuk e vlerësojnë Kur'anin, i degradon dhe i shkatërron. Në një hadith përmendet kështu: *"Pa dyshim që Allahu i Madhëruar, për shkak të Kur'anit disa popuj i lartëson dhe popujt e tjerë (që nuk e vlerësojnë si duhet) i degradon".*

Përveç se na duhet ta lexojmë Kur'anin që të gjejmë jetë në të, duhet të zbatojmë të gjitha fragmentet e jetës sonë me përkujdesje ndaj urdhëresave dhe ndalesave të tij, sepse Kur'ani Famëlartë nuk ka zbritur vetëm që të lexohet, por edhe të zbatohet nga çdo individ dhe çdo shoqëri.

Hasan el- Basriu thotë: "Allahu i mëshiroftë këta robër, të cilët në çfarëdo gjendje që të jenë për bazë e marrin udhëzuesin Hyjnor, Kur'anin; nëse veprat e tyre janë sipas Kur'anit, ta falënderojnë atë dhe nga Allahu kërkojnë që t'ua rrit këtë mirësi, mirëpo në qoftë se punët e tyre nuk janë sipas normave kur'anore, ata menjëherë e braktisin".

# Familja, bërthamë e shoqërisë së shëndoshë

**Sot, kur të gjitha vlerat njerëzore, pra, edhe ato fetare, janë lëkundur, ku edhe vlerat e institucionit të familjes islame nuk janë kursyer, shprehet nevojë e madhe që vlerat e familjes të ruhen, që jeta familjare të kthehet në rrugën e saj të vërtetë, që këtij institucioni hyjnor t'i jepet forma e atillë çfarë duhet ta ketë. Ikja nga obligimet, respektivisht, synimi drejt jetës së lirë e pa brenga, ikja nga jeta familjare, është karakteristikë e kohës e cila e ka përfshirë njeriun e sotëm.**

NGA SHABAN AZIRI

## FAMILJA, INSTITUCIUON HYJNOR

Për familjen janë dhënë përcaktime të shumta dhe ato ndryshojnë prej njëra - tjetrës. Një prej përcaktimeve më të përhapura e trajton familjen si një grup personash të lidhur nga gjaku dhe martesa, të cilët jetojnë bashkë për periudha të gjata kohore, ku pjesëtarët e moshës madhore kanë përgjegjësinë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Familja, sipas Islamit, është institucion hyjnor, origjina e së cilës rrjedh që me krijimin e njeriut të parë dhe ka për qëllim që njeriut t'i mundësojë veprime normale. Njerëzimi është produkt i institucionit të familjes e jo institucioni produkt i racës njerëzore.

Familja muslimane përbën bërthamën e bashkësisë së pastër e të mbarë. Kështu, mbarësia e individit është e lidhur kryekëput me mbarësinë e familjes, bile edhe mbarësia e bashkësisë (shoqërisë) varet nga mbarësia e familjes. Për këtë, feja islame i kushton një interesim dhe rëndësi të dorës së parë çështjes së familjes e gjithçka që ka të bëjë me të, sikurse bazat mbi të cilat duhet ngritur, shkaqet e vazhdimësisë në ruajtjen e lidhjeve dhe kompaktësia në të, me qëllim që familja muslimane të mbetet e konsoliduar dhe e mbrujtur vazhdimisht me frymën e dashurisë, mëshirës e mirëkuptimit.



Kur`ani e ka bërë mëse të qartë se si burri, ashtu dhe gruaja janë të domosdoshëm për njëri-tjetrin. Lidhur me këtë Allahu Fuqiplotë në librin e Tij, në kaptinën "En-Nisaë", verseti i pare, thotë:

*"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një veteje dhe nga ajo krijoi palën e saj dhe prej atyre dyve, u shtuan shumë burra e gra".*

Nga vetë fjalët e ajetit kuptohet se Allahu xh.sh. prej të njëjtit lloj krijoi burrin dhe gruan dhe në të njëjtën kohë deklaron qëllimin e krijimit të kësaj qenie të veçantë, së cilës di t'ia besojë sundimin e botës. Ai krijoi, kështu, Ademin a.s. dhe Havën r.a. nga e njëjta substancë dhe vendosi bazat e barazisë së tyre, në essence, si qenie njerëzore dhe si krijesa të Allahut.

Gjithashtu, për familjen është vlerësuar se është burim i më shumë institucioneve shoqërore, që nga familja deri te shteti. Ajo është bërthama e shoqërisë, e ndërtuar mbi baza të shëndosha, të cilat kanë aftësi që të gjejnë mirëkuptim, sinqeritet dhe intimitet të përkryer. Në Fenë islame thuhet se nuk ka marrëdhënie më të natyrshme se ato të gjakut dhe se nuk ka shembull më të mirë të intimitetit seksual përveç atij ku gërshetohen morali dhe kënaqësia.

Feja islame e pranon vetëm mënyrën familjare të jetesës. Rregulla e tillë nuk është as e rastit dhe as e pavlerë. Vlera dhe rëndësia më e madhe e familjes qëndron në fak-

tin se ajo është institucion i shenjtë.

Fatkeqësisht, sot institucioni i familjes është duke u rrezikuar nga një lloj i krizës së qytetërimit tonë. Të gjitha simptomat tregojnë se kjo krizë e ka dëmtuar institucionin e familjes dhe në mënyrë të posaçme e ka dobësuar. Ajo gjendet në shkatërrim si në Evropë, ashtu edhe në Amerikë. Kjo gjendje duhet të shërbejë si sinjal dhe ta zgjojë njeriun bashkëkohor për ta mbrojtur institucionin e familjes dhe vlerat e saj.

Sot, kur të gjitha vlerat njerëzore, pra, edhe ato fetare, janë lëkundur, ku edhe vlerat e institucionit të familjes islame nuk janë kursyer, shprehet nevojë e madhe që vlerat e familjes të ruhen, që jeta familjare të kthehet në rrugën e saj të vërtetë, që këtij institucioni hyjnor t'i jepet forma e atillë çfarë duhet ta ketë. Ikja nga obligimet, respektivisht, synimi drejt jetës së lirë e pa brenga, ikja nga jeta familjare, është karakteristikë e kohës e cila e ka përfshirë njeriun e sotëm.

Duke e konsideruar njeriun të lirë për të zgjedhur mënyrën e tij të jetesës, ku burri dhe gruaja mund të jetojnë njëri pa tjetrin, me disa gra apo me disa burra, fëmijëve të lindur nuk u dihet me saktësi atësia dhe një pjesë e tyre ngel nën kujdesin dhe kontrollin e shtetit. Në të tilla raste bie përgjegjësia e prindit për fëmijët. Sipas mësimeve islame, njeriu nuk është i lirë të bëj çfarë të dojë dhe kur të dojë. Prandaj, është e domosdoshme familja, ruajtja e saj, barazia në të, rritja e fëmijëve me normat e edukatës moralefetare.

Institucioni i familjes në Islam është i shenjtë dhe, si i tillë, ka përcaktuar konceptet e përgjithshme që duhet t'i përmbush familja si bazë themelimi e një strukture shoqërore, fetare dhe kulturore. Lartësimi shpirtëror, edukimi moral, përmbajtja ndaj emocioneve dhe epsheve shthurëse, sjellja e mirë ndaj gruas (burrit), detyrat ndaj familjes dhe fëmijëve, kanë qenë ndër kriteret e obligueshme për njeriun në Islam.



## ROLI I FAMILJES NË EDUKIMIN E BREZIT TË RI

Pasqyrimi i gjendjes së njerëzimit na bën të shohim se familja është institucioni i parë dhe më i rëndësishmi midis institucioneve sociale, si dhe forma më e hershme e shoqërisë njerëzore, e që është rezultat i vetë martesës. Shkaktarë kryesorë të jetës familjare janë faktet se mashkulli vetvetiu nuk mund ta sigurojë riprodhimin dhe ngritjen e fëmijëve dhe se familja siguron vazhdimësinë e jetës nëpërmjet lindjes dhe mirërritjes së fëmijëve. Brenda familjes fëmijët lindin jo vetëm si qenie biologjike, por edhe si anëtarë të një shoqërie të caktuar.

Familja është shkolla e parë ku formohen njerëzit dhe qytetarët e ardhshëm, prandaj detyra e saj është të përgatit dhe të rrit pasardhës në frymën dhe sipas porosive të Krijuesit të gjithësisë, sipas edukatës islame, me qëllim që fëmijët e tyre të bëhen shkolla më të mira në përgatitjen e fëmijëve të tyre për jetë familjare e shoqërore. Kjo kërkon që problemi i edukatës të mbështetet në kultivimin e ndjenjave fisnike, në kultivimin e disiplinës, në formimin e shprehive të kultivuara higjienike, në veprimtari të dobishme, në raporte të drejta midis dy gjinive, në humanizimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore etj. Si metodë kryesore e prindërve për edukimin e fëmijëve me mendime, shije e norma të shëndosha morale, shërben në radhë të parë shembulli personal, mënyra e jetesës dhe e sjelljes së prindërve, zakonet, rrethi dhe ambienti, karakteri dhe ndikimi i të rriturve.

Fëmija janë gëzimi dhe lumturia më e madhe e prindërve, sepse në to shikohet vazhdimi i ekzistimit vetjak. Nuk mjafton vetëm të kesh fëmijë, të ndjesh kënaqësi për ta dhe t'i duash, por duhet t'i dish detyrat dhe obligimet ndaj fëmijëve. Edukimi i fëmijëve është obligimi kryesor, sepse nga edukimi i mirë varet fati dhe përparimi i individit dhe i mbarë njerëzimit. Që prindi të arrijë t'i edukojë fëmijët e tij me sukses, duhet që vetë të jetë i kompletuar me edukatë të shëndoshë dhe shembullore. Muhamedi alejhiselam ka thënë: *"Secili prej jush është përgjegjës për vartësit e vet"*. Kjo do të thotë se çdo prind është përgjegjës



për fëmijët e vet. Për t'u plotësuar funksioni i vërtetë i familjes, prej prindërve kërkohet që ta përqendrojnë vëmendjen në këto pika:

Është detyrë fetare që prindi foshnjës së posalindur t'ia lexojë ezanin në vesh. Qëllimi është që, para së gjithash, deri te veshi t'i arrijë fjala e mirë dhe emri i Zotit.

Obligohet prindi që, me kalimin e ditës së shtatë, fëmijës t'i japë një emër të bukur, kuptimplotë dhe të pëlqyeshëm.

Për të pasur fëmijë me shije të lartë dhe edukatë të shëndoshë, duhet që fëmijëve t'u mësohet feja e vërtetë, fryma e moralit islam, si dhe parimet themelore të tij.

Për të përfituar fëmijë me edukatë të shëndoshë, ndikon qumështi i nënës, me moral të mirë e që jeton në mënyrë të ndershme. Fëmija që ushqehet me qumësht haram, prishet nga natyra morale dhe fiton prirje për cilësi negative.

Prindi duhet të ketë kujdes në pastërtinë fizike e morale të fëmijës, që tek ai të nguliten ndjenjat e personalitetit, dashurisë, mirëkuptimit, mirësjelljes dhe tolerancës.

Fëmijën duhet mësuar që të mos ngutet gjatë ushqimit, mos ta mbush gojën plot, të përtyp ushqimin mirë dhe të mos hajë tepër.

Prindi është i obliguar që fëmijëve t'ua sigurojë nevojën materiale, ndërsa nëna të kujdeset për mirëqenien trupore.

Pra, familja muslimane është përgjegjëse para Allahut xh.sh. sa i përket edukimit të fëmijëve. Lind pyetja: Vallë, a po e kryejnë familjet tona sot atë që u ngarkohet në përcjelljen e mesazhit edukativ te fëmijët? A mblidhen pjesëtarët e familjes rreth sofrës kur'anore, apo rreth asaj të mëkateve dhe të gjynaheve? Vallë, fëmijët tanë a gjejnë në familje atë që është e dobishme, e mbarë dhe e mirë për ta, apo gjejnë diçka tjetër? Është për të ardhur keq se sot shumë familje i kanë harruar të drejtat dhe detyrat që kanë ndaj fëmijëve të tyre. P.sh., është ulur kujdesi për ruajtjen e moralit të fëmijëve, dominon një liri e pakufizuar, nuk kërkohet llogari, e për rrjedhojë sot shumë të rinj e të reja përdorin alkoolin, drogën dhe merren me prostitucion etj. Në këtë mënyrë nuk i pritet rruga këtyre veseve të liga të cilat degjenerojnë rininë, e më vonë familjen, e cila në të tilla kushte nuk ka bazë reale. Të çudit fakti se, në disa raste ka prindër që interesohen më shumë për pasurimin e fëmijëve, pajtohen deri me dërgimin e vajzave të tyre prostituta, për të siguruar jetën e tyre materiale. Cila është më e rëndësishme në këto raste, pasuria apo fëmija? Sigurisht se fëmija është më i rëndësishëm dhe kur prindi kujdeset për fëmijët e tij dhe i edukon me frymën fetare, pa dyshim edhe fëmijët, në emër të Zotit do të kujdesen për ta.

## FAMILJA NË SHËRBIM TË MBROJTJES SË MORALIT

Familja është fusha më e rëndësishme dhe institucioni i vetëm i cili mundëson jetë të shëndoshë, mbron bashkëshortët nga jeta imorale, shfrenimi, konfuziteti dhe siguron klimë të përshtatshme për zhvillimin e potencialit shpirtëror të burrit dhe të gruas, si dhe të pastërtisë morale. Familja si pjesë e rendit shoqëror duhet të karakterizohet nga një sjellje e përkryer mes individëve, për t'ia prerë rrugën shkatërrimit të saj. Imoraliteti konsiderohet si një krim, me pasoja shkatërruese për familjen dhe shoqërinë. Historia dëshmon se jeta imorale shpeshherë ka tundur institucionin e familjes dhe palët e kurorëzuara. Për shkak të jetës imorale, është përmbysur perandoria e madhe romake. Me fjalë të tjera, derisa femrat e popullit bizantin, popullit grek dhe popullit romak ishin të personifikuara me vyrtitshmëri, derisa ishin femra dhe nëna shembullore, këta popuj përjetuan përparim të madh në çdo pikëpamje, krijuan vepra të mëdha artistike dhe pushtuan shumë vende. Mirëpo, kur në fron të mbretërisë së këtyre popujve ishin ulur laviret e njohura si Mesalin, Popeja e të tjera, këta popuj filluan shkallmimin.

Në këtë rast nuk mund e të mos i përmendim fjalët e dijetarit të njohur egjiptian, Muhamed Abduhu, i cili kishte theksuar:

"Unë dikur isha i mendimit se egjiptianët asnjëherë nuk mund të zhduken as të çrrënjosen, edhe sikur çfarëdo populli të vinte midis tyre dhe të jetonin nën sundimin e kujtdoqoftë. Këtë e kontstatova në bazë të histories, e cila tregon se egjiptianët brenda kaq shekujve kanë jetuar nën sundimet e huaja, të përzier me elemente, zakone dhe tradita të huaja, por, megjithatë, mbetën të njëjtit ata, egjiptianë të vjetër. Mirëpo, tash kur shoh se në çfarë mase midis tyre po manifestohet alkoolizmi dhe prostitucioni, e kam ndryshuar mendimin tim për ta".

Ngjashëm deklaroi edhe ish-presidenti amerikan John Cennedi lidhur me rininë amerikane. "Rinia amerikane është në rrezik të madh nga amoraliteti. Në shtatë të rekrutuar për ushtri, gjashtë janë të paaftë, për shkak se kanë bërë jetë të shthurur dhe kështu kanë humbur zotësinë dhe aftësinë trupore dhe shpirtërore".



# Kur’ani dhe teoritë shkencore

**“Ne do t’u bëjmë të mundur që të shohin Shenjat Tona në të gjitha horizontet si dhe në vehten e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se Ai (Kur’ani) është i vërtetë “. Sexhde- 53**

**MUHAMMED MUTEVEL-LI EL-SHA’RAVI**

Para se të futemi në temë, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Kur’ani i Madhëruar është libër universal. Ai vazhdimisht jep risi për çdo gjeneratë dhe kjo e bën ate të Madhëruar. Sikur mos të ishte Kur’ani libër universal që sjell risi të vazhdueshme, atij për një kohë të shkurtër do ti humbej vlera. Shihet qartë se Kur’ani është i pa shterrur,ushqen çdo gjeneratë aq sa ajo gjeneratë është në gjendje të marrë prej tij. Kështu e ushqen çdo gjeneratë duke ia dhënë ate që nuk ia dha gjeneratës së më parme.

Para se të flasim për të vërtetat e gjithësisë, ne duhet t’u përgjigjemi dy pyetjeve shumë të rëndësishme.
1. Mundësinë e lidhjes mes Kur’anit dhe teorive shkencore. Disa nga dijetarët gabojnë kur mundohen t’a shpjegojnë Kur’anin me zhvillimet shkencore. Fjalën e All-llahut xh.sh. e mbronin me teoritë shkencore që zbuloheshin. Mund të ndodhë që këto zbulime të jenë të gabuara dhe do të dalë se Zoti qenka gabim. Kur’ani, nuk është libër shkencor e të ketë nevojë për ta vërtetuar shkenca. Ai është libër adhurimi, me program dhe sistem jete. Ajo se ç’ka ka Kur’ani, e di vetë All-llahu, duke qenë se Ai e di se do të vijë një kohë kur Kur’ani do të kuptohet shumë më lehtë, pasi të kenë ardhur gjenerata tjera të cilat do të thonë se perëndoi koha e besimit. Tani jemi në kohën e shkencës. Këta do ta vërtetojnë mrekullinë e Kur’anit dhe do të flasin për të vërtetat e gjithësisë ashtu siç theksoi Kur’ani shumë shekuj më parë. Zbulimet e vërtetuara i japin kurajo njerëzimit, të thonë se njeriu e vërtetoi atë që thoshte Kur’ani. Kur’ani pra është dhurues i përhershëm, risitë e tija s’kanë të mbaruar. All-llahu në Kur’an thotë: **“Ne do t’u bëjmë të mundur që të shohin Shenjat Tona në të gjitha horizontet si dhe në vehten e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se Ai (Kur’ani) është i vërtetë “.** Sexhde- 53

Duhet të kemi kujdes në shkronjën (S in) në fjalën (Senurihim – do t’u

bëjmë të mundur). Ky sin jep kuptimin e një të ardhme. Sa herë të lexohet Kur'ani, e ardhmja është e pa definuar nga gjenerata në gjeneratë, deri në Ditën e Kijametit. Kjo të jep vizion të qartë, se shenjat e All-llahut, nuk kanë të mbaruar, ato do të zbulohen ndër gjenerata. Por kjo nuk do të thotë që ne ta marrim barrën të cilën nuk jemi në gjendje ta bartim. Ne duhet ta trajtojmë Kur'anin, si libër i cili na këshillon për njohuritë e botës. Kur'ani nuk na mëson sekretet se si të arrijmë deri te shkencat e përsosura teknike, ose astronomia, shkenca elekronike etj. Në Kur'an, pas sures së parë, pra Hapjes së Kur'anit, me rradhë vjen suretul Bekare e cila fillon me fjalët: Elif, Lam, Mim, Ky është një libër në të cilin nuk ka kurrëfarë dyshimi, është udhëzues për të devotshmit …"

Pra, Kur'ani është libër udhëzimi. All-llahu na dhuroi ajete të shumta të cilat do të na shërbejnë për përgjigje ndaj sulmuesve të Kur'anit, deri në Ditën e Kijametit. Ajete të shumta që gjenden në Kur'an, janë zbuluar ose janë të njohura për ne. Ajetet të cilat nuk janë të zbuluara, dhe janë ende të pa qarta për ne, na shërbejnë për t'u thënë sulmuesve të Kur'anit, të cilët thonë se perëndoi koha e besimit, se tani jemi në kohën e shkencës. E këta sulmues do të krijojnë diçka që nesër do t'u thonë njerëzimit se ky është Zot. Ky është produkt i diturisë sonë dhe krijimtari e jona. Mos i adhuroni krijesat e ta largoni Krijuesin. Kjo na detyron që shkencën ta përdorim për ta vërtetuar Kur'anin, sepse Kur'ani është argument i padiskutueshëm për vërtetësinë ose jo vërtetësinë e shkencës. Një shkencë e cila është në kundërshtim me Kur'anin e Madhëruar është gënjeshtër dhe e pa pranuar. Kur'ani është Fjala e All-llahut, përmes tij adhurohet deri në Ditën e Kijametit. Nuk ndryshon dhe nuk zëvendësohet. Është e rrezikshme lidhja e Kur'anit me teoritë shkencore, shpeshherë teoritë shkencore janë jo të sakta dhe të pavërteta. Ne jemi larg shpjegimeve të tyre, pasiqë ato mund edhe të vërtetohen se ishin teori të pa sakta. Prandaj këto nuk ndryshojnë ose nuk zëvendësojnë asgjë nga fjala e All-llahut xh.sh. Për këtë arsye sygjeroj të gjithë dijetarëve, të mos shpejtojnë në vërtetësinë e çfarëdo zbulimi shkencorë, dhe të krahasojë këtë zbulim shkencor me Kur'anin, përderisa të mos janë të bindur dhe të kenë bindje të plotë për vërtetësinë e tij. Do të jemi shkaktarë për një gabim të pafalshëm ndaj njollosjes së Kur'anit, kur të vërteohet pasaktësia e atij zbulimi.

## PSE U LA PA SHPJEGIM

Shtrohet pyetja, pse nuk u shpjeguan ajetet shkencore për bashkëkohësit e zbritjes së Kur'anit, ose të paktën të shërbente për gjeneratat e ardhshme. Dihet se të vërtetat e universit për të cilat është sinjalizuar në Kur'an nga ana e All-llahut xh.sh. kanë të bëjnë me proceset më të mëdha të kozmosit. Ato janë në shërbim të njeriut, qofshin ato në dijen e njeriut ose jo. Dielli, rrotullimi tokës, gravitacioni i tokës, nata dhe dita, si dhe procese të tjera natyrore, e në anën tjetër shkenca e embriologjisë si dhe gjithçka që është rreth njeriut, edhe këto kanë të bëjnë me regullat e proceseve natyrore. Rregullat e krijimit janë në shfrytëzim të njeriut, i njohëm ato ose jo. Miliona njerëz nuk dijnë asgjë për gravitacionin e tokës, mirëpo ata i shfrytëzojnë këto rregulla. Miliona njerëz nuk dinë asgjë për rregullat e natyrës, për precizitetin dhe balansin, mirëpo, ata i shfrytëzojnë këto rregulla. Miliona njerëz nuk dinë asgjë për jetën e fetusit në mitrën e nënës por, ajo nuk i pengon ata të mos lindin fëmijë.
Të gjitha këto, si dhe të tjera, nuk u shpjeguan nga All-llahu, sepse ato ishin në shfrytëzim të njeriut. Nuk kishte nevojë të shpjegoheshin, ishin ata në dijeni të plotë për to ose jo. Kjo është mrekulli e Kur'anit, ju jep njohuri aq sa do ta kuptojnë atë. Këto ajete u shpjeguan dhe do të shjegohen ndër gjenerata, do të shpjegohet aq sa do ta kuptojë njerëzimi në kohën në të cilën jeton.

## TOKËN E SHTRUAM

Të shohim tani vërtetësitë dhe realitet e Kur'anit. Të shohim nëse kemi të bëjmë me keqinterpretime, apo përplasje në mes së vërtetës shkencore dhe asaj Kur'anore!? Disa nga dijetarët përmendin se All-llahu xh.sh. në Librin e Tij thotë:

**" Ndërsa tokën e kemi shtruar ".** Sexhde-53

Fjala med ka kuptimin, shtruarje, d.m.th e kemi shtruar. Tokën e shohim të shtruar para nesh. Nuk ka kurrfarë përplasje në mes Kur'anit dhe asaj që shohim para nesh. Por kur u zbulua se toka është e rrumbullakët, u ngritën disa dijetarë fetarë dhe kundërshtuan këtë zbulim ngase mendonin se është në përplasje me Kur'anin. U themi se ishte keqinterpretim nga disa komentatorë të Kur'anit. All-llahu i Lartëmadhëruar, në Kur'an na kishte dhënë argumentin se toka është e rrumbullakët. Ai na informoi se toka dhe krijimi i saj është në formë topthi. Të polemizojmë rreth kësaj.

Përmendëm se në Kur'an thuhet: "Ndërsa tokën e kemi shtruar". All-llahu nuk tha se toka është e rrafshtë, gjë që nënkupton se ngado që të sillesh, toka është e rrafshtë. Nëse gjendesh në një pikënisje, sheh se toka para teje është e rrafshët. Po u ngjite më në veri, pra, në polin e veriut, sheh se toka është e rafshët. Nëse shkon në Evropë, Amerikë, Azi, ose në Afrikë, toka para teje është e rrafshët. Toka është e rrafshtë në çfarëdoqoftë këndi të rruzullit tokësor, e kjo nuk do të mund të ndodhte nëse toka nuk do të ishte e rumbullakët. Sikur toka të ishte në formë cilindri, katrori, trekëndëshi, gjashtëkëndëshi, ose në çfarëdo forme tjetër gjeometrike, do të arrinim vetëm në një skaj të saj. Përderisa nuk kemi arritur asnjëherë në një nga skajet e saj, nënkuptohet se toka nuk ka formë tjetër përpos formës së rrumbullaktë.

Mrekullinë e Kur'anit, unë e shoh në thënien: "Ndërsa tokën e kemi shtruar". Edhe kjo është një nga vërtetimet e All-llahut për formën e rumbullakët të tokës. Këtu është shfrytëzuar thënia që do të kuptohet

nga të gjithë në kohën e zbritjes së Kur'anit, dhe në të njëjtën kohë, nuk bie ndesh me shkencën. E gjithë kjo, ndodhë në dy fjalë të vetme, jepet lajmi ose sekreti i tokës në këto dy fjalë të vetme. Pra, kjo nuk mund të bëhet nga dituria e njeriut. All-llahu na ka sinjalizuar për formën e tokës edhe në katër fjalë të cilat ishin në kohën e krijimit.

### PARAPRINË NATA APO DITA

All-llahu xh.sh. në suren Ja-Sin thotë: **"As dielli nuk duhet ta arrijë hënën, dhe as nata s'është para ditës …"** Ja Sin-40

Fjala këtu është për rregullat e gjithësisë. Dielli nuk mund ta arrijë hënën, sepse siç është thënë nga shkencëtarët, ato lundrojnë nëpër orbita të veçanta. Kjo e vërtetë shkencore është zbuluar tani pak para disa vitesh, kurse Kur'ani e ka sinjalizuar që para katërmbëdhjetë shekujsh. "…dhe as nata s'është para ditës…". Këtu, All-llahu për qëllim kishte të eliminonte një realitet të gabuar. Arabët thonin se nata është para ditës. Tek arabët dita fillonte pasi të perëndojë dielli. Kështuqë, muaji Ramazan vërtetohej pasi të perendojë dielli në fund të muajit Shaban, Bajrami vërtetohej në perendimin e ditës së fundit të muajit Ramazan. Nëse arabët thonin se nata është para ditës kjo nënkuptonte se dita nuk është para natës.

Këtu kemi të bëjmë me dy të vërteta. Nata është para ditës, si dhe dita nuk është para natës. All-llahu këtë e la pa e kundërshtuar, sepse ishte një e vërtetë. Ai ju tha atyre se thënja juaj është e vërtetë, por, këtu shtoi edhe thënien: "edhe nata s'është para ditës".

Pra, dita s'është para natës dhe as nata s'është para ditës. Kjo jep të kuptohet, se nata dhe dita ishin prezente në të njëjtën kohë, e kjo nuk mund të ndodhë nëse toka nuk është e rrumbullakët. Ky nuk është kuptimi i fundit i këtij ajeti. All-llahu xh.sh. dëshiroi ta përmirësojë këtë realitet, dhe e bëri të qartë se nata dhe dita ekzistojnë në të njëjtën kohë në rruzullin tokësor. Me këtë na sinjalizoi për realitetin e krijimit të



tokës. Sikur All-llahu ta krijonte tokën në formë të rrafshtë në momentin kur ajo u krijua, dielli do të ishte prezent, dhe atëherë do të thonim se dita është para natës, sepse nata erdhi më pastaj. Por, All-llahu na thotë se as dita dhe as nata, nuk e parakuptojnë njëra tjetrën sepse janë të krijuara në një kohë. Kjo është argument se toka është krijuar në formën e rumbullakët. Forma e vetme është kjo e cila e vërteton se nata dhe dita janë krijuar (u gjendën) në të njejtën kohë. Kjo e vërtetë u vërtetua atëherë kur mendja e njeriut u angazhua dhe filloi të hulumtojë thellë në kuptimet e ajeteve Kur'anore. Kështuqë, shohim se All-llahu xh.sh. na ka sinjalizuar, edhe me këtë shembull, që ne të kuptojmë se toka është në formë të rrumbullakët, edhe atë vetëm me pak fjalë.

### RROTULLIMI I TOKËS DHE KODRAT

Në Kur'an, rrotullimi i tokës, është theksuar si një nga realitetet e gjithësisë. Në suren el Nemël, ajeti 88, i Lartëmadhëruari thotë :

**"Dhe i sheh malet (kodrat), e mendon (llogaritë) se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin ashtu siç lëvizin retë. (kjo është) Vepër e All-llahut, i cili çdo gjë e përsosi …"**

Kodrat u rrënjosën thellë në tokë. Ishte e domosdoshme që këto të privohen nga lëvizjet. Të qenit të privuara nga lëvizjet, sigurojnë mosdridhjet e tokës dhe sigurojnë luhatjet e njeriut. Ato janë simbol i qendrueshmërisë. Kur ato vështrohen, e japin këtë mesazh. Nga pamja e madhësisë dhe rrënjosjes së tyre, beson se toka është stabile dhe nuk lëvizë as edhe një hap të vetëm. Duket shumë stabile

dhe e pa lëvizshme, prandaj All-llahu në Kur'an e thotë fjalën: mendon (llogaritë). Këtë e ka thënë nga mëshira e Tij ndaj njeriut. Njeriu mendon se kodrat janë të pa lëvizshme. Por, ja që All-llahu dëshiron të na tregojë, se atë që ne i mendojmë se ato janë të pa lëvizshme, në realitet lëvizin nga një vend në një vend tjetër. Kodrat lëvizin ashtu siç lëvizin retë. Pse u tha si retë? Retë janë ato që nuk lëvizin vetvetiu, por lëvizin në sajë të erërave. Retë pa erërat qëndrojnë në vend. Erërat janë ato që i lëvizin retë nga një vend në një vend tjetër. Në Kur'an, përdorimi i shprehjes -" si retë", është sinonim i lëvizjes të kodrave me ndihmën e dikujt tjetër. Nëse kodrat janë të pa lëvizshme, atëherë kush i lëviz ato, nëse nuk lëvizen nga vetvetja? Kush është ai që i vë në lëvizje? Kjo është toka, e cila me lëvizjen(rrotullimin e saj), i lëviz edhe kodrat. Me siguri që edhe toka lëvizë dhe rrotullohet, sepse përndryshe, si do të lëviznin kodrat duke qenë ato të rrënjosura thellë në tokë. Pra kodrat e rrënjosura thellë, i përkasin një vendi që është në lëvizje. Ashtu sikur retë që janë të varura nga era, edhe kodrat janë të varura nga toka, ngase ato janë të rrënjosura në tokë. Në këtë mënyrë, All-llahu i Lartësuar na shpjegoi në formën më të përsosur, lëvizjen e tokës dhe rotacionin e saj. Ne kemi llogaritur se kodrat janë të palëvizshme por del se ato qenkan në lëvizje të vazhdueshme, përderisa toka lëviz. Fjala: "Mendoni se janë të palëvizshme", ka nevojë për një shpjegim më të gjërë, sepse kjo na vërteton një tjetër realitet shkencor.

Nëse qëndron në një trup që është në lëvizje, por nuk ka kurrfarë dridhje në ate trup, nuk e ndjen atë lëvizje. Do ta ndiesh atë lëvizje, nëse e krahason atë trup me një trup tjetër, i cili nuk është në lëvizje. Nëse vështrojmë nga dritarja e aeroplanit me të cilin fluturojmë, atëherë e ndiejmë lëvizjen e aeroplanit dhe atyre që janë aty. Por, nëse mbyllim dritaret dhe koha të jetë e qetë, si dhe aeroplani të fluturojë pa dridhje, ne nuk do ta ndiejmë lëvizjen e aeroplanit. Pse nuk do ta ndiejmë? Kjo ndodhë për arsye se çdo gjë përreth nesh, është e pa lëvizshme dhe ne nuk e ndiejmë atë lëvizje. Karriket dhe çdo gjë përreth teje, është e palëvizshme. Kjo vlen edhe për qëndrimin tonë në veturë ose tren, nuk kemi tronditje dhe çdo gjë është e qetë dhe nëse i kemi mbyllur dritaret nuk do ta ndiejmë lëvizjen e mjetit dhe lëvizjen tonë. Por nëse e hapim dritaren dhe vështrojmë një objekt të palëvizshëm do të vërejmë lëvizjet tona me mjetin ku qëndrojmë vetë.

Me këtë All-llahu xh.sh. dëshiroi të na tregojë se ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë lëvizjen e kodrave, sepse toka është stabile dhe qëndrimi ynë është stabil, dhe qëndrimi përreth nesh është stabil, dhe ne llogarisim se çdo gjë është e palëvizshme, sepse nuk imagjinohet ajo lëvizje përderisa nuk kemi mjet tjetër të palëvizshëm para nesh që të krahasohet. Por ne ju themi, këto kodra lëvizin, dhe këto nuk lëvizin nga vetja e tyre që të shkojnë nga një vend në një vend tjetër mbi tokë, por, ato përcjellin tokën gjatë rotacionit të saj, e ti mos u habit sepse ajo është nga " Vepra e All-llahut i Cili çdo gjë e përsosi", e po u bazove në këtë, atëherë do të bindesh.

Dikush thotë se ky cilësim i përket Ditës së Kijametit, por ne u themi atyre se kjo nuk ka të bëjë me ate, sepse atje nuk ka parallogaritje, por, atje është bindja.

All-llahu thotë:

**"…prandaj T'a hoqëm mbulesën, e sot shikimi yt është i mprehtë".** Kaf -22

Si dhe thënia e të Lartësuarit për kodrat në Ditën e Kijametit:

**"Dhe do të pyesin ty për kodrat, dhe thuaju: Zoti im do t'i bëjë ato hi e pluhur".** Ta Ha-105

Si është e mundur që ato t'i bën hi e pluhur dhe ato të parallogariten se janë të rrënjosura, thotë i Lartësuari xh.sh.:

**Ditën kur toka do të zëvendësohet me një tokë tjetër dhe qiellërat…"** Ibrahim-48

Në Ditën e Kijametit çdo gjë do të jetë e qartë dhe sheshazi, sepse nuk ka kodra, e gjitha do të jetë hi e pluhur. Do të shohim xhennetin dhe xhehennemin, si dhe do ta shohim All-llahun, pra llogaritja i përket kësaj bote kurse bindja në botës tjetër.

**Në vetet tuaja**

Një nga pikat shumë interesante të cilat i shqyrtoi Kur'ani, është edhe trupi i njeriut dhe shkenca organike. Shohim se All-llahu në Kur'an i përmend shqisat e të dëgjuarit, gjithnjë para shqisave të të pamurit. Kur njeriu humb të pamurit, atëherë themi se ka humbur çdo gjë. Nuk sheh, është në terr të plotë, e nëse nuk sheh, ska dyshim se është humbur plotësisht. Por nëse i ndodh që të humb të ndëgjuarit, e jo edhe të pamurit, themi se kjo do të ishte më e lehtë. Kur All-llahu e përmend të dëgjuarit dhe të pamurit, gjithmonë i jep përparësi të dëgjuarit!

Këtu kemi të bëjmë më mrekulli të All-llahut. All-llahu e lartësoi shqisën e të dëgjuarit, para asaj të të pamurit, sepse shqisa e dëgjimit është ajo e para e cila e merr detyrën nga organet e njeriut në këtë botë. Këtë detyrë dhe përparësi do ta ketë edhe në ahiret. Një nga arsyet është se kjo shqisë nuk fle kurrë. Pra, ky organ është ai i cili i pari e merr detyrën në këtë botë. Foshnja e posalindur dëgjon por nuk sheh. Nga kjo themi se rëndësia e këtij organi është që nga dita e parë e jetës së tij. Nëse në afërsi të një foshnje të sapolindur fjaloset, dhe përdoren fjalë bezdisëse, i sapolinduri do të reagojë duke qarë. Nëse të sapolindurve ia afrojmë duart afër syve, ata nuk e ndiejnë veten të rrezikuar. Kjo është e para. Në kohën kur njeriu është duke fjetur, duket të jetë çdo gjë në qetësi, me përjashtim të të dëgjuarit të tij. Nëse dëshirojmë që ta zgjojmë njeriun nga gjumi, edhe sikur t'ia afrojmë dorën afër syve, ai nuk do të reagojë. Por, nëse ai dëgjon ndonjë bubullimë, do të zgjohet shpejt dhe i trishtuar. Kjo ishte e dyta. Kurse e treta është ajo që të dëgjuarit është organ ndërmjetësues në mes njeriut dhe botës.

Në momentin kur dëshira e All-llahut ishte që personat e shpellës të flejnë me qindra vjet tha: **"Dhe iu mëshuam në veshët e tyre**

**(duke qenë ata) në shpellë (ku ata qëndruan) vite të tëra".** Kehf

Nëse prishet organi i dëgjimit, qenka e mundur që të flihet me qindra vite pa ndonjë shqetësim. Meqenëse lëvizjet dhe bubullimat gjatë ditës pengojnë njeriun të flejë në gjumë të thellë, kjo nuk ndodh gjatë natës, ngase është qetësi. D.m.th se veshi e merr detyrën i pari dhe ai nuk fle, nuk hamendet, si dhe qenka ndërmjetësues ndërmjet njeriut dhe botës. Është organ i cili dëgjon ftesën për në ahiret. Këto do të ishin disa nga shkaqet, se pse All-llahu e lartësoi të dëgjuarit para organeve tjera.

Kemi edhe një gjë tjetër të cilën e vërejmë në Kur'an. All-llahu kur flet për dëgjimin, gjithmonë e thekson atë në njëjës, kurse të pamurit gjithmonë në shumës. All-llahu thotë:

**"Dhe ju nuk do të mund të fshihni (mëkatet e juaja) sepse për ju do të dëshmojë ndëgjimi juaj dhe të pamurat e juaja".** Fusilet-22

A thua pse fjala -dëgjimi juaj, është në njëjës, kurse fjala- të pamurat, është në shumës? Pse nuk u tha: dëgjimet dhe të pamurit tuaj? Shikuar logjikisht, do të ishte më në rregull, sikur të ishin që të dyja në njëjës ose shumës. I Lartësuari me këtë deshi të na tregojë precizitetin e Kur'ani Kerimit. Të pamurit është shqisë e cila sundohet nga vetë dëshira e njeriut. Është në dëshirën time të shoh ose mos të shoh diçka. E kthej kokën, ose së paku shikimin e syve, nëse dua që të injoroj dikë, respektivisht të mos e shoh. Kurse të dëgjuarit është e kundërta e të pamurit. Nuk mund ta injorosh ose të mos dëgjosh, këtu nuk ka dua ose nuk dua. Nëse je në një dhomë ku ka dhjetë persona, sikur të flasin të gjithë, tek veshi yt do të arrijnë të gjitha zërat, deshe apo nuk deshe të dëgjosh. Pra do të mund të largosh shikimin tënd nga dikush që nuk do ta shohësh, por, nuk mundesh që të mos e dëgjosh ate që nuk dëshiron ta dëgjosh, dhe të sillesh sikur nuk e ke dëgjuar. Me dëshirë apo pa dëshirë, ti nuk ia ndalon vetes mosndëgjimin. Pra, të pamurit përfshin shumësin. Unë shoh një gjë, ti sheh atë, si dhe i treti e sheh atë. Njeriu edhe mund të mbyllë sytë e mos të shohe asgjë, por, kjo nuk vlenë për shqisën e të dëgjuarit. Të gjithë, përderisa jemi në një dhomë, do të dëgjojmë fjalimin. Të pamurit është i ndryshëm, kurse të dëgjuarit është unik. Secili ka sy dhe sheh aty ku ai dëshiron, por, secili nga ne ka veshë dhe që të gjithë jemi unik në atë çka dëshirojmë dhe çka nuk dëshirojmë të dëgjojmë. Këtu nuk përdoret thënia - dëgjimet. Veshët janë më të preferuar tek All-llahu, për dallim nga sytë, sepse ato nuk flejnë. Ato të cilët nuk flejnë, janë më të priviligjuara në krijim, se sa ato që flejnë. Veshët që nga krijimi i tyre nuk flejnë, ato veprojnë që nga sekonda e parë e jetës së tyre. Kurse organet e tjera të trupit, do të fillojnë së funksionuari pas disa ditësh, e ka prej tyre që fillojnë edhe pas disa vitesh.

Veshi nuk flen. Gjatë gjumit pushojnë të gjitha organet e trupit me përjashtim të të dëgjuarit. Me të dëgjuar një zë zgjohesh, por, sikur të kesh probleme me shqisat e të dëgjuarit, ose të mos dëgjosh fare, atëherë çfarëdo zhurme nuk të zgjon nga gjumi, sepse organi i thirrjes është i prishur. Po e njëjta vegël, pra veshi, do të jetë ai që do ta merr ftesën atëherë kur të fryjë Suri.

Për të funksionuar syri, ka nevojë për dritë e cila do të bën përthyerjen e objektit derisa të hyjë në sy e të shihet. Nëse është terr, atëherë nuk mund të shikohet. Kurse veshi e kryen funksionin e vet ditën dhe natën, në dritë dhe në terr, në gjumë ose zgjuar. Ai nuk fle kurrë dhe nuk ndalon. Për këtë arsye All-llahu i dha prioritet të të dëgjuarit, para të të pamurit.

### NDIESHMËRIA DHE LËKURA

Gjë interesante është edhe përsosmëria e ndjenjave, këtë na e mësoi i Lartësuari. Kur'ani ka prekur një realitet shumë interesant në natyrë. Ai na mësoi se si të njihemi me përsosmërinë e ndjenjave, angazhimet e ndjenjave. Ai na mëson për këtë duke qenë se është një realitet natyror e jo si një zbulim shkencor në lëminë e mjeksisë. Ai vetëm e tregon një realitet. Kur ai flet për mënyrën e dënimeve të pabesimtarëve me zjarr i Lartësuari thotë:

**"…Sa herë që tu piqen lëkurat e tyre do t'ua ndërrojmë me lëkurë tjetër me qëllim që ta shijojnë vuajtjen…"** Nisa-56

Urtësia e këtij ajeti është mu tek ndërimi i lëkurës e ajo bëhet për ta shijuar dënimin. Sipas Kur'anit vendi i ndijimit të dënimit qenka lëkura. Tani të shohim se ç'na thotë shkenca.

Është vërtetuar se të gjithë nervat e ndjeshmërisë janë të vendosura menjëherë passhtresës së lëkurës. Këto nerva pasi ta ndjejnë rrezikun dhe dhimbjën e sinjalizojnë trurin. Ato janë poshtë lëkurës pikërisht ashtu si tha All-llahu në Kur'an "do t'ua ndërrojmë me lëkurë tjetër me qëllim që ta shijojnë vuajtjen" Nga All-llahu është dhënë informacioni për një realitet natyrorë për, ndjeshmërinë dhe vendosjen e nervave të njeriut menjëherë pas lëkurës. Për ta ndier vazhdimisht njeriu dhembjen e zjarrit All-llahu do t'ia ndërrojë lëkurën sepse, kur lëkura të digjet e humb ndjenjën e dhembjeve ose vuajtjeve dhe kështu lëkura e re do të ndiejë dhembje. Tani kur shkencëtarët na thonë se nervat arrinë deri te lëkura u themi atyre se ato që janë të rëndësisë së veçantë na i ka treguar All-llahu para shumë shekujve.

Shihet qartë se llojet e mrekullisë në Kur'an janë të ndryshme dhe se ato sinjalizohen me shembuj shumë të thjeshtë. Në temat tjera thamë se All-llahu na thotë: "…Ecni nëpër tokë…" e nuk tha ecni mbi tokë, kështu vërtetuam mrekullinë se njeriu vërtetë ecën tokë në mes mbështjellësit atmosferik dhe sipërfaqes toksore. Ashtu siç u sqarua preciziteti i ajetit "… Zoti i shumë lindjeve dhe shumë perendimeve…"

Që të gjitha këto konsiderohen mrekulli të Kur'anit. Mrekullitë e Kur'anit nuk mbarojnë me kaq. Ato vazhdojnë dhe do të vazhdojnë…

***Përgatiti: Zelije Ziberi***

# Koncepti i Kur'anit për da'ven 1 (I)

HFZ. ATAULLAH ALIU

*"Ti ( Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit."*[2]

Në të kaluarën është shkruar për da'ven, e edhe sot e kësaj dite shkruhet në shumë gjuhë e edhe në gjuhën shqipe. Kështu që,edhe unë me këtë punim, të cilin e kamë titulluar *Koncepti i Kur'anit për da'ven* shpresoj të jap një kontribut modest.

Në këtë punim shqyrtohen gjashtëdhjetetre ajete, e për këtë ide më kanë ndihmuar autorët, siç janë: Muhamed Fuad Abdul-Baki, Klasifikimi tematik i ajeteve kur'anore, Shkup, 1995; Osman Nuri Hadžić, Muhammed a.s. i Kur'an, IV izdanje, Zagreb,1987; dhe Muhamed Fuad Abdul-Baki, El-Muëxhemulmufehres lielfadhil-Kur'ani, Ettabatethalithe,1992/1412.

Normalisht që titulli i zënë në gojë është e pamundur të lëvrohet, thënë kushtimisht "në mënyrë të përsosur" në një punim të këtij lloji, meqë për të nevojitet më shumë hapësirë.

Jam i mendjes se pa mirësjellje nuk ka da'vet, e pikërisht kjo është arsyeja që gjatë trajtimit të çështjes së da'vetit në këtë punim, potencohet virtyti i përmendur.

Këtë punim e kam ndarë në tri pjesë.

Pjesa e parë ka të bëjë me Konceptin kur'anor për da'ven në përgjithësi dhe i disa autorëve për virtytet e da'iut.[3] Pjesa e parë ka dy tërësi tematike: Koncepti i Kur'anit për da'ven në përgjithësi; dhe koncepti i disa autorëve për virtytet e da'iut. Pjesën e dytë e kam titulluar Koncepti i Kur'anit për da'ven gjatë periudhës parakur'anore, e cila gjithashtu është në dy tërësi tematike: Da'veja e Nuhit a.s. dhe refuzimi i popullit të tij; dhe Da'veja e Shuajbit a.s. dhe refuzimi i popullit të tij. Pjesa e tretë: Koncepti i Kur'anit gjatë periudhës kur'anore, e cila ka tri tërësi tematike.

Literatura bazë: Sherif Ahmeti, Kur'an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Medine, 1413/h.; Enes Karić, Kur'an s prijevodom na bosanski jezik, Sarajevo,1995; Abdul-Fettah el-Kadi, Esbabunnuzul anissahabeti velmufessirin, Bejrut, 1987; H. Hafëz Ibrahim Dalliu, Ajka e kuptimeve të Kur'ani Qerimit, Tiranë, 2005; dr.Jusuf Ramiq, Shkaqet e shpalljes së Kur'ani Qerimit, Shkup, 1990; dhe Abdul-Hamid el-Bilali, Metodat e da'vetit në pengimin dhe largimin e veprave të këqija, Shkup, 2003.

I.Koncepti i Kur'anit për da'ven në përgjithësi dhe i disa autorëve për virtytet e daisë

## 1.KONCEPTI I KUR'ANIT PËR DA'VEN NË PËRGJITHËSI

Për këtë çështje, për shqyrtim do të kemi gjashtë ajete, nga suret: Esh-



Shuaraë, El-Ankebut, Kaf dhe En-Nasr.

Në fjalët e Allahut thuhet:

*" Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt."*[4]

Andaj, Pejgamberi urdhërohet t'i thërrasë të afërmit, edhe pse ndër ta kishte mjaft kundërshtarë të rreptë, e Zoti i garanton se Ai është me të edhe kur është i vetmuar edhe kur është në grup, me xhematë.[5]

Ajeti në fjalë, na jep të kuptojmë se pas pranimit të fjalës së Allahut, Pejgamberi urdhërohet që të fillojë me da've nga rrethi më i ngushtë, respektivisht nga ai familjar.

Në ajetin tjetër thuhet:

*" E ata, të cilët luftuan për hir të Neve, Ne, me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se Allahu është në krahun e bamirësve."*[6]

Sipas këtij ajeti, kemi të bëjmë me atë se prej muslimanit, respektivisht prej daiut kërkohet iniciativa dhe mundi i tij, e orientimi dhe udhëzimi i përket Allahut xh.sh. dhe se Ai pamëdyshje është në krahun dhe ndihmën e bamirësve.

Po ashtu në Kur'ani Qerim thuhet:

*" Ne dimë më së miri çka thonë ata,e ti ndaj tyre nuk je ndonjë dhunues, ti këshilloje me këtë Kur'an atë që e ka frikë kërcënimin Tim."*[7]

Kështu që Muhamedi a.s., si daiu i parë në periudhën kur'anore, urdhërohet të mos u vërë veshin thënieve të tyre, sepse Zoti e di më së miri atë që e thonë ata; i thuhet se ti e ke për detyrë t'i këshillosh e t'i qortosh, e jo t'i fusësh me dhunë në fenë islame; këshilloje atë që e ka frikë dënimin me zjarr."[8]

Në kaptinën En-Nasr thuhet:

*"Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi (ngadhënjimi). Dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e Allahut. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërkuar prej Tij falje. Ai vërtet e pranon shumë pendimin; është Mëshirues i madh."*[9]

Enes Kariç bën këtë shpjegim: "Surja Nasr është medinase dhe ajo flet për çlirimin e Mekës, gjë me të cilën muslimanët janë nderuar dhe paralajmërojnë përhapjen e Islamit në pjesën e Gadishullit Arabik e më gjerë… Kjo sure paralajmëron se njerëzit dhe popujt do të hyjnë në Islam turma-turma, se flamuri islam do të ngrihet lart, ndërkaq adhuruesit e statujave do të zhduken… Kjo është shenjë e njëmendësisë së pejgamberllëkut të Muhamedit a.s. ( Sabuni,III, 615).[10]

## 2. KONCEPTI I DISA AUTORËVE PËR VIRTYTET E DAIUT

Në literaturën islame vazhdimisht është shkruar pë virtytet e daiut si element i rëndësishëm dhe me peshë.

Në këtë tekst do të përmendim shtatë autorë që kanë shkruar për këtë temë.

Njëri prej autorëve është Shejh Abdil-Aziz bin Abdil-lah bin Baz. Sipas këtijë autori, daiu duhet patur katër virtyte, e ato janë: ihlasi (sinqeriteti), dituria, butësia, dhe veprimi sipas da'vetit.[11]

Në veprën e tij *Usuludda'veti*, Abdul-Kerim Zejdani numëron pesë virtyte të daiut: sinqeritetin, durimin, mëshirën, modestinë dhe komunikimin.[12]

Ebul-Ala El-Mevdudi thotë se daiu duhet mobilizuar me këto virtyte: durim, flijim, qëllim dhe ngulm në punë.[13]

Për Abdul-Bedi Sakër, virtytet që duhet t'i ketë daiu janë: qëllimi i sinqertë, urtësia, durimi, dituria dhe nxënia e Kur'anit përmendsh (aq sa mundet).[14]

Xhemal Salihspahiç numëron katërmbëdhjetë virtyte: besimi i fuqishëm, aspekti i moralit, forcë e veçantë e imamit (daiut-A.A.), kujdesi në pamjen e trupit, ndjekja e mësimit islam, qetësia e brendshme, dashuria ndaj da'vetit dhe xhematit, maturia, modestia, jeta praktike, jeta familjare, kujdesi ndaj pranimit të fjalëve dhe abstenimi nga të kritikuarit.[15]

Sipas Abdul-Hamid El-Bilali, ata që veprojnë për ndalimin e veprave të shëmtuara duhet të kenë këto virtyte: urtësinë, durimin, diturinë, sinqeritetin, modestinë, dëgjimin e palës me mirësjellje, shpirtmirësinë dhe butësinë.[16]

Selman El-Aude përmend këto virtyte: dashurinë e vërtetë (ndaj Islamit -A.A.), durimin, modestinë dhe drejtësinë.[17]

Sipas këtyre autorëve, daiu duhet t'i ketë tridhjetë e ca virtyte.

**(Vazhdon )**

[1]) Fjala *da've* do të thotë: thirrje në rrugën e Allahut. Në vazhdim të këtij punimi do të përdoret në origjinal, d.m.th. në arabisht.

[2]) En-Nahl,125; përkthimi i ajeteve është marrë nga: h.Sherif Ahmeti, Kur'an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Medine, 1413.

[3]) Fjala *dai* do të thotë: thirrës në rrugë të Allahut. Në vazhdim do të përdoret në origjinal.

[4]) Esh-Shuaraë, 214.

[5]) h. Sherif Ahmeti,Kur'an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Medine, 1413.

[6]) El-Ankebutë, 69.

[7]) Kaf, 45.

[8]) h. Sherif Ahmeti,Kur'an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Medine, 1413, fq. 600.

[9]) En-Nasr, 1-3.

[1]) Enes Karić, Kur'an s prijevodom na bosanski jezik, Sarajevo,1995, fq. 604.

[1]) Shejh Abdil-Aziz bin Abdil-lah bin Baz,Edda'vetu ilellahi ve ahlakudduati, Rijad,1418,h.,fq.56-59.

[12]) Abdul-Kerim Zejdani,Usuludda'veti, Amman,1409/1988,fq. 345-364.

[13]) Ebul-Ala El-Mevdudi,Tedhkiretu duatil-islami, Kuvajt, 1966, fq. 37-42.

[14]) Abdul-Bedi Sakër, Edda'vetu ilell-llah,Bejrut, 1984, fq. 32-33.

[15]) Džemal Salihspahić, IMAM, Visoko, 2004, fq. 97-183.

[16]) Abdul-Hamid El-Bilali, Metodat e da'vetit në pengimin dhe largimin e veprave të këqija,Shkup, 2003, fq. 28-42.

[17]) Selman El-Avde, Ahlaku i thirrësit, Shkup, 2006, fq.19-43.

# Paqja në brendi të Islamit

**"Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një dhe se ne i jemi dorëzuar Atij" (El Ankebut 29:46).**

**TARIQ RAMADAN**



Ajo që një musliman arrin të kuptojë e të provojë në religjionin e tij është, para së gjithash, lidhja e tij thelbësore me ndjenjën e paqes, qetësisë dhe prehjes shpirtërore. Fjala islam është trajta e katërt gramatikore e po së njëjtës rrënjë *salama*: *islam*, *aslama* dhe d.m.th të dhurohesh, t'i mbështetesh krejtësisht Zotit me paqen në zemër.

**"Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen; pra, ta dini se me të përmendur Allahun, zemrat stabilizohen"** (Er-Rrad 13:28).

Pra, me të përmendurit e Zotit qetësohen zemrat…T'i mbështetemi Zotit, dëshira e zjarrtë për të arritur paqen e kësaj afërsie, paqen e "Atij që është afër" është gjithçka që dëshirojmë me gjithë qenien tonë. Dhe atëherë, duke pasur shembull Pejgamberin s.a.w.s ne i lutemi të Madhërishmit: *"O Zot, Ti je paqja, nga Ti vjen paqja dhe te ti kthehet paqja"*. Ndoshta ekziston ndonjë horizont më i qartë harmonie? Nga ana tjetër, në tërësinë e fjalimeve të përditshme, në mes gjithë asaj që mësojmë, paqja është thelbësore dhe nevojitet mëshira. Por, mjerisht, në gjithë atë që mësojmë ne, në gjithë atë që

themi, kjo nuk duket; apo duket aq pak, saqë personat që i kemi përreth e që na përkrahin të gjitha ditët kanë ndonjë dyshim mbi vërtetësinë e kësaj "paqeje" që ne e mbrojmë kaq shumë. Flasim shumë pak rreth saj, e tregojmë rrallë këtë ndjenjë, gjë që në të vërtetë mund të ngjallë dyshime mbi faktin që Islami sugjeron ëmbëlsi, dashuri dhe paqe të sinqertë.

Megjithatë, para së gjithash në Islam vlen ky mendim: në të njëjtën kohë në të cilën përshëndesim ndonjë vëlla ose motër tonën, a nuk i themi: *"es selamu aleijkum ue rahmetullahi ue berekatuhu…"*? *Es selam*, paqja. "Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin me ty". Këto janë fjalimet tona, disa herë i shqiptojmë pa seriozitet, e tjera herë me vëllazëri e dashuri. Në fund të lutjeve tona, të njëjtat fjalë shoqërojnë përshëndetjet tona: "*"es selamu aleijkum ue rahmetullah"* që u drejtohen të gjithë krijesave përreth neve, si engjujve ashtu edhe njerëzve, me qëllim për të përhapur këtë mesazh paqeje.

Së fundi, cila është gjëja që gjithë ne dëshirojmë? Në çka shpresojmë pas kësaj jete? Parajsën në të cilin të gjithë ne shpresojmë, që Shpallja e thërret me emra të ndryshëm: *el xhenneh,* por edhe *dar es selam*, vendbanim i paqes.

**"Allahu thërret për në Xhenet (vendbanimin e paqes)"** (Suretu Junus 10:25).

Zoti na thërret në vendbanimin e paqes. A nuk është ndoshta e vërtetë që besimi ynë bazohet në mënyrë thelbësore në kërkimin e paqes së brendshme e të asaj sociale? Është ajo që kërkojmë ta shprehim në jetën tonë të përditshme, në lidhjen tonë me Zotin, me njerëzit, kafshët, natyrën…jo vetëm me muslimanët:

**"Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një dhe se ne i jemi dorëzuar Atij"** (El Ankebut 29:46).

"**Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a (i) frikësohet (Zotit)"** (Ta Ha 20:44).

Fjalë të buta? Kujt, pra? Faraonit…më të keqit prej diktatorëve, arketipit të kryelartësisë, të arrogancës e të të gjitha mburrjeve. Kjo lidhje butësie e dashurie nuk kufizohet vetëm me njerëzit, por i zgjerohet të gjithë natyrës…Kështu tradita profetike na mëson që i është premtuar Parajsa atij njeriu që zbriti në një pus për ta shuar etjen e që, derisa po ngjitej lart, e pa një qen të etur dhe i ndihmoi. Ndërsa sa i përket asaj gruaje që rrihte macen e saj derisa ngordhi: do të fitojë një ndër ndëshkimet më të këqija.

Kjo është pamja e përgjithshme e mësimeve islame që i jep forcë e energji paqes dhe harmonisë mes njerëzve dhe gjithë krijesave. Zemra jonë është e mbushur me këtë ndjenjë, fjalët tona e ngjyrosin me pasuri, por shumë pak flasim për të. Ndërsa duhet ta përsërisim vazhdimisht në mënyrë thelbësore, fundamentale e thellësisht.

Në këtë duhet të na inkurajojë vëllazërimi ynë, në tjera fjalë të na bëjë t'ua kujtojmë të tjerëve durimin dhe mëshirën:

**"E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshillluan për mëshirë (për ndihmë)"** (El Beled 90:17).

Mirësia siguron paqen. Megjithatë, nuk bëhet fjalë që muslimani e muslimania të mbyllen, të fshehen pas një spiritualiteti ku gjejnë strehim, të merren vetëm me praktikën e kultit, duke kërkuar paqen totale larg nga ngjarjet e botës, pra të arrijnë një misticizëm absolut. E kundërta, duhet t'i shikojmë gjërat në fytyrë dhe gjëja e parë që duhet marrë parasysh është natyra reale e njerëzve. Ata a e kërkojnë gjithmonë paqen, a e duan sinqeritetin? A e duan me të vërtetë çiltërsinë dhe të vërtetën? Sigurisht jo, dhe nuk është e nevojshme të kërkojmë shumë larg manifestimet e konfliktit dhe të armiqësisë. Le të shikojë çdokush prej nesh vetveten dhe në brendësi të ndërgjegjes së tij…Çka do të gjejë?

**Dy rrugë të qarta**

Islami inkurajon paqen, por cili njeri, në brendësinë e tij më intime, mund të afirmojë që s'e njeh dhunën: qoftë ajo agresivitet, urrejtje, a nxitje e një instikti destruktiv, apo zemërim? Kontrollimi i vetvetes, qetësia, respekti ndaj të tjerëve, butësia, nuk janë të natyrshme, por fitohen, duke bërë një përpjekje personale, të përhershme. Ky është shpërblimi i njerëzve: arrijnë anën e tyre humane duke punuar shumë me vetveten; këtë duke e menduar dhe me maturi. Çdokush e di, secila zemër e ndjen. E vërteta është se jemi njerëz. Në ne, në secilin prej nesh ekzistojnë dy orientime:

rruga e pranimit dhe e dëgjueshmërisë

rruga e refuzimit dhe e mohimit.

*"I lumtur është ai që ndjek zemrën e tij, i pakënaqur ai që e korrupton"*. Në brendinë tonë dalin shenjat e para të shqetësimit: secili prej neve dëshiron, ka një dëshirë shumë të thellë, që ta pastrojë qenien e tij e t'i forcojë shqetësimet e veta shpirtërore. Në të njëjtën kohë ndjen peshën e sprovës së vetmuar: secili i njeh, më mirë se çdokush tjetër, prirjet e tij për t'u bërë i dhunshëm, të zemërohet, të dëshirojë paratë e pasurinë, të bëhet i famshëm, të synojë pushtetin. Asnjë nuk mund të mohojë realitetin e këtij shqetësimi të brendshëm: kush e mohon, tregohet engjëll; e kush pretendon të jetë engjëll, sipas fjalëve të Pascal-it, është afër të shndërrohet në kafshë. Burimet islame shprehin të njëjtin koncept: kush beson të jetë i pastër, është i papastër për të njëjtën bindje; më e keqja ndoshta, është ajo e kryelartësisë (el kibrija).

E gjithë letërsia, që nga ekzistenca e saj, është e mbushur nga tradita e këtij tensioni që herë sheshohet, herë tundet, herë dëmton brendinë e njerëzve. Nga Bagavad- Xhita[6] deri te Teurati[7], të Ungjilli[8], nga Dostojevski[9] te Baudlaire[10], horizonti human mbetet i njëjt. Kur'ani sh-

preh një ndër eksperiencat më të përditshme:

**"Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe, ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten"** (Esh Shems 91:7-10).

Dy rrugët janë të qarta dhe e marrin përsipër së bashku, në mënyrë më të qartë dhe etike, kuptimin e jetës së përtejme. Jeta është kjo sprovë ekuilibri për njerëzit që mund të bëjnë çka më mirë e çka më keq.

**Një tension natyror e human**

Këtu i afrohemi thelbit të nocionit të xhihadit, që nuk mund të kuptohet ndryshe veçse duke shikuar konceptin e njeriut që e frymëzon. Tensioni është natyral, konflikti i brendshëm është pikërisht human dhe njeriu ec e realizohet nëpërmjet përpjekjes që bën për t'i dhënë fuqi e për ta bërë prezente prirjen më pak të dhunshme, hidhëruese, agresive të qenies së tij. Ai çdo ditë lufton kundër fuqive më negative të qenies së tij: ai e di që çmimi i humanitetit të tij do të mund t'i pushtojë ata. Kjo përpjekje e brendshme, kjo luftë mes "postulimeve" të brendshme, është përkthimi më i përshtatshëm – letrar e figurativ- i termit *xhihad*.

***"Ky tension që synon kontrollin e vet neve, në arabisht përkthet me fjalën xhihad".***

Këtu nuk kërkohet të reduktohet xhihadi në dimensionin personal e të brendshëm (xhihad en nefs), por shumë qartë kërkohet t'i kthehemi shprehjes së realitetit të tij më të drejtperdrejtë: xhihadi për humanitetin e njeriut është ajo që instinkti është për sjelljen e kafshës. Të jesh për njeriun, do të thotë të jesh përgjegjës; e kjo përgjegjësi është e lidhur me zgjidhjen që duhet ta bëjë gjithmonë për të shprehur mirësinë dhe respektin e tij e të tjerëve. Të zgjedhësh, sipas realitetit të konflikteve të brendshme, d.m.th të përcaktosh paqen e zemrës.

***"Të kuptosh se çka d.m.th kontrolli i vetvetes, është hapi i obligueshëm i një diskutimi më të gjerë mbi kuptimin e konfliktit të armatosur".***

Po sjellim një fjalim të Pejgamberit, Muhamedit (s.a.v.s), nga një hadith, zinxhiri transmetues i të cilit njihet si i dobët (daif), por nga i cili mund të nxjerrim një mësim, meqense kuptimi dhe domethënia e tij konfirmohen nga tradita të tjera. Duke u kthyer nga një ekspeditë në të cilën muslimanët iu ishin kundërvënë armiqve të tyre, Pejgamberi a.s. definoi luftën si një "xhihad i vogël" në krahasim me "xhihadin e madh", që është përpjekja e pastrimit interior, të realizimit shpirtëror të njeriut para Krijuesit të tij. Më shumë se krahasimin, këtu duhet marrë parasysh bashkimin e besimit me eksperiencën e përpjekjes për të fituar harmoni e qetësi. Jeta është kjo sprovë, e forca shpirtërore justifikohet me zgjidhjen e mirësisë, të veprës së mirë, si për vetveten ashtu edhe për të tjerët:

**"...krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju sprovuar se cili prej jush është më vepërmirë"** (El Mulk 67:2).

Të ndryshosh hapësirën e brendshme, të qetësosh zemrën duke qenë mirënjohës ndaj Krijuesit e duke bërë vazhdimisht vepra humane e bujare, të duash drejtësinë e të jetosh në dritë; ky, pra, është kuptimi i spiritualitetit islam. Ai arrin horizontet e të gjitha spiritualiteteve që kërkojnë prej njeriut të gjejë forcën e të qenit në vend që të pësojë tërbimin dispotik të një jete të reduktuar vetëm në instinkte. Kjo përpjekje për vetëkontroll në arabisht përkthehet me fjalën *xhihad*. Për të kuptuar këtë aspekt obligohemi të diskutojmë më gjerësisht mbi konfliktin e armatosur. Ajo që duhet të kemi parasysh, së pari nga ana individuale e pastaj nga ajo internacionale, është që Zoti ka dashur tensionin dhe mbarështimin e tij e ka bërë një prej kushteve që lejojnë futjen tonë në fe e në humanizëm. Bëhet fjalë për t'u përmbajtur nga prirjet tona më negative ose shtazore, për t'iu afruar vlerës së kontrollit (vetëpërmbajtjes):

*Një ditë Pejgamberi (s.a.w.s) pyeti: "Kush është, pra, më i forti prej juve?" Shokët e tij u përgjigjën: "Ai që e mund armikun e tij". Pastaj Pejgamberi u përgjigj: "Jo, më i forti është ai që e sundon zemërimin e tij".* (I sjellë nga El-Buhari dhe Muslimi)

